



**ALBANIAN UNIVERSITY
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO – ADMINISTRATIVE**

TEMË PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

***SFIDAT E POLITIKËS FISKALE PËR VENDET QË I BASHKOHEN BE-SË
(RASTI I SHQIPËRISË)***

Punoi:

Ilda KADRIMI

Udhëheqës shkencor:

Prof. Asoc. Dr. Artur RIBAJ

TIRANË, 2020



**SFIDAT E POLITIKËS FISKALE PËR VENDET QË I BASHKOHEN BE-SË
(RASTI I SHQIPËRISË)**

Dorëzuar
Albanian University
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Administrative,
për marrjen e gradës shkencore -Doktor

Numri i fjalëve: 50 675
Tiranë, Mars 2020

Doktorante:
Ilda KADRIMI

Udhëheqës shkencor:
Prof.Asoc.Dr. Artur RIBAJ

Vërtetohet se ky Komision Vlerësimi është mbledhur në datën _____ për të bërë
vlerësimin e këtij Disertacioni të Ciklit të Tretë të Studimeve për marrjen e gradës shkencore

Doktor në Shkenca Administrative.

Dr. Emër Mbiemër

Titulli

Kryetar Komisioni

Dr. Emër Mbiemër

Titulli

Anëtar Komisioni

Dr. Emër Mbiemër

Titulli

Anëtar Komisioni

Dr. Emër Mbiemër

Titulli

Oponent

Dr. Emër Mbiemër

Titulli

Oponent

© **Copyright Ilda KADRIMI**

Përmbajtja e këtij punimi është totalisht autentike. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

© **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Ky material nuk është prezantuar më parë në këtë institucion dhe as në ndonjë institucion tjetër të ngjashëm me të. Mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të këtij punimi është krejtësisht origjinale dhe objektive.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Abstrakt

Ky punim së pari do të japë një vlerësim për shkallën e përmbushjes së kriterëve të Maastricht me fokus të veçantë tek kriteri i Politikës Fiskale. Diskutimi që lidhet me sfidat e politikës fiskale për vendet si Shqipëria që duan ti bashkohen BE-së dhe ndikimet e politikës fiskale në rritjen ekonomike janë fusha studimi mjaft aktuale pasi zhvillimi i instrumenteve të duhura fiskale mund të na çojë në një rritje ekonomike të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Politika fiskale, aspekti makroekonomik dhe sfidat e saj janë pjesa teorike e trajtimit dhe përshkrimi i literaturës ku jam munduar të argumentoj me gjetjet e mia gjatë studimit. Pas kësaj, punimi do të nxjerrë në pah fushat e ndërhyrjes të nevojshme në nivel makroekonomik dhe faktorët që duhen konsideruar.

Në këtë disertacion pjesën më të konsiderueshme e ka trajtimi i situates aktuale ku ndodhet Shqipëria lidhur me plotësimin e kriterit të politikës fiskale për integrimin në Bashkimin Europian dhe prespektiva dhe strategjitë që përdor Bashkimi Europian në vlerësimin e vendeve kandidate për këtë fushë me qëllim që të kemi në funksion metodën e krahasimit dhe të kemi një pasqyrë realiste se si dhe çka duhet të bëhet nga qeverisja e Shqipërisë, në mënyrë që ekonomia jonë të ketë një integrim të shëndetshëm ekonomik me Bashkimin Europian, duke ju trajtuar vërtetësinë e hipotezës së ngritur dhe dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore.

Borxhi Publik dhe potencialet për zvogëlimin e tij janë sfida direkte të qeverisjes, dhe si të tilla duhet pasur parasysh që ndikojnë në mos plotësim të kriterit të Politikës Fiskale. Duke u bazuar në teorinë shkencore ku politika fiskale ekspozohet si ekspansioniste, ajo mund të ndërtohet edhe si politikë fiskale shtrënguese.

Pra, shteti duhet të rrisë masën e akumulimit të të ardhurave tatimore dhe të reduktojë nivelin e shpenzimeve publike, duke pasur si orientim zvogëlimin e borxhit.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Po ashtu, mund të konkludojmë se qeveria duhet të mirë qeverisë evazionin fiskal dhe shpenzimet buxhetore për të qenë me kthim më të lartë në ekonomi dhe në rritjen e kërkesës agregate.

Fjalët kyçe: Politika Fiskale, Sfida, Bashkimi Evropian, Borxhi Publik, Deficiti Buxhetor



Abstract

This paper will first provide an assessment of the degree to which Maastricht criteria are met with particular focus on the Fiscal Policy criterion. Discussions related to the challenges of fiscal policy for countries like Albania that want to join the EU and the impacts of fiscal policy on economic growth are very current areas of study as the development of appropriate fiscal instruments can lead to continued economic growth and stable. Fiscal policy, the macroeconomic aspect and its challenges are the theoretical part of the treatment and the description of the literature where I have tried to argue with my findings during the study. After that, the paper will highlight the areas of intervention needed at the macroeconomic level and the factors to consider. The most significant part of this dissertation is the treatment of the current situation in Albania regarding the fulfillment of the fiscal policy criterion for integration into the European Union and the perspectives and strategies used by the European Union in assessing candidate countries in this field in order to have in function of the method of comparison and to have a realistic picture of how and what should be done by the government of Albania, so that our economy has a healthy economic integration with the European Union, treating you the veracity of the hypothesis raised and given answers research questions. Public debt and the potential for reducing it are direct government challenges, and as such should be borne in mind that they affect the failure to meet the Fiscal Policy criterion. Based on the scientific theory where fiscal policy is exposed as expansionist, it can also be constructed as tight fiscal policy. So, the state has to increase the tax incomes and reduce the level of public spending, with the orientation of reducing public debt. We can also conclude that the government should better manage fiscal evasion and budget expenditures in order to have a higher return on the economy and increase aggregate demand.

Keywords: *Fiscal Policy, Challenges, European Union, Public Debt, Budget Deficit.*



FALËNDERIME

Është shumë e vështirë të gesh fjalët e duhura për të shprehur falënderime ndaj atyre njerëzve të cilët bëhen bashkudhëtarë të sfidave të tua. Megjithatë, unë nuk mundem të mos përcjell dy fjalë modeste dhe shumë të përzemërta për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj këtyre njerëzve.

Fillimisht falënderoj udhëheqësin e këtij disertacioni për udhëzimet, këshillat, inkurajimin, mbështetjen, por edhe vërejtjet që më ka përcjellë gjatë realizimit të këtij studimi i cili dukej mision i pamundur.

Falënderoj për kontributin dhe mbështetjen e tyre të gjithë Profesorët e Albanian University dhe Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative për bashkëpunimin dhe mbështetjen që më kanë dhënë gjatë këtij udhëtimit të gjatë dhe të mundimshëm. Gjithashtu, falënderoj edhe studiues të tjerë me të cilët kam shkëmbyer mendime dhe kam marrë sugjerimet e tyre.

Një falënderim i veçantë është edhe për disa miq dhe bashkëpunëtor të mi në sistemin fiskal të cilët më mundësuan në sigurimin e të dhënave, pasqyrave financiare dhe kryerjen e intervistave, pa të cilat nuk do të kisha mundur ta realizoja këtë studim.

Dhe krejt në fund, por jo nga rëndësia, një falënderim shumë i sinqertë i kushtohet familjes sime të madhe, prindërve, motrës, vëllezërve, bashkëshortit dhe dy fëmijëve të mi, të cilët kanë qenë udhëheqësit e mi shpirtërorë, që me dashurinë e tyre, durimin dhe kurajën më dhanë forcën për të përballuar gjithë këto sfida.



PASQYRA E LËNDËS

KAPITULLI I: SFONDI I STUDIMIT

1.1. Hyrje	13
1.2. Politika fiskale dhe realiteti shqiptar	2
1.3. Kuadri i punimit	3
1.4. Përcaktimi i problemit	5
1.5. Objektivi i përgjithshëm i studimit	5
1.6. Objektiva specifike	5
1.7. Pyetjet për hulumtim	6
1.8. Rëndësia e studimit	6
1.9. Fushëveprimi i studimit	7
1.10. Kufizimi i studimit	8
1.11. Organizimi i studimit	9

KAPITULLI II: RISHIKIMI DHE TRAJTIMI ANALITIK PËRMES LITERATURËS

2.1. Politika Fiskale për vendet që i bashkohen BE-së	10
2.2. Objektivat e Politikës Fiskale	11
2.2.1 Qëndrimet e politikës fiskale	12
2.3. Roli i Politikës Fiskale për stabilitetin ekonomik	15
2.4. Roli i Politikës Fiskale për Rritjen Ekonomike	19
2.5. Politika Fiskale kriter dhe mekanizëm transmetues për integrimin ekonomik në BE	24
2.6. Plotësimi i Udhëzimit Politik të BE-së lidhur me Politikën Fiskale	34
2.6.1 Programi Ekonomik dhe Fiskal për vendet kandidatë si Shqipëria	37
2.6.2. Situata ekonomike dhe fiskalë e Shtetit Kandidat	41
2.6.3 Trendi i konsolidimit fiskal për vendet candidate si Shqipëria	43
2.6.4 Aplikimi i Mirëqeverisjes Fiskale	44
2.7. Sfidat e politikës fiskale lidhur me ekonominë informale për vendet në zhvillim	46
2.7.1. Ekonomia informale sfidë për vendet candidate për antarësim në BE	47
2.7.2. Evazioni fiskal rrit ekonominë informale dhe sfidon Politikën Fiskale	51
2.7.3. Sfidat të tjera të ekonomisë informale për Politikën Fiskale	57
2.7.4. Masa për adresim të sfidave që vijnë prej ekonomisë informale	60



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

2.8. Borxhi Publik sfidë dhe tregues i kriterit të Politikës Fiskale për integrimin në BE	64
2.8.1. Zanafilla e krijimit të teoris së borxhit publik.	66
2.8.2. Efektet e Borxhit të lartë Publik në stabilitetin ekonomik të vendit	69
KAPITULLI III. METODOLOGJIA	74
3.1 Hyrje	74
3.2 Metodat e përdorura në punim	74
3.3 Teknika e analizës së variancës ANOVA	76
3.3.1 Analiza e një shembulli të ANOVA	78
3.4 Regresion i thjeshtë linear	84
3.4.1 Modeli i thjeshtë i regresionit linear	84
3.4.2 Vlerësimi i parametrave të regresionit	86
3.4.3 Koeficienti i Korrelacionit midis X dhe Y	89
KAPITULLI IV ANALIZA (TRAJTIMI EMPIRIK)	
4.1. Hyrje	90
4.2. Ecuria e normës së rritjes së PBB-së	91
4.3. Treguesit sipas Nenit 126-të (ex-article 104 TEC) të Traktatit të Mاستrihtit	
4.3. Treguesi i Deficitit Buxhetor për Shqipërinë (2008-2018)	90
4.4. Treguesi i Borxhit Publik ndaj PBB për Shqipërinë (2008-2018)	95
4.5. Borxhi publik sfidë për Shqipërinë, institucionet përgjegjëse	
4.5.1 Konteksti i sfidës	102
4.5.2. Institucionet përgjegjëse për Menaxhimin e Borxhit Publik	104
4.5.3. Përfaqësja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	111
4.5.4. Risqet e institucioneve përgjegjëse lidhur me borxhin publik	116
4.6. Mbledhja dhe baza e të dhënave për treguesit dhe kriterin e Politikës Fiskale	118
4.7. Analiza bazuar në ANOVA dhe Regresionit të shumfishtë	123
4.8. Zvogëlimi i ekonomisë informale dhe mjedisi biznesit	124
4.9. Sfidat e Politikës fiskale	126



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

KAPITULLI V. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

5.1. Hyrje	130
5.2. Konkluzione	131
5.3. Rekomandime	137
5.4. Studime të mëtejshme	141

BIBLIOGRAFIA	143
--------------	-----

Aneksi I Shpjegimi i grafikëve të përpunuar nga të dhënat e marra	157
---	-----

Aneksi II Treguesit fiskale sipas buxhetit të konsoliduar shprehur në % për PBB	160
---	-----



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Objektivat e Politikës Fiskale	11
Tabela 2. Punime shkencore për impaktin negative të rritjes borxhit publik ndaj PBB-së. <i>Burimi: Autori</i>	72
Tabela 3. Analiza SWOT	90
Tabela 4. Analiza sipas Teknikës ANOVA	123
Tabela 5 Analiza e regresionit të shumfishtë midis variablave të pavaur dhe variablit të varur PBB	124
Tabela 6. Zbatimi i Udhëzimit ¹	125

¹0 = pa zbatim; 1 = po përgatitet implementimi; 2 = janë ndërmarrë hapat fillestarë; 3 = zbatimi në vazhdim me disa rezultate fillestare; 4 = zbatimi është avancuar; 5 = zbatim i plotë



LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Ekonomia e dyfishtë.	48
Figura 2. Mekanizmat e transmissioinit të rritjes së borxhit publik në rritjen ekonomike. Burimi: Nautet et al, 2011	71
Figura 3. Skema e institucioneve përgjegjëse për Performancën e Menaxhimit të Borxhit Publik	92
Figura 4. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit	105
Figura 5. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Makroekonomisë dhe Politikave Fiskale	107
Figura 6. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit	109
Figura 7. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit	109



LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1' Modeli i thjeshtë i regresionit linear	84
Grafiku 2. Një probabilitet ose marrëdhënie statistike ndërmjet X dhe Y.	84
Grafiku 3. Regresioni i thjeshtë I Y në X. Shpërndarja probabilitare e Y në X	85
Grafiku 4. Përshtatja e katrorëve më të vegjël në shumën	87
Grafiku 5. Ecuria e normës së rritjes së PBB-së	
Grafiku 6 Burimi: <i>Të dhënat marrë nga INSTAT, përpunuar nga autori</i>	84
Grafiku 7. Burimi: <i>Të dhënat marrë nga INSTAT, përpunuar nga autori</i>	89
Grafiku 8. Parashikimi për ecuria e normës së rritjes së PBB-së	
Grafiku 9. Borxhi publik dhe deficit buxhetor në raport me PBB (2008 -2018)	86
Grafiku 10. Defiçiti buxhetor në raport me PBB (2008-2018)	94
Grafiku 11. Tendenca e ecurisë së defiçiti buxhetor në raport me PBB (2019-2024)	93
Grafiku 12. Tendenca e ecurisë së Borxhit Publik në raport me PBB (2019-2024)	94



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

AFCOS	Anti-Fraud Coordination Service
BSH	Banka e Shqipërisë
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
PIIGS	PIIGS is an acronym for Portugal, Italy, Ireland, Greece, and Spain, which were the weakest economies in the eurozone during the European debt crisis.
ECOFIN	Economic and Financial Affairs Council configuration (Ecofin) The Economic and Financial Affairs Council (ECOFIN) is responsible for EU policy in three main areas: economic policy, taxation issues and the regulation of financial services.
ESA	The European Space Agency portal features the latest news in space exploration, human spaceflight, launchers, telecommunications, navigation, monitoring...
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
DP	Drejtori e Përgjithshme
DPB	Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit
DPTH -	Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit
E-GDDS	Data linked from this page correspond to data described in the International Monetary Fund's DSBB. For a fuller explanation of the DSBB and the enhanced General Data Dissemination System in which Country participates
NSDP	National Summary Data Pages
MBP	Menaxhimi Borxhit Publik
PRE (ERP)	Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë
PPP	Partneritetit Publik Privat
PP	Pikë Përqindjeje
BME	Bashkimi Monetar European



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

INSTAT	The Institute of Statistics (INSTAT) (Albanian: Instituti i Statistikës), is the statistical agency of Albania
FISIM	On loans, FISIM is the difference between interest receivable and the interest cost of funds calculated at a reference rate on the loan balance. On deposits, FISIM is the difference between interest payable at the reference rate on the deposit balance and interest actually payable to depositors.
COICOP	The Classification of individual consumption by purpose, abbreviated as COICOP, is a classification developed by the United Nations Statistics Division to classify and analyze individual consumption expenditures incurred by households, non-profit institutions serving households and general government according to their purpose.
TFP	Tabelave të Furnizimit dhe Përdorimit
SSB	Statistikat Strukturore të Biznesit
SAMB	Strategjitë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit
SAS	Statistikat AfatShkurtra
SFP	Statistikat e Forcave të Punës
SIMFSH (AFMIS)	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Financave të Shqipërisë (Albanian Financial Management Information System)
SIQMFSH (AGFIS)	Sistemi Informatik Qeveritar i Menaxhimit të Financave të Shqipërisë (Albanian Government Financial Information System)
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SWOT	Matrica SWOT
ASP	Albanian School of Public Administration
BI	Budget Institutions
BoA	Bank of Albania
CHU	Central Harmonization Unit
DG	Directorate of Government



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

DIEPP	Department for Indemnification of Ex-Political Persecuted Persons
DMFAS - UNCTAD-	Debt Management and Financial Analysis System
DOPA	Department of Public Administration
DTS	Donor Technical Secretariat
DU EI	Delivery Unit European Integration
EQA	External Quality Assurance
EPSAS	European Public Accounting Standards
ERP	Economic Reform Program
EU	European Union
FI	Financial Inspection
KMF (FMC)	Kontrolli Menaxhimit Financiar (Financial Management Control)
GDP	Gross Domestic Product
GDT	General Directorate of Taxation
GoA -	Government of Albania
SFQ (GFS)	Statistikat Financiare Qeveritare (Government Finance Statistics)
HRMIS	Human Resources Management Information System
HSC	High State Control
AB (IA)	Audit i Brendshëm (Internal Audit)
IFMIS	Integrated Financial Management System
IMF	International Monetary Fund
INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions
INP (IPA)	Instrument për Ndihmën Para-pranimi
IPS	Integrated Planning System
SNKSP (IPSAS)	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (International Public Sector Accounting Standards)
SIMSPI (IPSIS)	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (Integrated Planning System Management Information Systems)
ISSAI	International Standards for State Audit Institutions



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

IU	Institutional Unit
MEI	Ministry of European Integration
MOE	Ministry of Economic Development, Tourism, Trade and Entrepreneurship
MOF	Ministry of Finance
MFE	Minsitria e Financave dhe Ekonomisë
PBAM (MTBP)	Programi Buxhetor Afat Mesëm Medium-Term Budget Program
NDSI	National Strategy for Development and Integration
NPEI	National Plan for European integration
OPM	Office of Prime Minister
OBL	Organic Budget Law
PAR	Public Administration Reform
PBG	Policy Based Guarantee
PEFA	Public Expenditure and Financial Accountability
PFIC	Public Financial Internal Control
MFP (PFM)	Menaxhimi Financiar Publik (Public Financial Management)
PIFC	Public Internal Financial Control
MPI (PIM)	Menaxhimi Publik i Investimeve (Public Investment Management)
PPA	Public Procurement Agency
SAI	Supreme Audit Institution
SECO	State Secretariat for Economic Affairs
SIGMA	Support for Improvement in Governance and Management
SMFP	Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike
SOE	State Owned Enterprise
SPC	Strategic Planning Committee
TSA	Treasury Single Account



KAPITULLI I: SFONDI I STUDIMIT

1.1. Hyrje

Proçesi i integritit europian për pothuajse tre dekada ka përfaqësuar një çështje thelbësore për Shqipërinë dhe partitë politike në qeverisje apo opozitë. Ky proçes ka evoluar gradualisht disa herë më shpejt dhe disa herë më ngadal por disa herë edhe duke u përkeqësuar. Shqipëria aktualisht ende nuk e ka marrë statusin e "vendit kandidat" pavarësisht se ka *pothuajse një dekadë që e pret për të marrë*. Bazuar në Raport Progresin, Shqipëria duhet të përmbushë kriteret bazuar në kriteret e Kopenhagës, përkatësisht ekonomike, politike dhe ato të *acquis Communautaire*.

Të gjitha këto janë vendimtare për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian (BE). Gjithashtu, kriteret e tjera për të cilat shteti Shqiptar ka punuar dhe angazhohet të punojë për përmbushjen e tyre për anëtarësimin në BE kanë lidhje me kriteret e Mastroitit (kriteret e konvergencës), ku përfshihen: *kriteret e Politikës Fiskale*, stabilitetin e çmimeve, stabilitetin e kursit të këmbimit dhe kriterit të normës afatgjatë të interesit. *Duke pasur parasysh dinamikën dhe aspiratat kombëtare, përputhja e treguesve makroekonomikë shqiptarë me kriteret e Mastroitit fiton një rëndësi të veçantë.*

Politika makroekonomike është një grup masash politike përmes të cilave politikëbërësit kërkojnë të ndikojnë në gjendjen e ekonomisë dhe në këtë mënyrë të përmbushin objektiva të ndryshëm ekonomik dhe jo-ekonomik. Në përgjithësi, këto masa politike mund të ndahen në dy instrumente kryesore të politikës makroekonomike: politika fiskale dhe politika monetare. Politika monetare, e cila është në fushën e Bankave Qendrore, paraqet përdorimin e instrumenteve të drejtuara drejt qëllimit kryesor të stabilitetit të çmimeve, të favorshme për një rritje të qëndrueshme ekonomike.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Në të kaluarën, Bankat Qendrore të cilat zakonisht janë të pavarura në lidhje me autoritetet politike ekzekutive u përpoqën t'i përmbushin ato objektiva në mënyra të ndryshme. Për shembull, duke e lidhur sasinë e parave në qarkullim me sasinë e materialeve të çmuara dhe duke synuar rritjen e furnizimit të parave në qarkullim (karakteristikë e monetarizmit), shkallën e inflacionit ose PBB-së nominale etj. (Jahan & Papageorgiou, 2014; Thornton, 2012).

Në dekadat e fundit, është krijuar një shembull i një regjimi optimal të politikës monetare që synon një normë të caktuar të inflacionit bazuar në ndryshimin e normës ndërbankare për kreditë njëditore. Një strategji e tillë e politikës monetare mund të përshkruhet në një mënyrë të thjeshtuar me parimin Taylor (1993), me ç'rast synohet që norma nominale e interesit të Bankës Qendrore të përcaktohet si divergjencia funksionale e nivelit aktual të PBB-së nga PBB-ja e mundshme si edhe nga norma e interesit aktuale me normën e interesit të synuar (shiko Davig & Leeper, 2007; Kahn, 2010).

Ndërsa, koncepti i politikës fiskale nënkupton përdorimin e instrumenteve të politikës fiskale për të përmbushur objektivat e qeverisë dhe literatura bashkëkohore makroekonomike krahas politikës monetare sot po e vë theksin në evidentimin e objektivave afatshkurtra ashtu dhe objektivave afatgjata të politikave fiskale [Romer, (2006)].

1.2 Politika fiskale dhe realiteti shqiptar

Qeveritë e Shqipërisë për çdo vit ndërtojnë buxhetin sipas zërave përkatës në mënyrë që të ndikojnë në rritjen ekonomike dhe në këtë mënyrë të arrijë objektivat e ndryshme ekonomike, sociale dhe politike. Në njërin anë, buxheti përfshin përbërësit e shpenzimeve qeveritare dhe, nga ana tjetër, përbërësit e të ardhurave të qeverisë. Ekuilibri i përgjithshëm midis këtyre dy përbërësve përcakton bilancin e përgjithshëm të buxhetit të qeverisë ose bilancin strukturor duke eliminuar përbërësin ciklik të ciklit të biznesit.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Në krahasim me politikën monetare, e cila është më e natyrshme teknokratike, duket se politika fiskale mbulon një perspektivë më normative pasi pasqyron vlerat dhe besimet e përfaqësuesve të degëve ekzekutive në lidhje me atë që do të ishte një sistem ideal ekonomik dhe social për Shqipërinë.

Megjithëse politika fiskale është kryesisht e përcaktuar nga ana politike, historike dhe shoqërore, kjo nuk do të thotë se politika fiskale nuk mund t'i nënshtrohet një analize pozitive ekonomike. Duke parë politikën fiskale historikisht nga këndvështrimi i teorisë ekonomike, ka pasur disa periudha kur politika fiskale ka qenë jo efiçente dhe si rrjedhim e parëndësishme dhe nga ana tjetër ka pasur shumë periudha kohe kur në shoqërinë ekonomike ka ekzistuar mendimi se mekanizmi i transmetimit të politikës fiskale përgjithësisht mund të konsiderohet efektiv për rregullimin e mirë dhe stabilizimin e ekonomisë.

Marrëdhënia mes një defiçiti buxhetor brenda kufirit të 3% të PBB-së dhe borxhit publik deri në 60% të PBB-së nuk duket e qartë për të ardhmen. Por, sipas studimeve të Szapáry & Orbán (2004), dhe Faulend et al. (2005), për një vend me 3% të defiçitetit qeveritar të PBB-së dhe 5% ndaj normës nominale të rritjes së PBB-së, në afat të gjatë borxhi publik do të stabilizohet në nivelin e 60% të PBB-së.

Por, duhet të sjellim në vëmendje se borxhi mesatar publik ndaj PBB-së së vendeve anëtare të BE-së sipas statistikave të periudhës kur u hartuan kriteret e Mastroitit ishte afërsisht 60%. Gjithashtu u vlerësua se shkalla më e mundshme e rritjes së borxhi mesatar publik ndaj PBB-së në vitet që do të vinin do të ishte deri në 5%.

1.3 Kuadri i punimit

Punimi kalon përmes trajtimit të sfidave të integritit të Shqipërisë dhe veçanërisht trajtimit të sfidave të politikës fiskale duke u bazuar në instrumentet politike që përcaktojnë subjektet politike qeverisëse në rast të fitores në zgjedhje. Kjo do të vërtetohet edhe gjatë kapitullit që përmban trajtimin empirik të këtij disertacioni duke evidentuar se politika fiskale ka qenë mekanizëm i realizimit të objektivave të



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

koalicioneve qeverisëse të Shqipërisë me qëllim të përmbushjes së detyrimeve për integrimin në Bashkimin Europian por edhe të nevojave të publikut. Përdorimi i instrumenteve të politikës fiskale nuk duhet të bazohet vetëm në objektivat afatshkurtra por edhe në objektivat afatgjata që kryesisht orientohen në drejtim të plotësimit të kriterëve të politikës fiskale sipas kërkesave për anëtarësim në BE.

Në këtë drejtim ky disertacion bazuar në analizën empirike arrin në konkluzione se qeverisjet e Shqipërisë kanë punuar në drejtim të adresimit të sfidave për plotësimin e kriterit të Politikës Fiskale, dhe disertacioni evidenton tendencat pozitive në plotësim të kriterëve por edhe largim nga objektivi i arritur duke shkuar drejt vijimit të përkeqësimit në plotësimin e kësaj sfide.

1.4 Përcaktimi i problemit

Qëllimi im në këtë hulumtim përfshin identifikimin e sfidave të politikës fiskale për bashkimin në BE të Shqipërisë. Si rrjedhim, qëllimi im kryesor ishte të tregoja disa tregues konkret që gjenden si çështje në mekanizmin e transmetimit të politikës fiskale që mund të ndihmojnë në krahasimin dhe racionalizimin e gjetjeve të mëparshme në këtë fushë për Shqipërinë. Këto gjetje dhe implikimet e tyre së bashku me identifikimin e faktorëve për transmetimin e politikës fiskale në rritjen e PBB-së paraqesin problemin e hulumtuar duke krijuar edhe një bazë të re për hulumtime të ardhshme teorike dhe empirike në këtë fushë nga studiues të tjerë.

Ky problem u ndërtua për zgjidhje përmes identifikimit të gjetjeve të mia të cilat mund të ndihmojnë politikëbërësit se si të koordinojnë punën e tyre në lidhje me ringjalljen dhe arritjen e stabilitetit ekonomik përmes plotësimit të kriterit të politikës fiskale efikase. Në mënyrë të veçantë gjetjet për problemin e këtij studimi japin prova informuese për politikëbërësit që mund të përdoren për të trajtuar problemin në kohën e duhur, në mënyrë që të rivendosin besimin e tregut dhe të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm makroekonomik në të ardhmen.



1.5 Objektivi i përgjithshëm i studimit

Në krahasim me studime të ngjashme, hulumtimi im kontribuon në literaturën ekzistuese duke: a) shtrirë studimin përtej analizës së literaturës edhe me studime empirike bazuar në të dhënat reale të 10 viteve të fundit; b) duke marrë parasysh efektet e mundshme ndërthurëse të borxhit publik në rritjen ekonomike; dhe c) sigurimi i evidencave më të fundit përmes aplikimit të teknikës NOVA dhe ekuacioneve të regresionit për evidentimin e marrëdhënieve mes faktorëve endogjenë dhe ekzogjenë.

Ky hulumtim gjithëpërfshirës në këtë fushë mund të udhëzojë politikëbërësit në lidhje me evidentimin e masave më të përshtatshme ekonomike përmes plotësimit të kriterit të Politikës Fiskale. Ndërkohë që, ekonomia botërore është në një proces të rimëkëmbjes pas recensionit të vitit 2008, politika monetare në Shqipëri e ka humbur rolin e saj dhe ndihet e pafuqishme tashmë, Shqipëria duhet të përballojë edhe pasojat e çështjeve të saj politike dhe katastrofave natyrore dhe pandemike. Analizat e punimeve, raporteve dhe provat e marra nga trajtimi empirik i të dhënave mund të hedhin dritë në fushën e politikës fiskale, e cila pritet të jetë shumë debatueshme në të ardhmen përderisa çështja e integritetit të Shqipërisë në BE mbetet ende e porealizuar.

1.6 .Objektiva specifike

Tema kryesore e studimit të disertacionit është një vlerësim i sfidave të politikës fiskale për Shqipërinë e cila synon të bashkohet BE-së dhe identifikimi i treguesve përmes të cilave sfidat aktuale mund të adresohen. Hulumtimi merr parasysh: 1) një vlerësim të situatës dhe identifikim të faktorëve që pengojnë Shqipërinë për bashkimin e saj me BE-në; 2) një identifikim të treguesve specifik të paplotësuar për kriterin e Politikës Fiskale dhe varësinë e tyre; dhe 3) një vlerësim të faktorëve që



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

ndikojnë në plotësimin e treguesit të borxhit të lartë përmes rritjes së PBB-së dhe identifikimin dhe varësinë e faktorëve në rritjen e mundshme ekonomike të Shqipërisë duke pasur parasysh zhvillimin ekonomik dhe gjendjen e aktivitetit ekonomik në 10 vitet e fundit në Shqipëri.

1.7. Pyetjet për hulumtim

- (i) Çfarë sfidash ka Shqipëria në evidentimin e treguesve ekonomikë për plotësimin e Kriterit të Politikës Fiskale për anëtarësimin e saj në BE?
- (ii) A është ekonomia informale dhe evazioni fiskal sfida kryesore e politikës fiskale të Shqipërisë për integrimin në BE?
- (iii) Cilët tregues të kriterit të Politikës Fiskale kemi plotësuar për anëtarësim në Bashkimin Europian?
- (iv) Cilët tregues të kriterit të Politikës Fiskale nuk kemi plotësuar për anëtarësim në Bashkimin Europian?
- (v) Cila është ecuria dhe prespektivat e PBB-së sipas politikës fiskale të aplikuar nga 2008 në 2018 në Shqipëri?

Hipoteza

Bazuar mbi temën e studimit dhe objektivat e kërkimit, në vijim gjenden hipotezat:

H0: -Shqipëria ka kapërcyer sfidat për plotësimin e treguesve të kriterit të Politikës fiskale për anëtarësimin e saj në Bashkimin Europian.

H1: -Shqipëria ende nuk i ka kapërcyer sfidat për plotësimin e treguesve të kriterit të Politikës Fiskale për anëtarësimin e saj në Bashkimin Europian.



1.8. Rëndësia e studimit

Kërkimi i propozuar në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse kontribuon në literaturën e përgjithshme me prova të reja empirike në lidhje me sfidat e politikës fiskale në aktivitetin ekonomik, i cili është veçanërisht thelbësor për vendet që kërkojnë ti bashkohen BE-së. Për sa i përket rezultateve të pritura, teza kontribuon si në njohuritë akademike ashtu edhe në ato praktike, që ka të ngjarë të jenë të dobishme për politikëbërësit. Përfundimi jep udhëzime se si të zhvillohet një politikë fiskale efikase dhe e koordinuar në lidhje me ringjalljen dhe arritjen e stabilitetit ekonomik. Prandaj, gjetjet e këtij studimi japin prova informuese për politikëbërësit që mund të përdoren për të zgjidhur problemin në kohën e duhur në mënyrë që të rivendosin besimin e tregut dhe të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm makroekonomik për integrimin e natyrshëm të Shqipërisë në të ardhmen në BE.

1.9. Fushëveprimi i studimit

Vetëm disa studime empirike kanë trajtuar sfidat e politikës fiskale për integrimin në BE. Hulumtimi im, mbi të gjitha ofron disa prova të reja empirike në lidhje me çështjen e akumulimit të borxhit publik dhe ndikimin e tij për plotësimin e kriterit të Politikës Fiskale për integrimin në BE. Studime empirike dhe analiza që ju kam bërë atyre tregojnë se përtej një pragu të caktuar borxhi më i lartë publik ul nivelin e mundshëm, i cili mund të tregojë një marrëdhënie jolineare dhe konkave midis borxhit të qeverisë dhe rritjes ekonomike. Literatura në dispozicion sugjeron që vlera kritike e borxhit ndaj PBB-së do të qëndrojë në intervalin midis 85% - 100% për vendet e përparuara dhe **midis 40% -70% për vendet në zhvillim** (Kumar & Woo 2010; ChecheritaWestphal & Rother, 2010; Cecchetti et al., 2011; Reinhart & Rogoff, 2010a, 2010b). Debati për vlerat e pragut është ende shumë i pazgjidhur dhe kërkimi empirik mbi këtë temë është ende i pagarrantuar, veçanërisht në drejtim të llogaritjes së efekteve heterogjene të borxhit të lartë dhe të vazhdueshëm në rritjen ekonomike në të gjithë vendet. Sidoqoftë, provat empirike në kanalet e transmetimit përmes të



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

cilave borxhi i lartë ka të ngjarë të ketë efekte të dëmshme në rritje është mjaft i pakët, veçanërisht në lidhje me vendet në zhvillim në Evropë. Në ndryshim nga studimet e mëparshme, duhet të theksoj se borxhi i qeverisë Shqiptare mbi kufirin e lejuar prej 60% të PBB-së paraqet një pengesë për aktivitetin ekonomik të vendit, për eficientë e politikës fiskale në situata krizash duke ulur kështu efektet e shumëzuesit fiskal dhe si përfundim mos plotësim të treguesit për kriterin e kërkuar për aprovim të anëtarësimit në BE të Shqipërisë.

1.10. Kufizimi i studimit

Ndër kufizimet me thelbësore lidhur me këtë punim mund të rendisim:

- Ndryshimet e shpeshta politike, mungesa e qëndrueshmërisë qeverisëse dhe niveli i konsiderueshëm i ekonomisë joformale të Shqipërisë mund të jetë një problem në vete sa i takon saktësisë së informacioneve të prezantuara.
- Nuk janë konsideruar kanalet e tjera shtesë të transmetimit të efekteve fiskale në aktivitetin ekonomik të Shqipërisë. Në veçanti, do të ishte interesante të vlerësohen efektet fiskale asimetrike të varura nga shteti në variablat e tjerë makroekonomikë, të tilla si konsumi privat, shkalla e papunësisë, investimet private, indeksi i çmimeve të konsumatorit, eksportet neto etj. Kjo sigurisht mund të sigurojë një llogari shumë më të plotë se si funksionon mekanizmi i transmetimit të politikës fiskale në Shqipëri dhe sfidat e saj për integrim në BE. Ky kufizim mund të jetë një fushë studimi shumë interesante në të ardhmen, duke e shtrirë ekzaminimin në mënyrë empirike tek kanalet më të mundshme përmes të cilave ndikimi i zvogëlimit të borxhit publik do të transmetohet në PBB.



1.11. Organizimi i studimit

Ky studim do të jetë i strukturuar në pesë kapituj.

Kapitulli i parë jep një përshkrim të hollësishëm të kriterëve të Kopenhagës dhe Kriteret e Mاستrihtit, duke përfshirë një analizë metodologjike të harmonizimit për secilin kriter.

Kapitulli i dytë i punimit përqendrohet në rishikimin e literaturës për procesin e integritit në BE të Republikës së Shqipërisë, duke nxjerrë në pah progresin dhe ecurinë e Shqipërisë drejt integritit në BE.

Kapitulli i tretë jep një përshkrim të hollësishëm të teknikave dhe modeleve të përdorura për vlerësimin e kriterit të Politikës Fiskale në plotësim të kriterëve të Mاستrihtit dhe faktorët që ndikojnë dhe ndikohen sipas ekuacioneve respektive.

Kapitulli i katërt jep analizën empirike në funksion të hipotezave, pyetjeve kërkimore me qëllim arritjen e objektivave dhe qëllimit të disertacionit.

Kapitulli i pestë jep konkluzionet dhe rekomandimet e këtij punimi për çështje që duhet të merren parasysh nga qeverisjet e Shqipërisë në të ardhmen dhe që mendoj se është një kontribut i vlefshëm për Shqipërinë në këtë fushë.



KAPITULLI II: RISHIKIMI DHE TRAJTIMI ANALITIK PËRMES LITERATURËS

2.1. Politika Fiskale për vendet që i bashkohen BE-së

Historiku 30-vjeçar i politikës fiskale të vendeve që iu nënshtruan transformimit të sistemeve politike dhe ekonomike tregon një ndarje pak a shumë të qartë të eksperiencave në dy grupe kryesore: Vendet që reformuan njëkohësisht sistemin fiskal dhe strukturën institucionale (kryesisht vendet e Europës Qendrore dhe Lindore) për administrimin e tyre morën rezultate të mira dhe të qëndrueshme për sa i përket nivelit të të ardhurave.

Sot në Shqipëri politika fiskale zhvillohet në një kontekst institucional të përmirësuar, dhe struktura tatimore tenton ti përgjigjet nevojave për mbledhjen e të ardhurave publike. Duke u mbështetur në literaturën shkencore por edhe vërtetuar në praktikën financiare shteti përmes politikës fiskale mund të ndikojë drejtpërdrejt në ekonomi dhe zhvillimin e vendit duke ndërtuar politika të mirëfillta ekonomiko-financiare dhe stimuluar sektorë të veçantë me qëllim zhvillimor.

Legjislacioni fiskal ka pësuar ndryshime të vazhdueshme dhe shpesh me lehtësira të mëdha, në të gjitha vendet e Europës Lindore. Vende që tashmë bëjnë pjesë në Bashkimin Europian si Sllovenia, Kroacia, Polonia, Republika Çeke, Bullgaria, Rumania, etj, e kanë modifikuar legjislacionin e tyre fiskal sipas direktivave të BE-së dhe politikave të tyre ndjekin tashmë linjën e politikave europiane. Prej kohësh ata kanë kaluar fazën e tranzicionit dhe ekonomitë e këtyre vendeve kanë arritur të hyjnë në tregun e përbashkët dhe të shfaqen konkurrese, edhe pse në nivele inferiore krahasuar me vendet e perëndimit, të cilat e kanë kaluar me sukses provën e ekonomisë së tregut, për shkak të politikave shumëvjeçare demokratike.

Orientimi i politikave fiskale për vendet që synojnë t'i bashkohen BE-së, duhet të paraprihet nga afrimi i legjislacionit fiskal vendas, dhe shëndoshja e financave



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

publike përmes plotësimit të treguesve të Politikës Fiskale. Orientimi i politikës fiskale në Shqipëri reflekton përgjithësisht një përmirësim të sistemit vetjak , duke u bërë me efikas në mbledhjen e taksave. Kjo ka rezultuar në një tendencë pozitive në rritjen e të ardhurave publike dhe deri diku rënie të evazionit fiskal në rang vendi. Duhet theksuar se shtimi i të ardhurave nga taksat ka ardhur edhe si pasojë e rritjes ekonomike e cila është rritja natyrale e qëndrueshme.

2.2. Objektivat e Politikës Fiskale

Në procesin e formulimit të politikës fiskale, politikbërësit përcaktojnë objektivat të cilat synojnë t'i realizojnë dhe instrumentet me të cilat ato objektiva bëhen të realizueshme, duke iu përmbajtur detyrimisht principeve të menaxhimit fiskal si: a) transparenca lidhur me objektivat, implementimin e politikës fiskale dhe publikimin e llogarive publike; b) stabiliteti i procesit të bërjes së politikës fiskale; c) efikasiteti i ndikimit të politikës fiskale në ekonomi; d) përgjegjësia në menaxhimin e financave publike; e) efikasiteti i modelimit dhe implementimit të politikës fiskale; f) drejtësia (paanësia) duke përfshirë atë ndërmjet gjeneratave.

Objektivat e politikës fiskale lidhen me rritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore si qëllim parësor i një shoqërie bashkëkohore. Kjo mirëqenie sigurohet vetëm në kushtet e një ambienti që e cilësojnë stabiliteti ekonomik, politik dhe social. Pra, kur flasim për objektivat e politikës fiskale do të kemi sipas Tabelës 1. në vijim.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Objektivat e politikës fiskale	Përmbushjen e nevojave publike përmes një sistemi të shëndoshë të financimit publik
	Realizimin e punësimit të plotë
	Rritjen e normës së shtimit ekonomik
	Ruajtjen e stabilitetit të çmimeve
	Stabilitetin e bilancit të pagesave
	Përmirësimin e kushteve të punës duke përfshirë përmirësimin e strukturës kualifikuese të fuqisë punëtore dhe përparimin teknologjik
	Stimulimin e kursimeve
	Stimulimin e investimeve
	Rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore
Rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim dhe shëndetësi	

Tabela 1. Objektivat e Politikës Fiskale

Realizimi i këtyre objektivave varet nga: aftësia e qeverisë për bashkërenditjen e tyre me instrumentet fiskale për të influencuar kompozicionin dhe nivelin e kërkesës agregate; saktësia e analizave makroekonomike lidhur me trendet e indikatorëve kryesorë ekonomik dhe financiar; rregullimi dhe marrëveshjet institucionale për koordinimin e politikave makroekonomike.



2.2.1 Qëndrimet e politikës fiskale

Qëndrimet e Politikës Fiskale janë tre, dhe ato janë si në vijim: neutrale, ekspansioniste dhe shtrënguese.

Një qëndrim neutral i politikës fiskale nënkupton një ekonomi të ekuilibruar. Shpenzimet e qeverisë financohen plotësisht nga të ardhurat e përgjithshme tatimore dhe rezultatet buxhetore kanë një efekt neutral në nivelin e aktivitetit ekonomik. Një politikë fiskale kontraktuese ndodh kur shpenzimet e qeverisë janë më të ulëta se të ardhurat tatimore.

Një qëndrim ekspansionist i politikës fiskale përfshin faktin se shpenzimet e qeverisë tejkalojnë të ardhurat tatimore. Një ekspansion fiskal do të thotë shkurtim i taksave ose rritje e shpenzimeve publike me qëllim të stimulimit të rritjes së konsumit, respektivisht rritjen e kërkesës agregate. Kjo ndodh kur qeveria vëren ngecje apo shtim të ngadalshëm ekonomik ose kur papunësia është e lartë. Kështu, me rritjen e shpenzimeve publike dhe shkurtimin e taksave, individëve dhe firmave u lihet një sasi më e madhe parash për t'i shfrytëzuar në shpenzime konsumi ose investime. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit dhe shtimin ekonomik.

Një qëndrim kontraktues i politikës fiskale ndodh kur shpenzimet e qeverisë janë më të ulëta se të ardhurat tatimore. Politika fiskale shtrënguese do të thotë ulje e shpenzimeve publike dhe rritje e taksave. Kur qeveria synon uljen e kërkesës agregate për të ngadalësuar shtimin ekonomik apo uljen e inflacionit, përcaktohet për drejtimin e politikës fiskale shtrënguese. Nëpërmjet politikës fiskale shtrënguese ulet oferta e parasë e cila më tutje ul shpenzimet dhe kërkesën agregate. Njësoj, ulja e ofertës së parasë bën presion edhe në ngritjen e çmimeve në ekonomi.

Një çështje me rëndësi për qeverinë është përcaktimi lidhur me defiçitin buxhetor dhe borxhin publik, pra a do të mbulohen shpenzimet e rritura ose të pambuluara të



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

qeverisë me financim nga huaja apo emetimi i letrave me vlerë (financimi monetar i defiçitit²).

Vendimet lidhur me politikat fiskale në masë të madhe varen nga konsideratat politike si, besueshmëria dhe roli që luan qeveria në ekonomi por edhe nga reagimet publike lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë. Vendimet e tilla mund të ndikohen edhe nga faktorët e jashtëm që do të thotë se qeveria duhet të marrë parasysh trendet globale ekonomike dhe politikat fiskale të vendeve tjera, të cilat mund të kenë efekt në rialokacion të kompanive vendore.

Qëndrueshmëria fiskale është një nga treguesit më të rëndësishëm të vlerësimit të politikës fiskale. Ajo ka marrë një rëndësi të veçantë gjatë viteve të fundit për shkak të efekteve negative që u vunë re në Greqi, Spanjë, Irlandë, Turqi, etj. *Një politikë fiskale e qëndrueshme do të thotë që borxhi publik në termat e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nuk ka prirje pozitive.*

Megjithatë, literatura teorike fokusohet në atë që politika korente fiskale mund të ndiqet për një periudhë të pacaktuar pa ndikuar në fuqinë paguese të qeverisë, e cila nuk nënkupton domosdoshmërisht që borxhi publik duhet të mos ketë prirje pozitive. *Një kriter tjetër për të vlerësuar nëse një politikë fiskale është e qëndrueshme apo jo është edhe kushti që norma e parashikuar e rritjes së borxhit publik duhet të jetë më e vogël se norma e interesit gjatë një periudhe afatgjatë.*

Niveli i borxhit publik ka qenë dhe është një çështje e debatueshme edhe për Bashkimin European. Niveli i borxhit publik është një nga kushtet e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike, i nënshkruar në vitin 1997 si *element i Traktatit të Maastricht*. *Vendet e BE-së që kanë nënshkruar këtë pakt nuk lejohen të kalojnë nivelin e borxhit publik mbi 60% e PBB, dhe ato vende që e kanë më të lartë duhet të*

² Borxhi Publik në këtë artikull i referohet treguesve në përqindje ndaj PBB



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

bëjnë përpjekje për ta ulur. Ky nivel është rezultante e disa llogaritjeve matematikore bazuar në literaturën makroekonomike, dhe gjithashtu është objekt diskutimi dhe debatesh, por ai na jep sinjalin që nivelet e borxheve publike duhet të studiohen me kujdes nga politikëbërësit. Borxhet publike shfaqen pasi qeveritë kryejnë më shumë shpenzime se niveli i të ardhurave të tyre korente. Gjatë viteve të tranzicionit, të gjitha qeveritë e shumta në vendin tonë kanë operuar me nivele shpenzimesh më të larta se niveli i të ardhurave. Situata ekonomike e sociale mbi të cilën filloi epoka e re drejt ekonomisë së tregut e bënte të pashmangshme ndërhyrjen e shtetit në ekonomi nëpërmjet subvencioneve dhe investimeve publike.

Për Shqipërinë, niveli i borxhit publik në vitin 1996 ju afrua normës prej 60 përqind të PBB, dhe në vitin 1997 ai ishte mbi 70 përqind të PBB. Ndjekja e një politike fiskale, me rritjen e TVSH nga 12.5 përqind në 20 përqind dhe kontrolli mbi shpenzimet publike bënë të mundur që niveli i borxhit publik në fund të vitit 2004 të zbriste në rreth 55 përqind e PBB-së. Me këtë nivel borxhi publik ndaj PBB-së u vazhdua pothuajse deri në vitin 2008. Pas këtij viti borxhi publik ndaj PBB-së ka njohur rritje shumë të madhe duke arritur në 72.7% në vitin 2016 dhe kjo përbën dhe ngritjen kulmore më të lartë të borxhit publik ndaj PBB-së. Pas këtij viti ky raport ka ardhur duke u përmirësuar por ende vazhdon të jetë mbi kufirin e lejuar.

Për aq sa vet treguesit flasin, Shqipëria ka pasur një kujdes të mirë për ruajtjen e treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së deri në vitin 2011. Duke nisur që nga viti 2012 kemi thyerje të treguesit dhe si pasojë Shqipëria është në mosplotësim të treguesit. Lidhur me financimin e borxhit publik të Shqipërisë nga burimet e brendshme të kapitalit, gjatë viteve të fundit dhe tendenca për vitet në vazhdim do të vijë gjithnjë e në ulje.



2.3. Roli i Politikës Fiskale për stabilitetin ekonomik

Financat publike paraqesin studimin e rolit të qeverisë në ekonomi. Një funksion kryesor ekonomik i financave publike, përveç funksionit të alokimit dhe rishpërndarjes, është promovimi i stabilitetit ekonomik. Funksioni i stabilizimit të financave publike mishëron përdorimin sistematik dhe të qëllimshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisë me qëllim të ndikimit të politikës ekonomike në drejtim të objektivave të ndryshëm makroekonomikë, duke përfshirë punësimin e lartë, rritjen ekonomike pozitive dhe të qëndrueshme, dhe një llogari rrjedhëse të përshtatshme për bilancin e pagesa (Blanchard, 2010; Stanovnik, 2008).

Përdorimi me efikasitet i politikës fiskale nga qeveritë e vendeve të vogla kërkon planifikim gjithnjë e më të informuar të politikave dhe koordinim të organizuar mirë brenda institucioneve të çdo qeverie. Ndërkohë që nga institucionet ndërkombëtare të cilat bëjnë vlerësime për efekt të investitorëve institucionalë dhe partnerëve ndërkombëtarë të një vendi të vogël apo të mesëm, ky proces i vlerësimit të efikasitetit të politikës fiskale i nënshtrohet mbikëqyrjes fiskale ex-ante dhe ex-post nga palët e jashtme, duke përfshirë, në kuptimin më të gjerë edhe tregjet financiare.

Bazat ekonomike dhe fiskale si edhe shkalla në të cilën ky proces - i nënkuptuar ose i qartë - i mbikëqyrjes fiskale kryhet në mënyrë të rregullt, ka shumë rëndësi, dhe ndikon në vlerësimin dhe sjelljen e investitorëve dhe tregjeve financiare ndërkombëtare por edhe lokale. Vlerësimi i performancës së politikës fiskale të një vendi reflektohet menjëherë në ngritjen ose uljen e kostos eventuale për sa i përket normave të interesit të borxheve dhe si pasojë çmimit për të paguar pabarazitë fiskale.

Brenda Bashkimit Europian, koordinimi dhe mbikëqyrja e politikave ekonomike, veçanërisht politikave fiskale synojnë të sigurojnë që Shtetet Anëtare të konsiderojnë politikave të tyre ekonomike si një çështje me interes të përbashkët dhe t'i zbatojnë këto politika me qëllim që të kontribuojnë në objektivat e Komunitetit, veçanërisht rritja e qëndrueshme dhe jofinanciare, një nivel i lartë i punësimit dhe mbrojtjes sociale, konvergenca e performancës ekonomike dhe kohezioni ekonomik dhe shoqëror.

Proçesi i mbikëqyrjes shumëpalëshe të BE-së, në të cilin marrin pjesë të gjitha vendet anëtare, është bërë një element kryesor për hartimin dhe koordinimin e politikave makro-ekonomike brenda Bashkimit Europian. Objektivat pas koordinimit të politikave ekonomike të BE-së janë, mutatis mutandis, të vlefshme për vendet e treta



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

duke e bërë BE-ja një palë gjithnjë e më shumë aktive në një arenë më të gjerë siç është mbikëqyrja fiskale.

BE gjithmonë inkurajon konsolidimin fiskal, planifikimin dhe mbikëqyrjen e politikës makro-ekonomike dhe fiskale, veçanërisht me qëllim të përhapjes së stabilizimit dhe rritjes ekonomike tek vendet anëtare, vendet kandidate dhe vendet kandidate të mundshëm, por edhe tek vende të tjera në botë pavarësisht afërsisë së tyre gjeografike me BE-në. Në këtë punim vlerësohen arritjet kryesore të Shqipërisë në lidhje me konsolidimin fiskal por kryesore është që evidentohen edhe përmirësimet e nevojshme që duhet të kryhen në lidhje me mirë qeverisjen e financave publike.

Përmes analizës së literaturës për këtë çështje rezulton se:

- ✓ është shumë e vështirë të krijosh progres kur trajton njëkohësisht përputhshmërinë midis mbikëqyrjes dhe objektivave të pranimit në BE me ato të arritjeve të konsolidimit fiskal për vendet në zhvillim si Shqipëria;
- ✓ perspektivat e kombinuara të anëtarësimit në BE dhe kufijtë e ngushtë të manovrës në lidhje me makro- përzierjen e politikës ekonomike me sa duket kanë pasur një rol të fortë nxitës në bindjen e autoriteteve fiskale të vendeve kandidate dhe atyre potenciale për kandidatë për të miratuar politika të përgjithshme të kujdesshme fiskale.
- ✓ Rritja e qëndrueshme lejon rritjen e të ardhurave fiskale dhe zvogëlimin e defiçitit, të cilat nëse mirë qeverisen arrijnë një financim më të lehtë për shkak të operacioneve të shumta të privatizimit që kanë pasur vende si Shqipëria të cilat i përkisnin kampit të vendeve komuniste me ekonomi të centralizuar.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- ✓ Sfida e Shqipërisë për të ardhmen e afërt do të jetë për të rregulluar modelin e konsolidimit fiskal duke kufizuar madhësinë e qeverisë, duke hapur më tej hapësirën fiskale për një zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit privat të cilat mund të çojnë në reduktimin e borxhit publik ndaj PBB-së si tregues kyç i paplotësuar për sfidat e politikës fiskale të Shqipërisë drejt BE-së.

2.6.1 Situata ekonomike dhe fiskale e Shtetit Kandidat

Aktualisht, ka disa vende kandidatë nga Ballkani të tilla si: Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe së fundmi edhe Shqipëria. Dhënia e statusit bëhet në përputhje me kriteret e pranimit të Kopenhagën. Nërkohë që vendet candidate duhet të përgatitin të plotësojnë kriteret për pjesëmarrjen në mbikëqyrjen shumëpalëshe ekonomike sipas procedurave të koordinuara të politikave aktuale me vendet anëtare të BE-së.

Politikat e shëndosha buxhetore dhe fiskale dhe qëndrueshmëria e tyre kanë rëndësi për të gjitha vendet por me rëndësi të veçantë këto janë për vendet që pretendojnë për anëtarësim në BE dhe të cilat përgatiten për të plotësuar detyrimet sipas Traktatit të përcaktuar për tu bërë shtet anëtar i BE-së. Për këtë qëllim, një mbikëqyrje fiskale para pranimit është vendosur si kusht në vitet e fundit për vendet candidate. Kjo mbikëqyrje fiskale është një procedurë e përdorur për parandalimin e risqeve që mund të ndikojnë buxhetin e BE -së.

Mbikëqyrja fiskale para pranimit përbën një vlerësim për ekuivalentimin me fiskalin e Shteteve Anëtare si edhe njoftimin dhe paraqitjen e çështjeve për tu adresuar në programin e stabilitetit të vendit kandidat.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Këto instrumente u ofrojnë vendeve kandidate mundësinë për të përshtatur gradualisht kornizën e tyre të politikës fiskale me standardet e BE-së, të sigurojnë mbështetje në përgatitjen e anëtarësimit në BE, dhe lehtësojnë procesin e vëzhgimit që do t'ju bëjnë vendet anëtare dhe adaptimin e rekomandimeve në politikat e duhura. Ky bashkëpunim ndër gjithë këto vite ka qenë reciprokisht i dobishëm.

Në funksion të rregullave të BME (EMU-së, European Monetary Union⁹), një nga përparësitë dhe pretendimet kryesore për vendet kandidate që ato të vijjnë në një linjë me vendet anëtare është: *raportimi, monitorimi dhe kontrolli i financave publike, dhe në veçanti për politikën fiskale dhe pozicioni i saj krahasuar me procedurat aktuale të BE-së.*

Në vitin 2001, Komisioni Europian inicioi bashkërisht me vendet kandidate një iniciativë të re, të quajtur "proçedura e mbikëqyrjes fiskale para pranimit". Kjo proçedurë ndjek nga afër, por në një mënyrë të thjeshtuar, proçedurat e përhershme të mbikëqyrjes fiskale për shtetet kandidate. Sipas kësaj proçedure, vendi kandidat duhet të përgatisin Pogramet Ekonomike të Para-anëtarësimit, me synimin për të ndërtuar një kornizë politikash të përshtatshme afatmesme, përfshirë objektivat e financave publike dhe përparësitë e reformës strukturore të nevojshme për pranimin e BE-së.

Këto programe ofrojnë një mundësi për të zhvilluar aftësitë e nevojshme institucionale dhe analitike për të marrë pjesë në EMU, veçanërisht në fushat e mbikëqyrjes multilaterale dhe koordinimin e ekonomisë dhe politikës fiskale.

⁹ Unioni Ekonomik dhe Monetar (EMU) paraqet një hap të madh në integrimin e ekonomive të BE-së. Unioni Monetar (EMU) është një term ombrellë për grupin e politikave që synojnë konvergjinë e ekonomive të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Proçedura parashikon një dimension shumëpalësh të rëndësishëm duke përfshirë një mundësi për Shtetet Anëtare dhe vendet kandidate për të diskutuar programet ekonomike. Vendet kandidate janë të ftuar të marrin pjesë në takimet shumëpalëshe me zyrtarë të nivelit të lartë nga ministritë e ndryshme të financave të Shteteve Anëtare. Në këto takime, shërbimet e Komisionit prezantojnë vlerësimin e programeve ekonomike sipas çdo vendi kandidat përkatës. Për më tepër vendet kandidate mund të sigurojnë të paraqesin një prezantim me shkrim të punës së tyre gjatë mbledhjes. Ky prezantim mund të përfshijë ndër të tjera edhe një azhurnim të zhvillimeve të kohëve më të fundit dhe një përgjigje paraprake ndaj gjetjeve sipas vlerësimit paraprak të Komisionit.

Komisioni gjithashtu i paraqet Këshillit ECOFIN vlerësimin e tij të para-anëtarësimit, programet ekonomike dhe konkluzionet e takimeve shumëpalëshe. Më në fund, këto gjetje bëhen publike¹⁰.

Aderimi në BE nuk kërkon nga vendet kandidate vetëm që ato të mund të përmbushin nga ana nominale kriteret e konvergjencës së Mastroihtit, por kërkohet përmbushja e treguesve në përputhje me kriteret e pranimit të Kopenhagës¹¹.

¹⁰ In the Series of ECFIN Occasional papers, e vlefshme tek http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/occasional_papers/2007/occasionalpapers31_en.htm

¹¹ Kriteret e Kopenhagës kërkojnë që për anëtarësim, "një vend kandidat ka arritur stabilitetin e institucioneve, garantimin e demokracisë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve, ekzistencën e një ekonomie funksionale të tregut si dhe aftësia për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Anëtarësimi presupozon aftësinë e kandidatit për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshirë këtu aderimin në qëllimet e politikës, bashkimi ekonomik dhe atë monetaryl.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Në periudhën e paravlerësimit, shqetësimi kryesor është qëndrueshmëria fiskale afatmesme, në vend se arritja e ndonjë objekti të veçantë fiskal. Prandaj, vlerësimi i defiçitit për sa i përket PBB-së ka të ngjarë të ketë të bëjë me shpejtësinë e reformave strukturore, me shpejtësinë relative të rritjes ekonomike, shtrirjen e konvergencës reale si dhe bilancin e kursim-investimit të atij vendi.

Njoftimet fiskale. Funkcionimi i qetë dhe efektiv i Bashkimit Ekonomik dhe Monetar kërkon një qasje të koordinuar, shumëpalëshe të mbikëqyrjes së politikës fiskale. Kjo, nga ana tjetër, kërkon një sistem të sofistikuar informacioni për buxhetin operacional, duke u mbështetur në standardet e përcaktuara qartë të kontabilitetit, si edhe në kapacitete të mira administrative dhe analitike. Çdo gjashtë muaj, nga çdo Shtet Anëtar kërkohet që të përgatisë dhe dërgojë Komisionit të dhëna mbi borxhin qeveritar, nivelet e defiçitit fiskal dhe të dhëna të rregjistruara sipas standardeve të kontabilitetit ESA 95 deri në vitin 2010 kur u kërkua për aplikim ESA 2010.

Që nga viti 2001, vendeve kandidate u është kërkuar që edhe ato të bëjnë një njoftim vjetor në të njëjtën linjë si Shtetet Anëtare, me qëllim përgatitjen e tyre për anëtarësim. Format i këtij njoftimi është në thelb identik me atë të ndërmarrë aktualisht nga Shtetet Anëtare, megjithëse frekuenca është vjetore (në vend të gjysmëvjetorit për Shtetet Anëtare).

Ushtrimi i njoftimit para-pranimit së bashku me vlerësimin e tij shërbejnë për disa objektiva:

- ✓ Së pari, siguron që secili vend kandidat të dëshirojë të jetë në gjendje të pajtohet me ESA 95 (ose ESA 2010) standardi kombëtar i kontabilitetit deri në datën e pranimit.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- ✓ Së dyti, të dhënat e njoftimit, të parashikuara gjatë periudhës para pranimit lejojnë analiza efektive ekonomike të buxhetit aktual për pozicionet e vendeve kandidate.
- ✓ Së treti, raportimi dhe llogaritja e pozicioneve fiskale brenda vendeve kandidate në mënyrë progresive bëhet i krahasueshëm me ato të Shteteve Anëtare të BE-së

Drejtorja e Përgjithshme e Komisionit për çështjet ekonomike dhe financiare dhe Eurostat prodhojnë një vlerësim të këtyre raportimeve fiskale dhe ato janë të publikuara¹².

Ky vlerësim shqyrton cilësinë dhe besueshmërinë e defiçitit (ose tepicës) së njoftuar dhe shumën e borxhit publik, si edhe shkallën e pajtueshmërisë së të dhënave të njoftuara sipas standardeve të kontabilitetit ESA 95 (ESA 2010).

2.6.2 Programi Ekonomik dhe Fiskal për vendet kandidate si Shqipëria

Në vitin 2006 për vendet kandidate potenciale nga Ballkani Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia), u aplikua një tip i ngjashëm programi si ai i programit të para vlerësimit ekonomik, por pak më i lehtë se në rastin e vendeve kandidate (veçanërisht pa rishikim shumëpalësh ministror)¹³.

¹² http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/occasional_papers/2007/occasionalpapers33_en.htm

¹³ Kosova ende nuk është e detyruar të paraqesë një të tillë program. Sidoqoftë, donatorët, përfshirë **BE-në**, kërkoi që Kosova të prodhojë çdo vit një Afat të Mesëm Kuadri i Shpenzimeve (KASH) i cili në një masë të madhe shërben për të njëjtin qëllim të mbikëqyrjes fiskale. Duke pasur parasysh situatën e cënueshme e llogarive publike të Kosovës, sugjeroi paketën e zgjidhjes së të dërguarit të posaçëm të KB krijimi i një mekanizmi të mbikëqyrjes fiskale midis autoriteteve dhe Komisionit, në bashkëpunim me FMN, për të siguruar që publiku i Kosovës llogaritë mbeten në një udhë të qëndrueshme.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Dialogjet e rregullt zhvillohen në nivelin teknik për çështje të sektorit makroekonomik dhe financiar, veçanërisht me vendet kandidate dhe kandidate të mundshëm si ato të Ballkanit Perëndimor. Këto dialogje zhvillohen normalisht brenda nën-komiteve të specializuara e krijuara nën marrëveshje bilaterale të lidhura me këto vende (shoqatë, partneritet dhe bashkëpunim, ose marrëveshjet e tregtisë dhe bashkëpunimit).

Ndërsa këto dialogje mund të adresojnë një varg çështjesh (zhvillime të vërteta ekonomike, politika monetare, politika fiskale dhe zhvillimet, reformat strukturore), të dhënat dhe treguesit mbi çështjet fiskale duke pasur parasysh rolin thelbësor të instrumenteve fiskale në përzierjen e politikës makro-ekonomike në shumë nga vendet partnere, të cilat përballen me veprim të kufizuar në lidhje me politikën monetare.

Konsolidimi fiskal ka qenë një qëllim i qartë i qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat në kthesën e mijëvjeçarit në të shumtën e rasteve ishin përballur me pozicion të dobët fiskal dhe borxh publik mesatar dhe të lartë. Shumë reforma dhe politika të brendshme kanë qenë të detyruara nga bashkëpunimi dhe marrëveshjet e arritura me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

FMN ka kontribuar ndjeshëm në stabilizimin makroekonomik dhe veçanërisht lidhur me bilancin e pagesave dhe konsolidimin fiskal.

Në funksion të një situatë makro-ekonomike të përmirësuar dhe perspektiva e disa programeve të mbështetura me fonde si p.sh. në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, kanë vënë theksin e fortë në reformat strukturore.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Sidoqoftë, zhvillimet e fundit në vendet e mundshme kandidate evidentojnë që autoritetet apo qeveritë e këtyre vendeve kanë qenë më pak të prirur për t'u përfshirë në marrëveshje zyrtare me FMN, për shkak të një numri kufizimesh që obligon bashkëpunimi i tyre me FMN.

Agjensitë e vlerësimit të kredisë gjithashtu luajnë një rol të përhershëm në skenën e mbikëqyrjes fiskale dhe një pjesë e vlerësimit të tyre është drejtuar drejt monitorimit të rreziqeve të huave sovrane dhe mundësitë e mospagimit të borxhit publik nga qeveritë e shteteve respektive.

2.6.3 Trendi i konsolidimit fiskal për vendet kandidate si Shqipëria

Pozicionet fiskale janë përmirësuar dukshëm për vendet kandidate të mundshme krahasuar me vitin 2000. Në secilin nga katër vendet kandidate defiçiti i përgjithshëm i qeverisë ishte në mënyrë progresive ulur gjatë periudhës 2002-2010, pas një rritje në 2001 e cila nuk kishte ndonjë korrelacion të qartë të përbashkët në rajon.

Ndërsa nga viti 2011 në Shqipëri filloi rritja e borxhit publik i cili arriti kulmin në vitin 2015 dhe më pas u pasua nga rënia në vitet 2016-2018 dhe për vitin 2019 parashikohet që ky tregues t'i jetë rikthyer trendit në rritje. Përmirësim në këto vite ka pasur ulja e defiçitit sidomos në vitet e fundit të periudhës 2016-2018. Në Shqipëri, konsolidimi fiskal lidhur me defiçitin këto 4 vitet e fundit mund të konsiderohet spektakolar pasi defiçiti është zvogëluar nga 5.7% në 1.6%.

Mesatarisht progresi i kryer në këtë 10 vjeçarim e fundit për vendet kandidate të mundshme, tendenca e përgjithshme ka shfaqur gjithashtu një shkallë impresionuese të konsolidimit të përgjithshëm të bilancit të qeverive të tyre. Në përgjithësi, si për vendet kandidate ashtu edhe për vendet kandidate potenciale, numri i episodeve të



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

favorshme (përcaktuar si përmirësime vjetore në përgjithësi të bilancit të qeverisë) tejkalojnë dukshëm episodet negative. Përkeqësimet e situatave financiare në shumicën e rasteve kanë qenë në periudha afat shkurtër dhe pas kësaj është rikthyer tendenca e përmirësimit fiskal.

Borxhi publik përgjithësisht është ulur në këto vitet e fundit për të dy grupet e vendeve si ato kandidatë edhe ato që konsiderohen si vende potenciale kandidatë duke pasqyruar konsolidimin fiskal i cili ndërkohë ka zhvilluar kapacitetet për mbështetje parësore për çdo sektor që sjell zhvillim të konsiderueshëm.

Që nga viti 2016, Shqipëria ka pasur një ulje të raportit të borxhit publik të saj përgjatë këtyre viteve të fundit, edhe pse jo shumë të dukshëm në realitet. Kjo ulje është mbështetur nga një ulje e vazhdueshme në defiçitin e saj fiskal. Përmirësimet në bilancin fiskal kanë mbështetur Shqipërinë më tej në një ulje të nivelit të borxhit publik. Megjithatë, një sasi e madhe e detyrimeve të brendshme të papaguara dhe të mbartura për punime dhe PPP-të do t'i shtojnë shifrat aktuale të borxhit publik duke i bërë thirrje qeverisë për vazhdimin e politikave fiskale të kujdeshme.

Rregullimi i treguesve fiskalë për Shqipërinë paraqitet njësoj si për vendet kandidatë dhe ato potencial për vende kandidatë ku evidentohet se përmirësimi *ka qenë gjatë kësaj periudhe kryesisht i arritur përmes rritjes së të ardhurave dhe uljes së detyrimit për pagesa të interesave të borxheve dhe nuk erdhi nga ulje të shpenzimeve të qeverive*. Në një masë të madhe rritja e të ardhurave është nxitur nga aktiviteti i përgjithshëm ekonomik në rritje kryesisht të ndikuar nga kushtet e jashtme. Prandaj, është më pak e qartë se sa domethënës konsolidimi në terma të rregulluar në mënyrë ciklike.



2.6.4 Aplikimi i Mirëqeverisjes Fiskale

Rregullat fiskale mund të kontribuojnë në konsolidimin fiskal dhe rregullimin makro-ekonomik, duke bërë angazhimin e autoriteteve për arritjen e një objektivi dhe detyrimin për sinjalizimin transparent ndaj publikut të gjerë, në veçanti tregjet financiare. Gjatë gjithë procesit të gjatë të para-anëtarësimit, rregullat fiskale të BE-së ndikojnë në vendet kandidate për përcaktimin e politikave të mundshme të tyre. Sidoqoftë, edhe në rastin e vendeve kandidate, BE nuk po kërkon pajtueshmërinë menjëherë me rregullat fiskale të EMU-së. Për më tepër, në një fazë të hershme të tranzicionit këto rregulla nuk mund të përshtaten gjithmonë me gjendjen ekonomike dhe fiskale të vendeve përkatëse. Ndërsa miratimi i rregullave të duhura fiskale në fund të fundit varen nga autoritetet e secilit vend.

FMN-ja këmbëngul në një numër të madh çështjesh lidhur me konsolidimin fiskal të vendeve kandidate apo potenciale, por për një prej tyre FMN këmbëngul më fortë. Ajo është kërkesa që ka të bëjë me rritjen e potencialit, mirëqeverisjen dhe besueshmërinë e autoriteteve (vendeve) huamarrëse.

Lidhur me sistemet e kontabilitetit publik në shumicën e vendeve kandidate apo potenciale për kandidate pati një përmirësim në mënyrë progresive gjatë viteve të fundit, me prezantimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Në shumicën e rasteve, kandidatët dhe vendet e mundshme kandidate u prezantuan për herë të parë me Standardet e GFS, shpesh të ndikuara nga FMN për mbikëqyrjen fiskale në kontekstin e programeve të mbështetura nga FMN. Të dhënat fiskale megjithatë nuk janë gjithandej, plotësisht në përputhje me GFS.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Sa i përket vendeve kandidate, perspektiva e BE-së tashmë ka çuar në miratimin e standardeve ESA 2010. Midis të gjitha vendeve kandidate, Shqipëria ishte ndër të parat që publikoi të dhënat e qeverisë sipas standardeve ESA 2010.

Centralizimi transaksioneve financiare të qeverisë në një llogari të vetme në Ministrinë e Financave janë parakusht për menaxhimin e borxhit, dhe kështu shpesh një nga të parat masa për t'u futur në tranzicion të ekonomive drejt EMU-së. Ndër vendet kandidate dhe ato potenciale, vendi i fundit që krijoi një thesar të vetëm nga ku menaxhoheshin të gjitha transaksionet financiare të qeverisë ishte Mali i Zi (2002).

Llogari të tjera të shumta për llogari të borxhit vazhdojnë të ekzistojnë pothuajse në të gjitha vendet kandidate apo potenciale pavarësisht se numri i llogarive ka ardhur duke u kufizuar. Kjo është një situatë që jo vetëm që zvogëlon transparencën dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin e llogarive dhe parave publike duke rritur borxhin, por që gjithashtu mund të rritet rreziku i keqmenaxhimit të parave të hedhura në qarkullim dhe të mos shkojnë në destinacionin e duhur kur mund të kishin edhe efektivitet më të madh.

Kontrolli i brendshëm i financave publike. Theksi në rritje po i kushtohet kontrollit të brendshëm dhe kontrollit në administratat publike në të gjithë botën, si një element kryesor i përmirësimit të menaxhimit të financave publike. Për më tepër, kjo është domosdoshmëri për grupin e vendeve nën konsideratë për tu integruar në BE. Në 10 vitet e fundit janë marrë disa hapa konkrete drejt krijimit dhe funksionimit efikas të kontrollit dhe auditimit të brendshëm për financat publike në vendet kandidate dhe ato potenciale për kandidate. Sa i përket kontrollit të jashtëm, shkallës të zhvillimit të institucioneve të kontrollit të lartë shtetëror kemi variacione të modeleve dhe sistemeve të ndryshme nga njëri vend në tjetrin në Ballkanin Perëndimor.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Kufizimi për financimin monetar të borxhit publik. Ky është një element thelbësor i politikave të shëndosha fiskale. Në veçanti i ndeshur në vendet e ish-Jugosllavisë ku hiperinflacioni në vitet 1990 ndërgjegjësoi publikun për të metat e politikave të buta në drejtim të financimit të nevojave për para të qeverisë. Ky kufizim lehtëson krijimin e një ambjenti më të shëndoshë të financave publike për çdo vend.

Mësime nga krizat e mëparshme të dhimbshme janë mësuar gjithashtu nga Turqia, ku u nevojitën ndryshimet ligjore të vitit 2001 të ndalonin financimin e qeverisë së Turqisë nga Banka Qëndrore e Turqisë.

Legjislacionet kombëtare për Bankat Qendrore në vendet kandidate dhe vendet e mundshme kandidate janë në një shkallë të konsiderueshme të përafuar me Traktatin e BE-së. Ato ndalojnë financimin e borxhit publik nga Banka Qëndrore. Përjashtim bën vetëm Shqipëria, ku Banka Qëndrore lejohet të sigurojë kredi afatshkurtra për qeverinë. Meqënëse Kosova aplikon regjimin e monedhës me euro dhe Banka Qëndrore e Kosovës nuk është një autoritet monetar lëshues i kësaj monedhe atëherë Banka Qëndrore nuk mund të sigurojë asnjë strukturë kredie për qeverinë e Kosovës.

2.7. Sfidat e politikës fiskale lidhur me ekonominë informale për vendet në zhvillim

Sipas Edgar L. Feige (1989, 1994), Schneider (1994), Frey dhe Werner Pommerehne (1984), si edhe Herald Lubell (1991) ekonomia informale përbën gjithë aktivitetin ekonomik që kontribuon në produktin e përgjithshëm kombëtar të llogaritur zyrtarisht por faktikisht është i paregjistruar. Philip Smith (1994) e përkufizon ekonominë informale si: prodhimi i mallrave dhe shërbimeve i bazuar në treg, ligjërisht ose jo që i shpëton llogaritjes zyrtare të PBB-së.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ekonomia informale ka ndikime të rëndësishme për financat publike, rritjen dhe realizimin e politikave (Çule & Fulton, 2007). Ekzistojnë një sërë faktorësh që nxisin firmat drejt ekonomisë informale: barra tatimore direkte ose indirekte; kompleksiteti dhe intensiteti i rregullimeve; korrupsioni burokratik; cilësia e shërbimeve publike dhe besimi tek qeveria (Tanzi, 1982, 1983; Feige, 1996; Schneider and Enste, 2000; Schneider, 2002, 2007). Regresioni i shumëfishtë i të dhënave nga 18 shtete me ekonomi në tranzicion zbuloi se pabarazia në të ardhura është e korreluar konsiderueshëm me madhësinë e ekonomisë informale (Rosser & Ahmed, 2003). Ekonomia informale mund të jetë në shumë forma – p.sh aktivitetet jo ligjor, të ardhura të paraportuara (evazion fiskal) dhe sektori informal (Feige, 1990, 1996). Evazionit fiskal karakterizohet si një sjellje e qëllimshme jo ligjore ose si një sjellje që përfshin një dhunim direkt të ligjeve tatimore për t'iu shmangur pagesës së tatimeve. Nën-raportimi i qëllimshëm i të ardhurave dhe mbi-deklarimi i zbritjeve tatimore janë shembuj të evazionit tatimor (International Bureau of Fiscal Documentation (IBFD). 2001,134).

2.7.1. Ekonomia informale sfidë për vendet candidate për anëtarësim në BE

Në ekonomi termi –ekonomia informale (disa herë e përmendur si ekonomia në të zehtë, ekonomia e fshehur, ekonomia hije) i referohen aktiviteteve që ndodhen në ekonomi por që nuk raportohen zyrtarisht. Ky sektor mund të përfshijë gjëra të tilla si shitjet në rrugë, nga shitësit lokalë për fitime nga prodhimi familjar, dhe në disa raste dhe prodhimi industrial. Bizneset që operojnë në informalitet janë në gjendje që të shmangin taksat dhe rregullat por vuajnë nga pamundësia për të zbatuar në mënyrë efektive kontratat (pasi biznesi është operativ në mënyrë të paligjshme) dhe mund të heqin dorë nga tregjet formale të kreditimit. Ndërsa është e qartë se ky fenomen ekziston, një përkufizim standart i sektorit informal nuk gjendet në literaturë. Megjithatë, ka përkufizime të shumta të përdorura në studime të ndryshme.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Do të përdorja përkufizimin e (Feige, 1990), sipas të cilit një aktivitet konsiderohet të jetë pjesë e ekonomisë informale në qoftëse ky aktivitet nuk i përmbahet rregullave të përcaktuar, të pranishme në ekonominë formale. Kjo do të thotë se ekonomia informale¹⁴ mund të përkufizohet vetëm në kontekst të veçantë të strukturës institucionale që e rrethon atë.

Autorët Schrage (1984) dhe Thomas (1992) e kanë përkufizuar ekonominë informale si: -Një bashkësi aktivitetesh që në parim ushtrohen legalisht dhe që duhet ti nënshtrohet tatimit por që nuk deklarohen si aktivitete komerciale legale dhe si të tilla nuk përfshihen në vlerën e të ardhurës kombëtare ose që pjesërisht përfshihen në PBB-në.

Në literaturat e viteve të fundit si dhe nga FMN-ja është pranuar përkufizimi sipas së cilit në ekonomitë që janë përfshirë nga ryshfeti dhe korrupsioni , iniciativat ekonomike shtrembërohen pasi zyrtarët , qeveritarët , si dhe individëve private shtyhen që të paguajnë pjesë më të vogla të shpenzimeve publike nga të cilat ofrohen të mira publike. Si pasojë qeveria mbledh më pak të ardhura që çojnë në uljen e investimeve publike dhe në rritjen e varfërisë dhe pabarazisë së qytetarëve.

Në figurën 1. më poshtë paraqitet funksionimi i ekonomisë informale në mënyrë paralele me ekonominë formale. Ky funksionim paralel i të dyja ekonomive, realizohet në të njëjtin ambjent, në të cilën ekzistojnë në të njëjtën kohë tre aktorët kryesorë: 1-qeveria; 2-konsumatorët; 3- kompanitë.

¹⁴Marre nga FMN, (Alesina, 1999)




Figura 1. Ekonomia e dyfishtë. *Burimi: (Alesina, 1999)*

Në figurën 1. gjejmë të pasqyruar lidhjen funksionale dhe ko-ekzistencën e ekonomisë informale dhe asaj formale në kuadër të ambjentit të përgjithshëm ekonomik. Në këtë ko-ekzistencë , paguesit e tatimeve paguajnë provizion për të mirat publike në të cilat kompanitë që –i kalojnë lirshëmll kanë qasje të kufizuar. Ekonomia informale mund të klasifikohet në tre grupe të tilla si sektori jorformal, aktivitete paralele dhe tregu i zi (Bagachwa & Naho , 1995). Siç u tha nga Bagachwa dhe Naho , tregu i zi paraqitet nga njësi të vogla prodhuese dhe shpërndarje të mallrave dhe shërbimeve dhe përbëhet nga punëtorët e punësuar dhe personat e vetëpunësuar në të gjithë vendin dhe përfshijnë si zonat rurale dhe ato urbane. Një tjetër problem është prodhimi i mallrave dhe shpenzimeve nga të dyja burimet nga ato të ligjshme dhe të paligjshme , të cilat nuk mund të zbulohen në vlerësimet zyrtare të prodhimit të brendshëm bruto.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Një përkufizim e deklaroi atë si : -Të gjitha aktivitetet ekonomike që kontribuojnë në llogaritjen e PBB-së zyrtare por që aktualisht janë të peregjistruar (Friedrich Schneider & Enste, 2000)l.

Përveç kesaj , Konferenca ndërkombëtare e Stacionëve të Punës (ICLS) e përshkruan termin e ekonomisë informale duke u bazuar në kompanitë e peregjistruara , përveç nga pronarët e bizneseve , të cilët punësojnë persona nga familja pa pagesë , të cilët nuk kanë një punë dhe as kanë kontrata të mbrojtjes sociale dhe të daljes në pension. Ata janë informale në pikëpamjen se ata janë më së shumti të peregjistruar në statistikat zyrtare ; dhe pjesëmarrësit kanë pak ose aspak akses në tregjet e organizuara, në institucionet e kreditit , në arsim dhe trajnime formale ose në shërbime publike.

Ekonomia informale gjithashtu përfshin dhe aktivitete të paligjshme si prodhim dhe shitjen e disa drogave joligjore apo krime të tjera si tregtia e trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabanda , trafikimin e paligjshëm të armëve etj. Përkufizimet ndryshojnë nga njëri tjetri , sipas qasjes, specialitetit dhe qëllimit të punës.

Është e vështirë për të dalë me një përkufizim të plotë. Rreziqet kryesore që kërcënojnë realizimin e dy objektivave kryesore afatgjata të qeverisë ,atë të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë dhe integrimin në Bashkimin Europian, vijnë nga strukturat që janë krijuar në sektorin informal si dhe tregjet e ekonomive të vendeve në tranzicion të cilat kanë krijuar pozicione monopoli.

Është shumë i rëndësishëm fakti që përkundrajt ngecjes së zhvillimit të shpejtë ekonomik, varfërisë së lartë dhe gjithpërfshirëse si dhe papunësisë së madhe nga njëra anë , dhe nga ana tjetër -kapitaliste të shumtë tranzitorell të cilët kanë krijuar pasuri të mëdha ekonomike kryesisht në kuadër të aktivitetit ekonomik informal. Shumica e kapitalistëve tranzitorë nuk janë në gjendje të dokumentojnë prejardhjen e kapitalit nëpërmjet raporteve legale financiare dhe fiskale të bizneseve te cilat i



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

ushtrojnë në mënyrë informale në ekonominë kombëtare ose në tregjet ndërkombëtare. Ndërmarrjet që funksionojnë në sektorin informal kanë mundësi që t'i ofrojnë të mirat materiale dhe shërbimet me çmime relativisht më të ulëta se ato që zhvillojnë aktivitetin ekonomik ¹⁵në sektorin formal (ligjor) pasi ato nuk paguajnë fare ose paguajnë pjesërisht tatime në konsum dhe në fitim dhe kontribute në fondet e sigurimeve shoqërore.

Si një fenomen i ri ekonomia informale ka ardhur në vëmendjen gjatë Luftës së Dytë Botërore. Njerëzit morën pjesë në aktivitetet jo formale për shkak të kontrolleve mbi çmimet, dhe programeve të racionimit gjatë luftës. Duke filluar me studimin e (Cagan, 1958) ekonomistë diskutuan dhe parashikuan këtë pjesë të fshehtë të ekonomisë. Aktualisht pas viteve 1960 dhe 1970-të u theksua se ekonomia informale është një nga subjektet më interesante dhe më shqetësuese që ato kishin ekzaminuar ndonjëherë. Megjithatë, kjo mori kohë për vendet e tjera për ta kuptuar.

Studimet e hershme tregojnë që madhësia e ekonomisë informale në SHBA u rrit gjatë viteve 1965-1989 (Tanzi, 1999; Molefsky, 1982); në fund të kësaj periudhe, të ardhurat e llogaritura të përgjithshme ishin nga 20 deri në 30 përqind të të ardhurave të regjistruara (Feige, 1989). Në Mbretërinë e Bashkuar, llogaritjet e të ardhurave të përgjithshme ishin në vlerat 2.5-15% të GDP-së, me një tendencë rritëse në vitet 1970 dhe zbutje në vitet e mëvonshme (O'Higgins, 1980). Në Gjermaninë Përendimore, të ardhurat e përgjithshme ishin llogaritur rreth 27% e GNP-së¹⁶ në 1980. Ekonomia informale është konsideruar si një problem në mbarë botën në 1980 dhe pastaj ky subjekt tërhoqi vëmendjen e studiuesve në gjithë botën, por relativisht

¹⁵Kaufmann, D. & Kaliberda, A. (1996). Integrating the unofficial economy into the dynamics of post socialist economies: a framework of analysis and evidence. World Bank Policy Research WP 1691.

¹⁶Zyra e analizës Ekonomike (BEA) çdo vit publikon një krahasim mes matjes së të ardhurave personale nga ana e saj dhe matjes nga shërbimi i të ardhurave të brendshme i të ardhurave bruto të rregulluara.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

është bërë pak progres në të kuptuarit e saj. Në rastin e Shqipërisë, vëmendja e publikut dhe ajo akademike mbi këtë çështje filloi pas viteve 1990.

2.7.2. Evazioni fiskal rrit ekonominë informale dhe sfidon Politikën Fiskale

Fjala taksë (nga latinishtja *taxo* që përkthehet -çmiml, -normëll, -tarifëll) është një detyrim financiar për tatimpaguesin që vendoset nga qeveria për të financuar shpenzimet e ndryshme publike. Ndërkohë që evazion (nga latinishtja *evasionem* që përkthehet -veprimi i shpëtimit ose shmangies nga presioni i një argumenti, akuze, detyrimi ose pyetje) është shmangia joligjore e pagimit të tatimeve duke realizuar një deklaram të rremë të të ardhurave.

Kuptimi i shprehjes *evazion fiskal*, sipas shkencës së financave, lidhet me të gjitha ato veprime që kanë për qëllim të zvogëlojnë ose të eliminojnë kontributin fiskal në arkën e shtetit prej qytetarëve ose subjekteve, duke shkelur dispozita dhe norma fiskale specifike. Evazioni Fiskal është mospagim i detyrimeve tatimore që rrjedhin nga ligji. Evazioni fiskal ka një efekt shkatërrues ndaj politikës fiskale të qeverisë duke i shkaktuar shtetit një humbje jo të vogël nga të ardhurat fiskale të tij. Në total evazioni fiskal në nivel botëror kap një shifër midis 21000 - 32000 miliardë dollarë, e barabartë kjo me PBB-në e ShBA-së, Japonisë dhe Gjermanisë të marra së bashku.

Ekonomia informale ekziston si pasojë e disa shkaqeve dhe ndër më kryesorët është evazioni fiskal. Ekzistenca e kësaj ekonomie informale ka pasojat e veta. Në këtë studim ne do të trajtojmë disa nga pasojat më të rëndësishme. *Një nga pasojat kryesore të ekonomisë informale është Norma e Rritjes së PBB-së.* Nuk ka një mendim të përbashkët për masën e ndikimit të marrëdhënies midis ekonomisë informale dhe rritjes ekonomike. Megjithatë, sipas disa autorëve si (Adam & Ginsburgh, 1985) për llogaritjen e ekonomisë informale në Kanada, Frey dhe Weck-Hannemann (1984) për llogaritjen e ekonomisë informale për 17 vendet e OECD-së, (Loayaza, 1997) për llogaritjen e ekonomisë informale për 14 vendet e Amerikës Latine, (Kaufmann &



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Kaliberda, 1996) për llogaritjen e ekonomisë informale për vendet në tranzicion, (Friedrich Schneider & Enste, 2000) për llogaritjen e ekonomisë për 76 vende të tjera, të gjithë këto gjetën një marrëdhënie negative midis ekonomisë informale dhe normës së rritjes së PBB-së.

Për vendet në zhvillim si Shqipëria e cila na ndihmon në këtë punim mund të evidentojmë se Schneider në vitin 2005 konkludoi për një shenjë lidhje negative midis ekonomisë informale dhe normës së rritjes së PBB-së për vendet në tranzicion dhe vendet në zhvillim.

Spektori informal ende nuk është shumë i qartë në krahasim me sektorët e tjerë ekonomikë. Pjesë e problemeve është se ky sektor është tejet i vështirë për tu matur¹⁷. Kjo është për shkak se individët që operojnë në këtë sektor kanë pak nxitje për të treguar aktivitetet e tyre, dhe kanë stimuj të fortë për ti fshehur ato, duke përfshirë edhe frikën e dënimit nga shteti.

Janë bërë disa studime për të vlerësuar ekonominë informale në Shqipëri. Përveç studimeve të (Friedrich Schneider, 2002a) dhe (Christie, E., & Holzner, 2003) edhe instituti Kombëtar i Statistikave Shqiptare ka bërë studime për matjen e ekonomisë informale në Shqipëri. (Friedrich Schneider, Buehn, & Montenegro, 2010) llogaritën ekonominë informale në Shqipëri për vitet 1999-2007, gjetën se sektori informal i ekonomisë llogaritet mesatarisht 37.3% e PBB-së.

Edhe pse janë bërë këto studime, akoma për Shqipërinë nuk ka një vlerësim të plotë i cili mund të përdoret si model dhe tregues për kërkimet në këtë fushë. Gjithashtu, paqëndrueshmëri në tregues dhe modele vijojnë edhe sepse ende shumë shqiptarë preferojnë të mos i fusin paratë e tyre në banka për arsye të mungesës së besimit tek qëndrueshmëria e ndërmjetësve financiar (ndikuar kjo edhe nga situata e firmave

¹⁷Kaufmann, D., & Kaliberda, A. (1996). Integrating the unofficial economy into the dynamics of post socialist economies: a framework of analysis and evidence. World Bank Policy Research WP 1691



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

piramidale dhe klasës politike e cila nuk garanton pavarësi të rregullatorëve të tregjeve financiare), dhe/ose burimi jo i qartë i origjinës së këtyre parave. Tek kjo e fundit kryesisht janë paratë që vijnë nga korrupsioni, pastrim parash dhe emigrantët që kryejnë veprimtari të paligjshme.

Nuk duhet të ngatërrojmë *shmangien e tatimit me evazionin fiskal*. Përkufizime të pranuar universalisht për shmangien e taksave dhe evazionin fiskal nuk ekzistojnë. Të vizatosh vijën midis shmangies ligjore të taksave dhe evazionit fiskal të paligjshëm nganjëherë është e vështirë. Megjithatë evazoni fiskal është i ndryshëm nga shmangia e taksave sipas Richardson (2008) i cili e përkufizon evazionin fiskal si -sjellje të qëllimshme, të paligjshme apo aktivitet që përfshijnë një shkëlqje të drejtëpërdrejtë të ligjit të taksave për të shmangur pagesën e tatimit. Ndërsa, Kim (2008) thotë se evazoni fiskal është i paligjshëm, ndërsa shmangia e taksave është një mënyrë e ligjshme për të ulur barrën e taksave.

Referuar informacionit të marrë nga dokumenta të websitit shtetiweb, një nga diskutimet më të rëndësishme është se duhet të bëhet dallimi midis *shmangies së tatimit dhe evazionit tatimor*. Shmangia tatimore, të cilën John Maynard Keynes e ka quajtur dikur -I vetmi profesion intelektual që sjell ndonjë shpërblim. Nuk ka asgjë të paligjshme rreth shmangies tatimore. Përherë gjykatat kanë thënë se: nuk ka asgjë të keqe që dikush ta rregullojë biznesin në mënyrë që tatimet të jenë sa më të ulta që të jetë e mundur. Kushdo vepron kështu, të pasurit, të varfërit dhe të gjithë veprojnë drejtë, askush nuk e ka detyrimin që të paguajë më tepër nga sa kërkon ligji. Të kërkojë më shumë në emër të moralit është hipokrizil.

Evazoni fiskal është i mundshëm përmes disa veprimeve që kryhen në situata shumë të ndryshme dhe konkretisht disa prej tyre i citojmë si në vijim:



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

1-mbajnë dy libra regjistrimi të transaksioneve të biznesit. Njëri regjistron biznesin e vërtetë dhe tjetri i paraqitet organeve tatimore. Disa evazues përdorin dy regjistra arke.

2-bëjnë një punë të dytë kundrejt të ardhurave me para në dorë. Sigurisht të bësh një punë shtesë është plotësisht e ligjshme, megjithatë e ardhura e marrë nga një punë e tillë shpesh paguhet me para në dorë dhe jo me çek. Kështu që nuk ekziston asnjë regjistrim ligjor i të ardhurave nuk u raportohen organeve tatimore.

3-këmbimi mall me mall: unë do të rregulloj televizorin nëse ti do më rregullosh kompjuterin. Kur e merrni pagesën në natyrë, në vend të parave, ky është një transaksion i tatueshëm. Por keto të ardhura rrallë raportohen.

4-veprimet me para në dorë. Duke paguar për të mirat dhe shërbimet me para në dorë është e paraportuar, për këtë qëllim është shumë e vështirë për organet tatimore për të rënë në gjurmë të transaksioneve.

5- Në kryerjen e operacioneve të shitjes ose të shërbimeve pa lëshuar faturën e rregullt për veprimin e kryer ndaj qytetarit/konsumatorit (e ashtuquajtura shitje në -të zezë!).

6- Hartimi i deklarimeve fallso të të ardhurave me pasojë deklarin fiskal të mangët ose të gabuar që sjell derdhjen e munguar të detyrimeve reale.

7- Kryerja e një aktiviteti ekonomik jashtë çdo rregulle: për shëmbull, -punë në të zezë nga nëpunësit (publik ose privat).



8- Megjithëse në raporte të rregulla pune, marrja e një pjesë të shpërblimit në formë të padokumentuar, për pasojë të pataksueshme, përmes parave në dorë (forma tipike e integracionit ose rikompensimit të përdorur në ndërmarrjet e mikro apo të vogla).

9- Pasi t'i nënshtrohet marrëveshjes midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndryshimi i natyrës së zërave që shoqërojnë dëftesën e pagës, për shëmbull, duke dhënë transferta fallso (që nuk janë të taksueshme) me qëllim që të eliminojnë zërat e taksueshëm (për shëmbull, pagesat suplementare).

10- Marrëveshje të fshehta me klientin e ndërmarrjes ose punëtorin autonom për të zvogëluar ose evituar krejtësisht paraqitjen e faturave ose ndryshimin e natyrës së zërave;¹⁸– xhirimi i dokumenteve fiskale subjekteve që nuk janë reale në mënyrë që këto të kontabilizohen në kosto (në mënyrë për të zvogëluar në mënyrë fiktive shumën e taksueshme).

11- Mospagimi i taksave ose detyrimeve për përfitimin e shërbimeve ose moskryerja e kërkesave të detyrueshme, për shëmbull mos pagesa e taksës së TV, të taksave lokale të shërbimeve, etj.

Për të dhënë një masë kuantitative mbi përmasat e fenomenit të evazionit fiskal, si në nivel individual ashtu dhe në nivel kolektiv, përveçse dhënies së shumës totale të fondeve evazive mund të përkufizohet dhe të llogaritet indeksi i evazionit të përcaktuar si raporti midis fondeve evazive dhe totalit të fondeve që shteti duhet të marrë nga taksat dhe tatimet. Indeks tjetër, indeksi makroekonomik është raporti midis fondeve totale evazive dhe PBB-së.

¹⁸<https://shtetiweb.org/2014/11/03/evazoni-fiskal/>



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ekziston edhe një variant shumë më i rëndë i evazionit, *mashtrimi fiskal*, që kryhet me mekanizma të sofistikuar që krijojnë një aparencë të rregullt, nën të cilën mbahet i fshehtë evazoni, duke e bërë kështu më të vështirë punën e kontrollit të administrimit financiar. Instrument tipik i mashtimit fiskal është futja në kontabilitet të faturave fallso të blerjeve për të zvogëluar shumën e taksueshme. Të ardhurat e evazionit e të mashtimeve fiskale futen në të ashtuquajturën *-ekonomi nën ujëll*. Evazoni fiskal dënohet me sanksione në para dhe mbi një kufi të caktuar të uljes së shumës së taksueshme, edhe penalisht. Mashtrimi fiskal dënohet shumë më ashpër nga evazoni i thjeshtë, kjo në varësi të shkallës së dëmit ekonomik dhe të rrezikshmërisë.

Instrument tipik i mashtimit fiskal është futja në kontabilitet të faturave fallco të blerjeve për të zvogëluar shumën e taksueshme. Të ardhurat e evazionit e të mashtimeve fiskale futen në të ashtuquajturën *‘ekonomi nën ujë’*. Evazoni fiskal dënohet me sanksione në para dhe mbi një kufi të caktuar të uljes së shumës të taksueshme, edhe penalisht.

Mashtrimi fiskal dënohet shumë më tepër nga evazoni i thjeshtë, kjo në varësi të shkallës së dëmit ekonomik dhe të rrezikshmërisë. Në nenin 116 *‘Evazoni Fiskal’* të legjislacionit tatimor shkruhet: *-Fshehja e detyrimeve tatimore, nëpërmjet dorëzimit të dokumentave false, deklaratave të pavërteta apo të informacioneve joreale, vlerësimi i te cilave çon në përlogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion fiskal dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt*¹⁹.

Një rast të veçantë të evazionit fiskal përbëjnë *parajsat fiskale*. Parajsë fiskale zakonisht quhet një shtet që garanton një taksë të ulët ose edhe zero mbi depozitat bankare. Arsyet e një zgjedhje të tillë janë të ndryshme: tërhiqen kapitale të shumta

¹⁹ UMF Nr 21, date 02.09.2008, *‘per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise’*, i ndryshuar.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

nga vendet e huaja, duke i dhënë në shkëmbim një taksim mjaft të ulët. Por nuk është vetëm kjo arsyeja pse në këto vende vendosen selitë e shoqërive të ndryshme, të quajtura *shoqëri offshore*. Duhet theksuar edhe statusi i veçantë tepër rigoroz për ruajtjen e sekretit bankar. Nga pikëpamja e kontribuesit, parajsat fiskale përbëjnë një mundësi për të fshehur taksimin mbi të ardhurat, e thënë ndryshe një teknikë e shmangies fiskale.

2.7.3. Sfidat të tjera të ekonomisë informale për Politikën Fiskale

Rëndësia e sektorit informal qëndron kryesisht në ndikimin e vet të mundshëm në aplikimin e politikës së duhur fiskale. Sektori informal potencialisht ul saktësinë e informacionit, pasi aktiviteti informal ekonomik, me përkufizim, nuk përfshihet në treguesit ekonomikë tradicionalë, dhe për këtë arsye mund të çojë politikëbërësit që të marrin vendime të gabuara.

Për shembull, në qoftë se një numër i madh i punëtorëve do të lëvizë nga punësimi formal në punësimin informal, statistikatat zyrtare mund të regjistrojnë një rritje të lartë të papunësisë pasi punonjësit informalë kanë një stimul të fortë për të raportuar veten si të papunë. Kjo mund të çojë politikëbërësit për të implimentuar politika fiskale (shpenzimet sociale) dhe / ose politika monetare (norma e interesit), të projektuara në mënyrë të lillë për të luftuar papunësinë e lartë, kur, në realitet, njerëzit kanë punë, por vetëm se nuk kanë atëformale.

Ndërsa ky është një shembull i ekzagjeruar, problemet nga politikat mund të rezultojnë nga informacioni i pasaktë në lidhje me gjendjen e ekonomisë.

Potenciali për gabime është veçanërisht i mprehtë në vendet në zhvillim, ku të ardhurat tatimore janë jetike për ndërtimin e infrastrukturës dhe madhësia e vogël e ekonomisë do të thotë se edhe pasaktësitë relativisht të vogla në të dhënat ekonomike mund të ketë pasoja të rëndësishme. Kjo mungesë e informacionit dhe nevoja për të siguruar matje më të sakta për politikëbërësit ka shtyrë studimin e sektorit informal.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ndërsa shumë punë është bërë, akoma më shumë është e nevojshme në mënyrë që të zhvillohen teori koherente dhe të testueshme për të përshkruar sektorin informal.

(Voicu, 2012) pasi shqyrtoi teorinë themelore të studimit të ekonomisë "nëntokësore" arriti në përfundimin se një njohuri e mirë e historisë së mendimit ekonomik është një domosdoshmëri për çdo analizë ekonomike. Subjekti është mjaft dramatik, nga natyra e tij; kështu që është e nevojshme për të sjellë perspektivë shkencore për ekonominë informale. Përveç kësaj, ekonomia informale është një përbërës i pashmangshëm i çdo ekonomie, është komponenti më fitimprurës i kësaj ekonomie. Mos respektimi i këtij komponenti mund të çojë në mangësi serioze të analizës ekonomike që çon në miratimin e strategjive jorealiste.

Përpunimi i një teorie që përcakton ekonominë informale si nëndegë të ekonomisë totale është një nga hapat e parë dhe argumenti kryesor që mbështet nevojën për një analizë të tillë vjen sipas C. Vo Icu (2012): -dëshmia e kohës që tregon se ekonomia informale është burim i zhvillimit, jetesës dhe madje edhe të shpëtojnë nga zona periferike për disa ekonomi të pazhvilluar²⁰.

Ekonomia informale ndikon jo vetëm në tregjet zyrtare, por edhe të gjithë vendin. Efektet negative të saj klasifikohen si efektet në treguesit ekonomikë, të ardhurat e qeverisë dhe konkurrencës. Ekonomia informale ka një ndikim në këtë kuptim. Përpjekjet për të ulur këtë trend të përhershëm dhe të qëndrueshëm rritje janë të nevojshme. Studimet që lidhen me rritjen ekonomike tre gojnë se ekziston një lidhje midis nivelit të mirëqenies dhe efikasitetit. Në këtë drejtim, duhet treguar më shumë vëmendje për të kuptuar pse ekonomia informale është më e lartë në vendet e zhvilluara dhe se si duhet të punojmë për ta zvogëluar madhësinë e kësaj ekonomie.

Fenomeni i ekonomisë informale duhet analizuar në aspektin e faktorëve të cilët potencialisht mund të shkaktojnë atë.

²⁰C. VO ICU (2012). Economics and "underground" economy theory.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ky fenomen është kompleks dhe zhvillimi i tij në një ekonomi vjen si pasojë e disa faktorëve që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe bëjnë të mundur zgjerimin e tij duke zëvendësuar ekonominë formale me atë informale. Më poshtë listohen disa nga elementët që janë thelbësor në shkaktimin e ekonomisë informale : a) Tregu i punës; b) Korrupsioni; c) Sistemi Tatimor; d) Ekonomia e Cash-it, etj.

Të gjithë këta faktorë të përmendur më sipër kanë ndikuar negativisht tek financat publike të Shqipërisë dhe përballimin e sfidave të politikës fiskale për integrimin e Shqipërisë në BE. Mos ndjekja e kursit të duhur për kapërcimin e sfidave të politikës fiskale dhe menaxhimit të financave publike, kanë vijuar të krijojnë disekuilibër të treguesve makroekonomikë të Shqipërisë, dhe sidomos në rritjen e papunësisë dhe në thellimin e asimetrisë midis rritjes ekonomike dhe mirë shpërndarjes së të ardhurave për çdo shqiptar ku evidentohet ndarje e skajshme me vetëm 2 shtresa popullore si të varfër dhe të pasur. Ky disproporcionalitet në shpërndarjen e të ardhurave qëndron në realitetin shqiptar, pasi situata duket shumë më pozitive nëse bazohemi vetëm tek të dhënat statistikore sipas INSTAT, e cila tregon se ritmi i shpejtë i rritjes ekonomike e ndihmoi Shqipërinë të ngushtojë hendekun e të ardhurave për frymë krahasuar me mesataren e BE-së. Konkretisht, duke i rritur ato nga 18% të mesatares së të ardhurave të Bashkimit Europian (BE) në 1998 në mbi 45% në 2017. Gjithashtu, kjo rritje përgjysmoi varfërinë në vend nga 25.2% në 2002 në 12.5% në 2008 dhe akoma më pak në 2017.

Qëndrueshmëria fiskale dhe financare ka një ndikim themelor në aftësinë e Shqipërisë për të lëvizur drejt integritit ekonomik të qëndrueshëm me BE-në. Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve buxhetore dhe rritja e efikasitetit për to mund të krijojnë mundësi për investime në shërbimet sociale – duke kontribuar kështu në rritjen e mirëqenies për të varfërit që janë rreth një e dyta (1/2) e popullsisë në vend.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Këtu mund të ndikojë edhe krijimi i kushteve për rritjen e konkurrueshmërisë, krijimin e vendeve të punës, mbështetja e inovacionit dhe sipërmarrjeve të reja duke ndihmuar në kapërcimin e sfidave të vazhdueshme, të cilat pengojnë integrimin ekonomik të Shqipërisë në BE.

Gjithashtu, ndikon pozitivisht në përballimin e sfidave edhe rritja e besimit të shqiptarëve tek qeverisja e tyre dhe kjo arrihet përmes sigurimit të transparencës dhe jo asimetrisë së informacionit nga qeveritë apo partitë politike në Shqipëri.

Problemi i ekonomisë informale është një problem kryesor për integrimin e Shqipërisë në BE. Në realitetin shqiptar nga çdo qeverisje e këtyre 30 viteve nuk është bërë aq sa duhet për kapërcimin e këtyre sfidave. Përkundrazi, ekonomia informale është lënë dhe kultivuar si një reagim i natyrshëm dhe spontan ndaj pamundësisë së ekonomisë formale për të plotësuar nevojat e një pjese të anëtarëve të shoqërisë duke e pranuar pa zë se në vendet në zhvillim e ato në tranzicion ekonomia informale jep një kontribut të konsiderueshëm për rritjen ekonomike, ndonëse duke u shoqëruar me shumë probleme.

*Megjithatë, një prej masave të marra të pozuara nga çdo qeverisje e Shqipërisë për kapërcimin e këtyre sfidave gjatë këtyre tridhjetë viteve ka qenë **lufta kundër korrupsionit**. Gjatë këtyre tridhjetë viteve qeveritë e ndryshme kanë ndërmarrë masa për luftën kundër korrupsionit duke përmirësuar legjislacionin dhe ngritur struktura të posaçme për të parandaluar dhe për t'i vënë fre praktikave korruptive, siç është Ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë së nëpunësve publikë, Ligji për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, apo struktura përkatëse si Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, etj.*



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Sa efektive kanë qenë këto struktura të reja dhe sa janë zbatuar ligjet në Shqipëri, kjo pozohet qartë dhe denoncohet nga çdo parti opozitare derisa ajo synon të vijë në pushtet gjatë këtyre tridhjetë viteve.

2.7.4. Masa për adresim të sfidave që vijnë prej ekonomisë informale

Të gjitha sfidat për shmangien e ekonomisë informale të cilat shfaqen përmes evazionit dhe mashtrimet fiskale gjejnë terren për lulëzim nga keq qeverisja e administratës publike. *Adam Smith më shumë se dy shekuj më parë do të vinte në dukje: “Atje ku të paktën ka një dyshim të zakonshëm për shumë shpenzime jo të domosdoshme dhe keqzbatim të shpenzimeve publike, legjislacioni që e ruan atë respektohet pak”.*

Përpjekjet e qeverisë në bisedimet me misionin e FMN – së në lidhje me luftën kundër ekonomisë në hije/evazionit, nuk duhen parë dhe analizuar vetëm në aspektin politik që nuk u arrit firmosja e një marrëveshje, por te fakti se ekonomia në hije/evazioni po bëhet gjithnjë e më shumë shqetësues në kursin e integritit të vendit në BE si dhe në kuadër të globalizimit, për arsye se zvogëlimi i nivelit të evazionit është një parakusht vendimtar për të siguruar një proces të qëndrueshëm zhvillimi dhe politikash kundër varfërisë. Së dyti, një sistem tatimor dhe doganor me një nivel të ulët të evazionit kontribuon për një qeverisje më të mirë, për përgjegjshmëri të institucioneve shtetërore dhe për demokraci me anë të vendosjes së një kontrate ndërmjet shtetit dhe qytetarëve të tij, me qëllim që të luftohet evazioni i pastër tatimor (veprimtari ligjore që kryhen në mënyrë ligjore, por tatimet nuk paguhen), ekonomia në hije (veprimtaritë ligjore që kryhen në mënyrë të paligjshme) dhe ekonomia kriminale (veprimtaritë e paligjshme).



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ndryshimi në rritje i përqindjeve tatimore, i detyroi tatimpaguesit të kërkojnë dhe të gjejnë rrugëzgjdhje të reja për të ndryshuar mënyrën e deklarimit të detyrimeve për administratën tatimore, për të ndryshuar kohën e transaksioneve dhe për të ndikuar tërësinë e veprimeve të tjera që prekin fitimet e tyre. Këto ndryshime modelohen si një lojë kundër masave shtrënguese të qeverisë dhe, në këtë kuptim, *evazioni kontribuon në ndjenjën e trajtimit të padrejtë dhe mungesës së respektit për ligjin, duke krijuar një cikël vetëgjenerues që ushqen vetveten dhe të çon në më shumë evazion; evazioni ndikon gjithashtu saktësinë e të dhënave makroekonomike.*

Gatishmëria e ulët për të paguar tatimet influencohet nga shumë faktorë si marrëveshja institucionale me të cilën qeveria funksionon, politikat tatimore dhe administrimi i saj (sjellja e administratës tatimore dhe barra tatimore e perceptuar, struktura tatimore në përgjithësi si dhe strategjia e përdorimit të masave shtrënguese), që ndikojnë mbi gatishmërinë e tatimpaguesve për të paguar tatimet; kështu evazioni tatimor, si shfaqje e moralit tatimor, nuk është vetëm një veprimtari e paligjshme, por, gjithashtu, ka një lidhje të fortë me vendimet e politikës tatimore të qeverisë, me sjelljen e zyrtarëve tatimorë dhe me aspektet kulturore.

Në përgjithësi, tatimpaguesit shqiptarë në këto vitet e qeverisjeve demokratike kishin pritshmërinë që qeverisjet në Shqipëri do t'ju ofronin një lloj shërbimi ose përfitimi më të mirë si përgjigje për votat dhe tatimet që paguajnë, por meqenëse qeverisjet kanë dështuar në sigurimin e të mirave bazë publike ose në sigurimin e tyre në mënyrë të mjaftueshme, tatimpaguesit nuk kanë qenë të gatshëm për t'i paguar tatimet dhe si pasojë rezulton nivel i lartë i evazionit tatimor. *Për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit tatimpaguesit nuk janë të sigurt nëse tatimet që ata paguajnë po përdoren për të financuar të mirat dhe shërbimet publike, si rrjedhim ata e kanë ulur gatishmërinë e tyre për të paguar sidomos kur tatimpaguesit vërtetojnë se pagimi i tatimeve në raport me koston e mitmarrjes të një zyrtari tatimor është më e vogël.*



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Struktura e dobët ose korruptive të ankimit/apelimit tatimor nuk i ka mbrojtur të drejtat e tatimpaguesit nga arbitrariteti i zyrtarëve tatimorë dhe për arsye se sistemi tatimor nuk ka operuar mbi bazën e ligjit, tatimpaguesit i janë ndrojtur arbitraritetit, diskriminimit, trajtimit të pabarabartë, etj. Mungesa e sundimit të ligjit ka zvogëluar transparencën e veprimit publik dhe ka forcuar mosbesimin te tatimpaguesit dhe, si rezultat, tatimpaguesit nuk kanë dëshirë që ta financojnë qeverisjen me anë të pagimit të tatimeve, por kanë bërë evazion tatimor.

Keq qeverisja e sistemit fiskal, ka shërbyer për qëllime korruptive, gjë që ka bërë të mundur që shumë tatimpagues e kanë arsyetuar evazionin që kanë bërë duke ia vënë gishtin padrejtësisë së sistemit dhe keqpërdorimit të të ardhurave. Nevoja e mbijetesës ka pasur një influencë të madhe mbi përmbushjen e kërkesave të legjislacionit tatimor nga ana e tatimpaguesve, për arsye se veprimtaria e tatueshme ka rrezikuar kushtet e mbijetesës së tyre karshi konkurrentëve që bënin evazion fiskal. Kultura tatimore e një vendi është tërësia e institucioneve formale dhe informale që lidhen me sistemin tatimor dhe ekzekutimin e tij praktik, të cilët historikisht janë rrënjësor thellë brenda kulturës së vendit, e cila përfshin varësitë dhe lidhjet që shkaktohen nga ndërveprimi i vazhdueshëm i tyre.

Nëse do të analizojmë rrënjësorjen e kulturës tatimore në Republikën e Shqipërisë, së pari duhen marrë në konsideratë –aktorët e saj duke e nisur shtjellimin nga kultura e përgjithshme e vendit, te kultura tatimore, te legjislacioni tatimor, për të parë se si ndërveprojnë –aktorët ku ndërmjet të tjerëve do të veçohen: politikanët, akademikët, zyrtarët tatimorë, ekspertët (ekspertët kontabël të autorizuar, kontabilistët e miratuar, juristët tatimorë) dhe tatimpaguesit.

Kultura e një komuniteti tatimpaguesish diktohet: së pari, nga kultura e administratës tatimore; së dyti, nga shkalla e përmbushjes me dëshirë të kërkesave të legjislacionit



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

tatimor, përzierje komplekse e traditës, historisë dhe mjedisit ku punon administrata tatimore. Klima tatimore në shoqërinë shqiptare këto 10 vitet e fundit ka qenë vazhdimësia e një klime antagonistike dhe jo e një klime sinergjike, në të cilën tatimpaguesit dhe administrata tatimore kanë punuar kundër njëri – tjetrit; mungesa e një klime sinergjike nuk i ka krijuar të gjitha kushtet për të punuar së bashku.

Kompleksitetet e financës publike dhe legjislacionit tatimor, si dhe dykuptimësitë në interpretimin dhe ekzekutimin e tij kanë diktuar një tjetër prirje specializimin gjithnjë e më shumë të këshilltarëve tatimorë në fusha të veçanta pasi kompleksiteti e bën të pamundur që tatinmpaguesi të jetë ekspert i legjislacionit të përgjithshëm tatimor.

Legjislacioni tatimor është bërë kaq i ndërlikuar sa që ekspertët kontabël/kontabilistët e miratuar/ekspertët tatimorë kanë vështirësi në interpretimin e shumë prej kushtëzimeve ligjore. Madje, legjislacioni kompleks tatimor është më i vështirë për t'u kuptuar nga tatimpaguesit e zakonshëm për shkak të nivelit të lartë të abstraksionit të gjuhës, fjalive të gjata dhe komplekse si dhe kuptimit shumë profesional të termave, kur dihet se ka një mungesë të edukimit financiar bazik për shqiptarët dhe për tatimpaguesi e vegjël apo të mëdhenj gjithashtu.

Niveli i ekonomisë në hije/evazionit tregon se legjislacioni tatimor është adaptuar varfërisht në raport me ekonominë e vendit, për arsye se konflikti i pritshmërive që parashikohet të bashkëpunojnë mbetet i vështirë dhe mosmarrëveshjet kanë konsumuar burimet. Në të kundërtën, në qoftë se legjislacioni tatimor do të ishte adaptuar mirë në ekonominë e vendit, tatimpaguesit do të bashkëpunonin me administratën tatimore dhe do të harmonizonin pritshmëritë e tyre dhe do t'i përdornin burimet në mënyrën më të mirë dhe më krijuese.

Shumë studime e përcaktojnë besimin në qeveri si përcaktues të rëndësishëm të evazionit fiskal. Në qoftëse individët besojnë që qeveria do të veprojë sipas interesave të tyre dhe që procedurat janë të drejta ka gjasa që ato të bashkëpunojnë më shumë në



pagimin e tatimeve. Studimi nga Slemrod (2003) mbështeti marrëdhënien negative mes besimit në qeveri dhe evazionit fiskal. Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshueshme, sa më i lartë besimi tek qeveria, aq më i ulët niveli i evazionit në një vend. Besimet socializojnë njerëzit në atë mënyrë që të kufizojnë sjelljet devijuese. Studimet empirike tregojnë që ekziston një marrëdhënie negative mes besimit dhe evazionit fiskal. Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshueshme, sa më i lartë besimi aq më i ulët niveli i evazionit në një vend.

2.8. Borxhi Publik sfidë dhe tregues i kriterit të Politikës Fiskale për integrimin në BE

Në këtë çështje do të trajtojmë rishikimin e literaturës për treguesin e Borxhit Publik ndaj PBB-së meqënëse për Shqipërinë ky vijon të jetë sfida kryesore për qeverisjet e saj që prej vitit 2012 kur u kapërcye kufiri tavan i përcaktuar në 60% të PBB-së. Qeverisjet e Shqipërisë gjatë 10 vjeçarit të fundit vetëm e kanë rrit borxhin publik ndaj PBB-së, përjashtuar këtu tendencën rënëse që u shfaq në këto 2 vitet e fundit të periudhës së marrë në analizë.

Në këtë çështje analiza do të vij si kontributë shtesë për trajtimin e këtij treguesi sipas pikëpamjeve dhe këndvështrimeve të analizuara nga raportet dhe publikimet lidhur me Borxhi Publik në raport me PBB-në. Borxhi Publik ndahet në borxh të brendshëm (të marrë nga shtetasit e vet) dhe borxh të jashtëm (të marrë nga shtete të tjera ose nga organizata e institucione financiare ndërkombëtare). Nga pikëpamja e afatit të shlyerjes, borxhi shtetëror mund të jetë afatshkurtër, afatmesem, afatgjatë.

Efektet pozitive në afatshkurtër dhe ato negative në afatgjatë, sfidat dhe vështirësitë për shkak të ndryshimit të programeve politikie, keq-qeverisjes, si edhe faktorëve të



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

jashtëm që ndrikojnë ekonominë e një vendi, krahas krizave ekonomike globale dhe fatkeqësive natyrore apo pandemive.

Vëmë re që studimet janë të ndara në dy kategori. Një pjesë e sheh borxhin publik si një ndihmë për zhvillimin e mëtejshëm të një vendi dhe pjesa tjetër që fokusohet në efektet negative të tij.

Sipas mendimeve Kejnside, defiçiti buxhetor dhe borxhi publik kanë një ndikim pozitiv në aktivitetin ekonomik të çdo vendi, në veçanti përmes mekanizmit të shpenzimeve publike, duke argumentuar se rritja e shpenzimeve publike është rezultat i defiçiteve dhe borxhit të shkaktuar nga politika fiskale ekspansioniste.

Nga ana tjetër përfaqësuesit e shkollës neo-klasike thonë se defiçiti buxhetor dhe borxhi publik mund të kenë edhe efekte negative në ekonomi. Ata analizuan shpenzimet e konsumit familjar gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor dhe treguan se qeveria me lëvizjet e defiçitit buxhetor shton barrën tatimore për brezat e ardhshëm.

(Mahdy, 2009) argumenton se rritja e nivelit të borxhit publik të brendshëm mund të ketë efekte pozitive për rritjen ekonomike të vendit nëpërmejet rritjes eficientë së dhe madhësisë së investimeve që stimulojnë rritjen e kursimeve private nëpërmjet efektit të diversifikimit të riskut. Tregjet e borxhit të qeverisë zgjerojnë madhësinë e tregjeve të kapitalit, lehtësojnë mundësinë e financimit dhe të sektorëve strategjikë dhe riskozë, të cilët sektori bankar zakonisht ngurron t'i financojë. Disponueshmëria e instrumentave qeveritare mund të shërbejë në këtë mënyrë si një mjet tejet atraktiv për kursimet brenda vendit.

Sipas (Takeo Hoshi, 1993) kompanitë e mëdha e më të suksesshme janë të prirura të përzgjedhin tregun qeveritar të letrave me vlerë krahasuar me kompanitë më të vogla, aq më tepër që fitimi nga letrat me vlerë të qeverisë stimulon konkurrencën në sektorin bankar dhe atë financiar, duke nxitur rritjen e ekonomisë në tërësi.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

(Švaljek & Badurina, 2011) kanë trajtuar në studimin e tyre menaxhimin e borxhit publik para, gjatë dhe pas krizës për tre vende anëtare të Bashkimit Europian: Hollandë, Irlandë dhe Hungari. Janë zgjedhur këto tre vende nga autorët, për shkak se të gjithë kishin një sistem relativisht të zhvilluar të mirëmenaxhimit të borxhit publik para krizës dhe gjithashtu për shkak të faktit se gjatë krizës ata që janë përgjegjës për menaxhimin e borxhit publik, kanë ndjekur një politikë të akomodimit aktiv në rrethanat aktuale të tregut.

Kriza ekonomike globale ka pasur efekte të ndryshme në defiçitin fiskal dhe zhvillimin e borxhit publik në këto vende. Në përfundim autorët japin një pasqyrë të menaxhimit të borxhit publik në Kroaci në periudhën e krizës dhe e krahasojnë atë me menaxhimin e borxhit publik në tri vendet e marra në studim. Por borxhi është një thikë me dy tehe. Kur përdoret me mençuri dhe moderim është e qartë se përmirëson mirëqenien, por kur është përdorur keq rezultati mund të jetë fatkeqësi për individët, familjet dhe firmat, pasi çon në falimentimin dhe shkatërrimin e tyre financiar. Për një vend, borxhi i lartë dëmton aftësinë e qeverisë për të ofruar shërbimet e domosdoshme për qytetarët e saj.

Në një konferencë të zhvilluar në Tiranë (Shano, 2018) është shprehur për cilësinë e menaxhimit të borxhit publik. Sipas tij borxhi publik i marrë ndër vite nuk ka kontribuar në krijimin e një ekonomie moderne me bazë të qëndrueshme për të mundësuar investimet. Duke parë problemet e vendit tonë, ku në shumë rajone ka mungesë të ujit dhe të energjisë elektrike mund të thuhet që ky borxh nuk është menaxhuar në mënyrën e duhur duke bërë të qartë nevojën për një menaxhim më të mirë të tij. Sipas tij borxhi për Shqipërinë nuk ka qenë ndihmë për zhvillimin e vendit.



Borxhi Publik ose siç njihet ndryshe borxhi shtetëror, përfshin totalin e huave shtetërore dhe të interesave të maturuara e të pashlyera deri në momentin e llogaritjes së tyre. Marrja e borxhit nga ana shtetit diktohet nga nevoja e sigurimit të burimeve për mbulimin e defiçitit buxhetor, që nuk është e mundur të përballohet nga të ardhurat shtetërore. Kur borxhet e marra përdoren në mënyre produktive, për zhvillimin ekonomik të vendit, atëherë mund të jetë dobiprurëse. Në rast të kundërt kthehen në një barrë të rëndë për gjeneratat e ardhshme të vendit, të cilat do duhen të përballojnë shlyerjen e tyre nëpërmjet tatimeve më të mëdha.

2.8.1. Zanafilla e krijimit të teorisë së borxhit publik.

Në shekullin e 19, roli i shtetit ishte i kufizuar në disa funksione kjo sepse në atë kohë ishte mendimi i ekonomistëve të cilët besonin në politikën -Laissez Fairell. Këta ekonomistë të këtij mendimi besonin se qeveria duhet të kishte funksione minimale për tregun kryesisht detyra e tij do të ishte ligji dhe rendi për mjedisin e brendshëm dhe mbrojtja nga ndonjë agresion nga mjedisi i jashtëm si për shembull lufta apo pushtimi nga një shtet tjetër.

Gjithashtu ata trajtonin se punësimi i plotë mund të arrihej pa-ndikimin e qeverisë në një treg me konkurrencë perfekte. Ata kishin shumë besim tek individualizmi i çdo anëtari të qeverisë i cili ishte i prirur nga interesat vetjak të arrinte më të mirën për vete, por përkthyer kjo për të gjithë shoqërinë që do vepronin kështu individualisht, kjo do të çonte në një përmirësim të interesave totale të shoqërisë. Kjo teori duke i minimizuar²¹ funksionet e qeverisë, minimizonte në të njëjtën kohë shpenzimet publike të saj por në të njëjtën kohë edhe të ardhurat që do të nevojiteshin dhe mbi të gjitha qeveria nuk kishte pse të merrte borxh.

²¹ Ekonomia e Pergjithshme



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Përveç kësaj ky lloj mendimi shprehej se shpenzimet qeveritare ishin shpesh herë dhe jo produktive dhe të kota si pasojë e vendimeve politike. Adam Smith në librin e tij -Pasuria e kombeve shprehej se në treg duhet të vepronte -dora e padukshmell dhe çdo borxh i qeverisë rëndon mbi shpatullat e shoqërisë. Sipas këtij sistemi liberal Smith argumentonte se qeveria ka vetëm tre detyrime të rëndësishme ndaj shoqërisë:

- 1- Detyrimi për mbrojtje nga një luftë.
- 2- Ngritja e institucioneve publike të cilat do të jenë në shërbim të shoqërisë.
- 3- Kryerja e shpenzimeve të domosdoshme në infrastrukture për popullin e tij, si shkolla, etj.

Sipas J.B. Say thuhej se qeveria duhet të kishte disa funksione minimale për të kuptuar nevojat e shoqërisë dhe për të bërë shpenzimet qeveritare pikërisht aty ku shoqërisë i nevojiteshin. Ai ishte kundra borxhit publik, dhe tregonte se midis huamarrjes individuale dhe huamarrjes së qeverisë ka një ndryshim të madh, po ashtu edhe një efekt të ndryshëm në ekonomi. Por përveç kësaj shoqëria është e ngarkuar të paguajë interesat vjetore të këtij borxhi ku në vetvete qarkullimi vjetor i pagesës së interesave është një shtesë për kapitale të nevojshme.

Sipas Rikardos borxhi publik është një nga burimet më të tmerrshme i cili u shpik për të nënshtruar një komb. Ricardo shtyu më tej argumentet e Smith dhe Say duke shpjeguar se interesat e borxheve shkojnë për të fuqizuar shtetin huadhënës dhe duke rënduar kombin huamarrës të cilit i rriten taksat për të paguar për këto borxhe.

Por si çdo linjë mendimi edhe klasikët kishin kritikët e tyre, të cilët ishin në dy drejtime. Së pari jo çdo shpenzim qeveritar është jo produktiv prandaj borxhi publik nuk është gjithmonë një barrë për ekonominë. Së dyti pikëpamja e kalimit të borxhit si barrë nga njëra gjeneratë tek gjenerata pasardhëse nuk është plotësisht korrekte.



Kjo, sepse gjenerata e ardhshme përveç trashëgimit të borxhit nga gjenerata aktuale, ajo përfiton edhe të drejtën dhe përdorimin e aseteve të krijuara nga këto borxhe.

Teoritë²² moderne të borxhit publik morën zhvillim gjatë kohës të depresionit të madhe në Amerikë në vitet 1930. Pikëpamjet fillestare të këtij mendimi i bëri John Meinard Keynes. Keynesi iu kundërvu mendimit të rrymës klasike e cila mendonte se nuk duhej krijuar borxh publik. Gjatë kohës së një papunësie të lartë injektimin në ekonomi mund ta bënte në mënyrë të menjëhershme qeveria dhe mos të priste reagimin e vonuar nga investimet private, pra burimet mund ti siguronte qeveria edhe nëpërmjet efektit multiplikator, këto injektive në ekonomi do të sillnin rritjen e të ardhurave kombëtare.

Ai e lidhi financimin e defiçiteve të buxhetit të shtetit nëpërmjet borxhit publik ku nëpërmjet efekteve multiplikator kjo do të perkthehej në punësim dhe rritje të produktit përfundimtar.

Në idenë e tij nuk shfaqej asnjë lidhje ndërmjet shpenzimeve produktive apo jo produktive si rryma e mendimit klasik. Keynesi shpjegoi se nëpërmjet borxhit publik qeveria mund të realizonte projekte të mëdha me shumë fonde dhe për to do të paguante kur të përfitonte të ardhura në të ardhmen nga realizimi i tyre. Në të njëjtat linja mendimi qëndronin edhe neo-klasikët të cilët ishin një degëzim i klasikëve. Teoria moderne theksonte se kështu do të zhvillohen edhe sektori bankar, tregjet e kapitalit dhe kompanitë e sigurimit sepse ato mund të investonin në fondet e qeverisë.

Pikëpamja Konvencionale pohon se në afatin e shkurtër borxhi publik shfaq një efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike, ndërsa në afatin e gjatë ai shfaq një efekt negativ, që përçohet nëpërmjet uljes së kapitalit dhe të ardhurave kombëtare.

²²<http://www.financa.gov.al/files/usesfiles/Borxhi>



2.8.2. Efektet e Borxhit të lartë Publik në stabilitetin ekonomik të vendit

Sipas Nenit 4 të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 për -Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2006, fq. 6089²³) me borxh publik do të quajmë: *shumën e përgjithshme të borxhit të shtetit, e emetuar në monedhën kombëtare dhe/ose në një monedhë zyrtare të ndryshme nga monedha kombëtare, i cili nuk përfshin detyrimet financiare të bashkive/komunave apo të ndonjë autoriteti tjetër të pushtetit vendor.* Borxhi shtetëror përfshin edhe borxhet e Republikës së Shqipërisë, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për efekt të përlogaritjes së borxhit shtetëror, në rastin kur një detyrim i papaguar është emetuar në një monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare, ai vlerësohet në monedhën kombëtare, sipas kursit zyrtar të këmbimit, të shpallur nga Banka e Shqipërisë, në çastin e vlerësimit.

Ndërsa, rritja ekonomike është rritja e kapacitetit të ekonomisë së një vendi për të prodhuar të mira dhe shërbime një një periudhë të caktuar kohe, krahasuar me periudhën paraardhëse. Rritja ekonomike mund të matet në terma nominale, në të cilën përfshihet inflacioni, ose në terma reale, në të cilën nuk përfshihet inflacioni

Sipas Elmendorf dhe Mankiw (1999) borxhi shtetëror është i rëndësishëm për vetë efektet që ai sjell, në mënyrë direkte ose jo, në ekonominë e vendit. Një vend me një borxh të lartë qeveritar priret të përballet me norma të larta interesi, dhe autoriteti monetar mund të gjendet nën presion për t'i ulur këto norma nëpërmjes Politikës Monetare. Kjo strategji mund t'i ulë normat e interesit në afatin e shkurtër, por në afatin e gjatë do të ketë norma reale interesi të pandryshuara dhe një inflacion dhe norma nominale interesi më të larta. Rritja e këtyre dy treguesve, do të pasqyrohet në reduktimin e investimeve private, dhe për rrjedhojë në reduktimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe rritjes ekonomike.

²³Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2006, fq. 6089



Gjithashtu, *borxhi shtetëror mund të ndikojë mbi Politikën Fiskale*. Disa ekonomistë argumentojnë se mundësia e huamarrjes së një qeverie ul disiplinën e procesit të përdorimit të buxhetit. Nëse një qeveri bën shpenzime shtesë, të cilat nuk lidhen me të ardhura nga taksat, atëherë politikëbërësit dhe publiku shqetësohen më pak nëse këto shpenzime janë të duhurat. Përdorimi i koeficientit të fondeve shtesë në mallra konsumi dhe joproductive, nga ana e qeverisë do të përkthehet në një efekt negativ për rritjen ekonomike.

Borxhi shtetëror i lartë e bën ekonominë e një vendi më të prekshme ndaj një krize ndërkombëtare si recensionet dhe humbjet e besimit tek tregjet dhe ndërmjetësit financiar. Një borxh shtetëror i lartë ushtron presion negativ mbi Bankën Qëndrore dhe bankat tregtare nëpërmjet disa kanaleve të ndryshme. Për shembull, ai rrit koston e financimit të institucioneve financiare pas rritjes së riskut të aseteve. Institucioneve financiare, të cilat mbajnë një pjesë të madhe të borxhit shtetëror perceptohen si të riskuara. Atyre mund t'u duhet të paguajnë norma më të larta interesi tek depozituesit dhe të kenë vështirësi në rritjen e fondeve. Ato gjithashtu mund të gjenden nën presion potencial nga Banka Qëndrore për të rritur kapitalin dhe likuiditetin. Këto bëjnë që të rritet kosto e borxhit publik duke ndikuar negativisht në rritjen ekonomike, tek PBB.




Figura 2. Mekanizmat e transimit të rritjes së borxhit publik në rritjen ekonomike.

Burimi: Nautet et al, 2011

Në ekonomi ndeshen të dy anët e veprimit në uljen apo në rritjen ekonomike afatgjatë që jep respektivisht rritja apo ulja e borxhit publik. E shprehur ndryshe, një rritje (ulje) e borxhit publik mund të ketë një efekt negativ (pozitiv) mbi rritjen ekonomike në afatgjatë. Tre kanalet kryesore janë: kanali i kursimeve neto, kanali i koston së shërbimit të borxhit, dhe kanali i besueshmërisë kombëtare. Në Figurën 2. Si më sipër është paraqitur edhe skema sipas së cilës veprojnë këto tre kanale në rritjen apo rënien ekonomike.

Disa studime empirike kanë zbuluar se nivele të larta të borxhit shtetëror kanë një efekt negativ në rritjen ekonomike në vendet në zhvillim (Pattillo et al., 2002; Pattillo et al., 2004; Schclarek, 2004; Kumar dhe Woo, 2010; Patrizio Lainà, 2011).

Në vijim paraqitet Tabela 2 me punimet e autorëve të ndryshëm lidhur me impaktin dhe efektet negative që jep rritja e borxhit publik ndaj PBB-së.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Nr.	Autorët	Vendi	Impakti i Borxhit Publik / PBB-së
1.	Schclarek (2004) Rolin e borxhit të jashtëm mbi rritjen ekonomike për 59 vende në zhvillim për periudhën 1970-2002	Schclarek (2004) Rolin e borxhit të jashtëm mbi rritjen ekonomike për 59 vende në zhvillim për periudhën 1970-2002	Ekziston një impakt linear negativ i borxhit të jashtëm mbi rritjen ekonomike
2.	Patrizio Lainà (2011)	Marrëdhënia dinamike mes borxhit publik dhe rritjes ekonomike në SHBA për periudhën 1959-2010	Borxhi publik ka efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike në afatin e shkurtër, dhe efekt negativ mbi rritjen në afatin e gjatë
3.	Kumar dhe Woo (2010)	Impaktin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike duke u bazuar në një panel prej 38 vendesh të zhvilluara dhe në zhvillim për vitet 1970-2010	Kumar dhe Woo (2010) Impaktin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike duke u bazuar në një panel prej 38 vendesh të zhvilluara dhe në zhvillim për vitet 1970-2010
4.	Chatherine Pattillo, Helene Poirson, Lucca Ricci, (2002)	Impakti jo-linear i borxhit të jashtëm mbi rritjen ekonomike për 93 vende në zhvillim për periudhën 1969-98	Borxhi i jashtëm ka një impakt negativ në rritjen ekonomike për vlera të borxhit mbi 35-40% të PBBsë
5.	Chatherine Pattillo, Helene Poirson, Lucca Ricci, (2004) Kanalet me të cilat borxhi publik ndikon mbi rritjen ekonomike, për 61 vende në zhvillim për periudhën 1969	Chatherine Pattillo, Helene Poirson, Lucca Ricci, (2004) Kanalet me të cilat borxhi publik ndikon mbi rritjen ekonomike, për 61 vende në zhvillim për periudhën 1969-1998.	Impakti negativ i borxhit të lartë publik mbi rritjen ekonomike operon nëpërmjet një efekti të fortë negativ në faktorin e akumulimit të kapitalit fizik dhe atë të rritjes së produktivitetit total të faktorëve të prodhimit

Tabela 2. Punime shkencore për impaktin negative të rritjes borxhit publik ndaj PBB-së. *Burimi: Autori*



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Rritja ekonomike e qëndrueshme ka një rëndësi jetësore për të gjithë ekonominë e vendeve, sidomos për vendet në zhvillim si Shqipëria e cila është përpara sfidave të stabilitetit makroekonomik e politik, uljes së papunësisë dhe anëtarësimit në Bashkimin Europian. Kriza aktuale e borxheve në Europë, padyshim që ka ngritur vëmendjen e shumë ekonomistëve për fenomenin e rritjes së nivelit të huamarrjes nga shumë shtete në zhvillim apo të zhvilluara.

Pavarësisht se Shqipëria, ndryshe nga shumë vende të tjera të zhvilluara, arriti të mbante një nivel rritje ekonomike pozitive prej mesatarisht 4 përqind gjatë periudhës 2007-2012, dhe një stabilitet makroekonomik gjatë viteve të fundit, niveli i lartë i borxhit të saj shtetëror mbi 70% është parë si mjaft shqetësues në sytë e ekonomistëve vendas dhe të huaj.

Rritja e nivelit të borxhit shtetëror mbi nivelin 60 përqind të PBB në vitin 2012 i cili është kufiri i lejuar nga Bashkimi Europian (BE) për vendet që aspirojnë të integrohen në të ngriti shume debate mes politikbërësve opozitar në atë kohë, por kjo u harrua pas ardhjes në pushtet duke bërë që borxhi publik nga PBB-së të kapërcente edhe nivelin e 70%. Vetëm në këto 2 vitet e fundit u vu re një reduktim i nivelit të borxhit publik i cili zbriti në nivelin e 67%, por ngjarjet madhore të vitit 2020 do ta vendosin në rrezikun e ngritjes akoma më të madhe edhe sesa 70%.

Pjesa e borxhit publik afatgjate në Shqipëri do të thotë rrezik i lartë i financimit fiskal, ndërsa në afatin e mesëm, rritja e borxhit publik mund të dëmtojë gjithashtu perspektivën për rritje ekonomike duke ngushtuar hapësirat për kreditim të sektorit privat dhe duke ndikuar në aftësinë e qeverisë për të financuar projekte kyçe të zhvillimit të cilat gjatë viteve të fundit është vënë re se po kryhen përmes Partneritetit Publik Privat (PPP-ve).



KAPITULLI III

3. METODOLOGJIA

3.1 Hyrje

Gjatë punës sime kërkimore kam aplikuar metodat e analizës por edhe të sintezës pasi në një pjesë të punimit duhet të kalojmë nga e përgjithshmja tek individualja. Metodot kryesore të analizës që kam aplikuar janë: analiza logjike, analiza statistikore dhe të dhënat e publikuara në punime të këtyre fushave nga institucionet relevante.

Për t'i arritur qëllimet e synuara në këtë punim ka qenë i domosdoshëm aplikimi i metodave standarde të njohura mbi hulumtimin shkencor. Gjithashtu, për të qartësuar më tej qasjen ndaj këtij procesi të hulumtimit është shfrytëzuar përvoja e gjatë personale në financa dhe kontabilitet dhe zotëruese e titullit Eksperte Kontabël e Çertifikuar.

3.2 Metodot e përdorura në punim

Gjatë punimit të këtij studimi janë përdorur metodologji bashkëkohore shkencore si dhe metodat e analizës kuantitative. Metodologjia dhe metodat e përdorura janë:

1. Deduksioni - kjo metodë mundëson që t'i arrijmë synimet e hulumtimit, duke filluar nga e përgjithshmja dhe duke arritur cakun e synuar, pra, të veçantën. Në këtë rast është studiuar dhe është analizuar situata ku ndodhet Shqipëria lidhur me plotësimin e kriterëve për anëtarësim në BE sipas metodologjisë së aplikuar për çdo vend kandidat të miratuar nga BE, derisa arrijmë tek Kriteri i Politikës Fiskale dhe cilët prej treguesve të saj qëndrojnë të paplotësuar.
2. Deskriptive – këtu janë mbledhur studime dhe raporte të ndryshme që janë marrë me studimin e integritetit të vendeve të rajonit dhe Shqipërisë në BE dhe në veçanti për Krietrin e Politikës Fiskale.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Në këtë rast është përdorur literaturë nga autorë të ndryshëm të huaj dhe pak vendas, si dhe raporte, studime nga agjenci të ndryshme dhe hulumtime të publikuara nga organizma që merren me studime të kësaj fushe. Hartimi i këtij studimi është mbështetur në sa vijon: Në shfrytëzimin e të dhënave të publikimeve të Bashkimit Europian, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, INSTAT, si dhe të institucioneve dhe universiteteve me fusha studimi të specializuara në sfidat e integritit të vendeve kandidatë për t'ju bashkuar BE-së si edhe burime të tjera.

3. Analiza krahasuese - materialet e përdorura në këtë punim janë analizuar si dhe janë krahasuar me njëra-tjetrën me qëllim që të jemi sa më objektiv në hulumtimin e bërë.

4. Modeli ekonometrik - është përdorur për testimin e treguesve dhe faktorët që e afektojnë plotësimin e kriterit të Politikës Fiskale për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Më konkretisht, tregues për plotësim të kriterit të Politikës Fiskale janë reduktimi i defiçitit publik (buxhetor) sipas Traktatit të Maastricht për referencë me vlerë nga 0 deri në -3% të GDP-së si edhe raporti i borxhit ndaj GDP të jetë brenda kufirit të vendosur prej 60%. Teknikat dhe modelet ekonometrike të regresionit janë aplikuar bazuar në të dhënat e marra nga website zyrtar i INSTAT për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2018, përfshirë këtë të fundit. Të dhënat për vitin 2018 janë të dhëna paraprake sipas raportimit që gjendet në database të INSTAT, pavarësisht se të dhënat nga autori i punimit janë përpunuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 dhe testuar përfundimisht në fillim të Marsit 2020. Edhe në Mars 2020, statusi i të dhënave për vitin 2018 vijon të figurojë si të dhëna paraprake dhe të dhënat për vitin 2019 ende nuk janë të publikuara në database të INSTAT. Përveç analizës së 2 treguesve në veçanti, me qëllim thellimin e kërkimit në drejtim të treguesit të përkeqësuar të borxhit publik do ta analizojmë nga këndvështrimi si mund të ndikohet në rritjen e PBB me qëllim që edhe ky



tregues të vijë brenda kufirit të kërkuar, dhe për këtë do të aplikojmë teknikën ANOVA dhe modelet ekonometrike të regresionit ku faktorë të pavarur do të jenë a) të ardhurat në buxhet; b) shpenzimet e qeverisë; c) borxhi publik ndërsa faktor i varur do të jetë GDP.

3. 3 Teknika e analizës së variancës ANOVA

Ndërsa analiza e variancës arriti në rezultate në shekullin e 20-të, paraardhësit e saj shtrihen në disa shekuj në të kaluarën sipas Stiglerit. Këto përfshijnë testimin e hipotezave, ndarjen e shumave të katrorëve, teknikat eksperimentale dhe modelin shtesë. Laplace po kryente testimin e hipotezës në vitet 1770. Zhvillimi i metodave të katrorëve më të vegjël nga Laplace dhe Gauss rreth 1800 siguroi një metodë të përmirësuar të kombinimit të vëzhgimeve (mbi praktikat ekzistuese të përdorura më pas në astronomi dhe gjeodezi). Filloi gjithashtu një studim i madh i kontributeve në shumat e katrorëve. Laplace dinte të vlerësonte një variancë nga sasia e mbetur (sesa një total) shuma e katrorëve.

Deri në 1827, Laplace po përdorte më pak metoda katrorësh për të adresuar problemet ANOVA në lidhje me matjet e baticave atmosferike.

Ronald Fisher prezantoi termin variancë dhe propozoi analizën e tij zyrtare në një artikull të vitit 1918 -Korrelacioni midis të afërmeve për supozimin e trashëgimisë Mendelian. Aplikimi i tij i parë i analizës së variancës u botua në vitin 1921.

Analiza e variancës u bë e njohur gjerësisht pasi u përfshi në librin Metodatat Statistike të Fisherit më 1925 për Kërkuesit Shkencorë. Modelet e rastësisë u zhvilluan nga disa studiues. E para u botua në polonisht nga Jerzy Neyman në 1923. Një nga atributet e ANOVA që siguroi popullaritetin e saj të hershëm ishte eleganca llogaritëse. Struktura e modelit aditiv lejon zgjidhje për koeficientët aditivë me algebër të thjeshtë sesa me llogaritjet e matricës. Në epokën e llogaritësve mekanikë kjo thjeshtësi ishte kritike. Përcaktimi i domethënies statistikore kërkonte gjithashtu



hyrje në tabela të funksionit F të cilat furnizoheshin nga tekste të statistikave të hershme.

Analiza e variancës (ANOVA) është një koleksion i modeleve statistikore dhe procedurave të vlerësimit shoqërues të tyre (siç është "ndryshimi" midis dhe ndërmjet grupeve) që përdoret për të analizuar ndryshimet midis mjeteve të grupit në një mostër. ANOVA u zhvillua nga statisticienë dhe biologë evolucionar Ronald Fisher. ANOVA bazohet në ligjin e variancës totale, ku varianca e vëzhguar në një variabël të veçantë është e ndarë në përbërës që i atribuohen burimeve të ndryshme të variacionit. Në formën e tij më të thjeshtë, ANOVA siguron një test statistikor nëse dy ose më shumë mjete të popullsisë janë të barabarta, dhe për këtë arsye gjeneralizon testin t përtej dy mënyrave.

Analiza e variancës është studiuar nga disa qasje, më e zakonshme prej të cilave përdor një model linear që lidhet me përgjigjen ndaj trajtimeve dhe blloqeve. Vini re se modeli është linear në parametra, por mund të jetë jo linear në të gjithë nivelet e faktorëve. Interpretimi është i lehtë kur të dhënat janë të ekuilibruara midis faktorëve, por shumë më i thellë është i nevojshëm për të dhëna të pabalancuara.

Analiza e variancës mund të paraqitet në lidhje me një model linear, i cili bën supozimet e mëposhtme në lidhje me shpërndarjen e probabilitetit të përgjigjeve.

Modeli linear i derivuar. Kempthorne përdor randomizimin-shpërndarjen dhe supozimin e shtimit të trajtimit njësi për të prodhuar një model linear të prejardhur, shumë i ngjashëm me modelin e librit shkollor të diskutuar më parë.

Statistikat e testit të këtij modeli linear të përftuar janë përafruar nga statistikat e provave të një modeli të duhur linear normal, sipas teoremave të përafrimit dhe studimeve të simulimit. Sidoqoftë, ka ndryshime. Për shembull, analiza e bazuar në randomizim rezulton në një lidhje të vogël por (rreptësisht) negative midis vëzhgimeve. Në analizën e bazuar në randomizim, nuk ka supozim të një shpërndarjeje normale dhe sigurisht asnjë supozim të pavarësisë. Përkundrazi, vëzhgimet janë të varura!



Përmbledhja e supozimeve. Analiza ANOVA e bazuar në model normal supozon pavarësinë, normalitetin dhe homogjenitetin e variancave të mbetjeve. Analiza e bazuar në randomizim supozon vetëm homogjenitetin e variancave të mbetjeve (si pasojë e shtimit të njësisë së trajtimit) dhe përdor procedurën e rastit të eksperimentit. Sidoqoftë, studimet e proceseve që ndryshojnë variancat sesa mesataret (të quajtura efekte shpërndarëse) janë realizuar me sukses duke përdorur ANOVA. Nuk ka supozime të nevojshme për ANOVA në përgjithësinë e tij të plotë, por testi F i përdorur për testimin e hipotezave ANOVA ka supozime dhe kufizime praktike të cilat janë me interes të vazhdueshëm.

Karakteristikat. ANOVA përdoret në analizën e eksperimenteve krahasuese, ato në të cilat interesi është vetëm ndryshimi në rezultate. Rëndësia statistikore e eksperimentit përcaktohet nga një raport i dy varianteve. Ky raport është i pavarur nga disa ndryshime të mundshme në vëzhgimet eksperimentale: Shtimi i një konstante në të gjitha vëzhgimet nuk ndryshon domethënien. Shumimi i të gjitha vëzhgimeve me një konstante nuk ndryshon rëndësinë. Pra, rezultati i domethënies statistikore ANOVA është i pavarur nga paragjykimet dhe gabimet e vazhdueshme, si dhe njësitë e përdorura në shprehjen e vëzhgimeve. Në epokën e llogaritjes mekanike ishte e zakonshme të zbritet një konstante nga të gjitha vëzhgimet (kur është e barabartë me rënien e shifrave kryesore) për të thjeshtuar futjen e të dhënave. Ky është një shembull i kodimit të të dhënave.

Lidhja me regresionin linear. Më poshtë sqarojmë lidhjen midis ANOVA-s shumë-drejtimitëshe dhe regresionit linear.



3.3.1 Analiza e një shembulli të ANOVA

Analiza e modeleve të variancës (ANOVA) studion marrëdhëniet midis variablave të varura dhe një ose më shumë ndryshore të pavarura brenda së njëjtës kornizë siç bëjnë modelet e regresionit linear por nga një këndvështrim tjetër. Fillojmë duke parë nga një perspektivë ANOVA rezultatet e një regresioni duke shpjeguar përgjigjen e parave të pronave me GNP e vërtetë dhe normën e interesit në dokumentin tregtar 90-ditor .

Rezultatet e regresionit në një Kornizë ANOVA

Rezultatet e regresionit ishin si më poshtë:

Variabël i varur:	Holdings Real Money
Konstante	10.47 (3.21)
Shkalla e letrës 90-ditore	-2.62 (0.38)
GNP real	0, 17 (0.01)
R-katror	0.91
Gabim standard ($\hat{\sigma}$)	6.70
Numri i Vëzhgimeve	40
Shkallët e Lirisë	37

Modeli i regresionit mund të shihet si përpjekje për të shpjeguar shumën totale të katrorëve të variablit të varur, zotërimeve të parave reale, duke përdorur dy variabla të pavarura, GNP reale dhe norma nominale të interesit. Mbetja e shumës së katrorëve SSE përfaqëson pjesën e shumës totale të katrorëve SSTO kjo nuk mund të shpjegohet nga variablat e pavarur.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Dhe shuma e katrorëve për shkak të SSR të regresionit përfaqësonin pjesën e shumës totale të katrorëve të shpjeguara nga regresioni. Do të kujtohet që R^2 është raporti i SSR me SSTO. Rezultatet e regresionit më lart japin gabimin standard të regresionit ku σ që është një vlerësim pikësor, σ është rrënja katrore e gabimit mesatar i katrorit NVM. Gabimi mesatar katror në regresionin e mësipërm është kështu:

$$MSE = \hat{\sigma}^2 = 6.702 = 44.89 \text{ pra shuma e gabimeve në katror}$$

$$\text{është } SSE = (n - K - 1) MSE = (37) (44.89) = 1660.93.$$

Meqenëse koeficienti i përcaktimit, R^2 , është i barabartë

$$R^2 = \frac{SSR}{SSTO} = \frac{SSTO - SSE}{SSTO} = 1 - \frac{SSE}{SSTO}$$

Rrjedh se

$$R^2 SSTO = SSTO - SSE \Rightarrow (1 - R^2) SSTO = SSE,$$

Kështu që, duke pasur parasysh R^2 dhe SSE, mund të llogaritim SSTO nga marrëdhënia

$$SSTO = \frac{SSE}{1 - R^2} = \frac{1660.93}{1 - 0.91} = \frac{1660.93}{0.08} = 18454.78$$

Shuma e katrorëve për shkak të regresionit bëhet atëherë

$$SSR = SSTO - SSE = 18454.78 - 1660.93 = 16793.85.$$

Tani varianca e variablës së varur, zotërimeve të parave reale, është totali shuma e katrorëve të ndara me $(n - 1)$, shkallët e lirisë përkatëse duke e llogaritur një vëzhgim nga n -të në dispozicion është përdorur për të llogaritur mesataren e ndryshores së varur.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Dhe kemi parë që gabimi të variancës vlerësohet duke e ndarë shumën e gabimeve në katror me $(n - K - 1)$, numrin e shkallëve të lirisë të rëndësishme për llogaritjen, kështu kemi përdorur pjesë të informacionit K duke llogaritur koeficientët e regresionit të variablave të pavarur dhe një pjesë e informacionit për të llogaritur termin e konstantes, duke lënë vetëm $(n - K - 1)$ mbetje të pavarura katrorësh.

Më në fund, mund të identifikojmë shkallët e lirisë së përdorur në llogaritjen e shumës së katrorëve për shkak të regresionit (SSR). SSR është shuma e devijimeve në katror të vlerave të montuara të ndryshores së varur nga mesatarja e të varurve të ndryshueshme,

$$SSR = \sum_{i=1}^n (Y_i - \bar{Y})^2$$

Nuk janë vlera të montuara \hat{Y} që për nga natyra e llogaritjeve janë të kufizuara të shtrihen përgjatë vijës së montuar. Shkallët e mundshme të lirisë në llogaritjen e kësaj linje janë parametrat e saj $K + 1$ - në lidhje me variablat e pavarur K . Një nga këto shkallë të lirisë humbet sepse vetëm $n - 1$ nga $Y_i - \bar{Y}$ janë të pavarur devijimet duhet të plotësojnë kufizimin $\sum_{i=1}^n (Y_i - \bar{Y}) = 0$ kështu që nëse dimë ndonjë $n - 1$ të këtyre devijimeve, dimë edhe devijime të tjera.

Shuma e katrorëve për shkak të regresionit llogaritet kështu me K shkallë lirie (Dy në shembullin e mësipërm). Kështu që mund të llogarisim variancën për shkak të regresionit (d.m.th. regresioni nënkupton katrorin) si

$$MSR = \frac{SSR}{K} = \frac{16793.85}{2} = 8396.925$$



Këto analiza të rezultateve të variancës mund të paraqiten në ANOVA në vijim

Tabela:

Analiza e Variancës			
Burimi i variancës	Shuma e katrorëve	Shkallët e lirisë	Katrori i mesatares
Regresioni	16793.85	2	8396.925
Gabimi	1660.93	37	44.89
Totali	18454.78	39	

Vini re se si shkalla totale e lirisë është shuma e shkallëve të lirisë për llogaritjen e shumës së regresionit të katrorëve dhe shkallët e lirisë për llogaritjen e shumës së gabimeve në katror. Dhe, siç tregohet më parë shuma e përgjithshme e katrorëve është e barabartë me shumën e katrorëve për shkak të regresionit plus shumës së gabimit të katrorëve. Është veçanërisht e rëndësishme të vihet re se katrori mesatar për shkak të regresionit dhe gabimit mesatar katror nuk shton deri në barazimin e variancës e cila në rastin e mësipërm është $18454.78 / 39 = 473.2$. Statistikat F për testimin e hipotezës së pavlefshme të asnjë marrëdhënie midis regresionit dhe ndryshores së varur është

$$\begin{aligned}
 F &= \frac{\sum_{i=1}^n (Y_i - \bar{Y})^2 - \sum_i e_i^2}{K} \div \frac{\sum_i e_i^2}{n - K - 1} \\
 &= \frac{SSTO - SSE}{K} \div \frac{SSE}{n - K - 1} \\
 &= \frac{MSR}{MSE} = \frac{8396.925}{44.89} = 185.72
 \end{aligned}$$

,që tejkalon shumë vlerën e F (2, 37) në tabelat statistikore për në ndonjë nivel të arsyeshëm i α .



3.4 Regresion i thjeshtë linear

Tani i drejtohem fushës së statistikave që është më e rëndësishme për atë që ekonomistët zakonisht bëjnë analizën e marrëdhënieve ndërmjet variablave. Këtu do përqendrohemi plotësisht në marrëdhëniet lineare. Për shembull, mund të jemi të interesuar në marrëdhëniet midis sasisë së parave të kërkuara dhe vëllimit të transaksioneve që njerëzit bëjnë siç përfaqësohet nga niveli të ardhurave të parave. Ose mund të jemi të interesuar për marrëdhëniet midis shpenzimeve familjare për ushqimin dhe të ardhurat familjare dhe madhësinë e familjes. Analiza e regresionit përdoret për të analizuar dhe parashikuar marrëdhëniet midis përgjigjes ose variablit të varur (pronat e parave dhe shpenzimet familjare për ushqimin në shembujt e mësipërm) dhe një ose më shumë të pavarura, shpjeguese ose variablave parashikuese. Në shembullin e kërkesës për para, variablin e vetëm të pavarur ishte niveli i të ardhurave; në shembullin e shpenzimeve të ushqimit familjar, kishte dy ndryshore të pavarura, të ardhurat familjare dhe madhësia e familjes.

Ne duhet të bëjmë dallimin e dy llojeve të marrëdhënieve ndërmjet ndryshoreve.

Marrëdhënia përcaktuese ekziston nëse vlera e Y përcaktohet në mënyrë unike kur specifikohet vlera e X — marrëdhënia midis dy ndryshoreve është e saktë. Për shembull, mund të kemi


$$Y = \beta X$$

ku β është konstante. Nga ana tjetër, mund të ketë një marrëdhënie midis dy ndryshoreve që përfshin disa komponentë të rastit ose gabim të rastësishëm. Kjo marrëdhënie quhet një mundësi apo marrëdhënie statistike. Në këtë rast mund të kemi

$$Y = \beta X + \epsilon$$



i cili mund të shihet si një model probabilistik që përmban dy përbërës: *përbërësi përcaktues β_x plus një gabim i rastësishëm ϵ* . Figura më poshtë paraqet një shembull të një marrëdhënie përcaktore të vijës së drejtpërdrejtë midis X dhe Y përgjatë të cilit qëndrojnë të gjitha kombinimet e vëzhguara të dy ndryshoreve. Një shembull i një marrëdhënie probabliste ka një shpërndarje të kombinimeve të vëzhguara të X dhe Y rreth një funksioni linear ose marrëdhënie përcaktuese që tregon gabime në përshtatshmërinë që vijnë nga ndikimi në Y të faktorëve të panjohur përveç X. Për secilin nivel të X ekziston një shpërndarje e probabilitetit të Y. Dhe mjetet e këtyre probabiliteteve të shpërndarjeve Y ndryshojnë në mënyrë sistematike me nivelin e X.



Grafiku 1. Modeli i thjeshtë i regresionit linear


3.4.1 Modeli i thjeshtë i regresionit linear

Kur marrëdhënia statistikore është lineare modeli i regresionit për vëzhgimin Y_i merr formën

$$Y_i = \beta_0 + \beta_1 X_i + \epsilon_i$$



Ky është raporti funksional ose përcaktues midis variablave dhënë nga $\beta_0 + \beta_1 X_i$ dhe është komponenti i shpërndarjes së rastësishme. Y_i është variabla e varur për vëzhgimin e i -të, X_i është variabla e pavarur për vëzhgimin e i -të, supozohet se janë jo-të rastit, β_0 dhe β_1 janë parametra dhe i janë devijimet e Y_i nga nivelet e parashikuara të tyre bazuar në X_i , β_0 dhe β_1 .



Grafiku 2. Një probabilitet ose marrëdhënie statistike ndërmjet X dhe Y.

Termi i gabimit supozohet se ka këto karakteristika:

- ϵ_i shpërndahet normalisht.
- Vlera e pritur e termit të gabimit, e treguar nga ϵ_i , është i barabartë me zero.
- Variacioni i ϵ_i është konstant, σ^2 .
- ϵ_i janë statistikisht të pavarur - domethënë, kovariancën midis ϵ_i dhe ϵ_j është zero.


Me fjalë të tjera,

$$\epsilon_i = N(0, \sigma^2).$$

Ky supozim i normalitetit për i -të është mjaft i përshtatshëm në shumë raste.



Shpesh ka shumë faktorë që ndikojnë në Y përveç atyre të pavarura variabël (ose, siç do ta shohim më vonë, variablat) në modelin e regresionit. Aq pasi efektet e këtyre ndryshoreve janë shtesë dhe prirën të ndryshojnë me një shkallë të pavarësisë së ndërsjellë, mesatarja e tyre (dhe shuma e tyre) do të prirën drejt normalitetit sipas teoremës së kufirit qendror kur numri i këtyre ‘zhdukur’ faktorët janë të mëdhenj. Shpërndarja e termit të gabimit dhe niveleve që rezultojnë e Y në nivele të ndryshme të X është dhënë në figurën.



Grafiku 3. Regression i thjeshtë i Y në X. Shpërndarja probabilitare e Y në X

Meqënëse termi i gabimit është një ndryshore e rastësishme, kështu është edhe ndryshorja e varur Y_i . Vlera e pritur e Y_i është e barabartë

$$\begin{aligned} E \{ Y_i \} &= E \{ \beta_0 + \beta_1 X_i + \epsilon_i \} \\ &= E \{ \beta_0 \} + E \{ \beta_1 X_i \} + E \{ \epsilon_i \} \\ &= \beta_0 + \beta_1 E \{ X_i \} + 0 \\ &= \beta_0 + \beta_1 X_i \end{aligned}$$



Ku $E\{X_i} = X_i$ sepse këto X_i janë një seri jo e rastësishme e paracaktuar numrash. Ekuacioni, marrëdhënia themelore përcaktuese si më lart quhet funksioni i regresionit. Thjesht vija e mesatareve që lidhet me mesataren e Y deri në vlerën e ndryshores së pavarur X , parametri β_1 është pjerrësia e kësaj linje dhe β_0 është prerja me boshtin.

Ndryshueshmëria e Y_i dhënë X_i është e barabartë

$$\begin{aligned} \text{Var}\{Y_i | X_i\} &= \text{Var}\{\beta_0 + \beta_1 X_i + \epsilon_i\} \\ &= \text{Var}\{\beta_0 + \beta_1 X_i\} + \text{Var}\{\epsilon_i\} = 0 + \text{Var}\{\epsilon_i\} = \sigma^2 \end{aligned}$$

Ku funksioni i regresionit $\beta_0 + \beta_1 X_i$ është përcaktor dhe për këtë arsye nuk ndryshon. Kështu Y_i kanë të njëjtën ndryshueshmëri rreth mesatareve të tyre X_i .


Më në fund, pasi supozohet të jetë i pavarur për vëzhgimet e ndryshme, kështu janë kushtëzuar Y_i me X_i . Prandaj rrjedh se $Y_i = N(\beta_0 + \beta_1 X_i, \sigma^2)$

3.4.2 Vlerësimi i parametrave të regresionit

Vlerësimet e pikave të β_0 dhe β_1 mund të merren duke përdorur një numër alternative vlerësimesh. Metoda më e zakonshme e vlerësimit është metoda e katrorëve më të vegjël. Kjo metodë përfshin zgjedhjen e vijës së vlerësuar të regresionit kështu që shuma e devijimeve katrore të Y_i nga vlera e parashikuar nga linja minimizohet. Le të tregojmë devijimet e Y_i nga të pajisurit linja e regresionit nga e_i dhe vlerësimet e katrorëve tanë të β_0 dhe β_1 nga b_0 dhe përkatësisht b_1 . Atëherë kemi

$$Q = \sum_{i=1}^n e_i^2 = \sum_{i=1}^n (Y_i - b_0 - b_1 X_i)^2$$

Ku Q është shuma e devijimeve katrore të Y_i nga vlerat e parashikuara nga rreshti.



Grafiku 4. Përshtatja e katrorëve më të vegjël në shumën e distancave vertikale në katror e të dhënave në linjën e katrorëve më të vegjël.

Procedura e vlerësimit të katrorëve më pak përfshin zgjedhjen e b_0 dhe b_1 , ndërprerja dhe pjerrësia e linjës, në mënyrë që të minimizohet Q . Kjo minimizon shumën e gjatësive katrore të vijave vertikale në figurën. Ku $x = (X_i - \bar{X})$ dhe $y = (Y_i - \bar{Y})$ janë devijimet e ndryshoreve nga mesataret e tyre përkatëse për $i = 1, \dots, n$. Vlerësuesit më të vogël të katrorëve b_0 dhe b_1 janë të paanshëm dhe, siç mund të shihet, varet në mënyrë lineare nga vlerat n të mostrës Y_i . Mund të tregohet se vlerësuesit më të vogël të katrorëve janë më efikasë d.m.th. Variancë më e ulët se të gjithë vlerësuesit e tjerë të mundshëm të paanshëm të β_0 dhe β_1 që varen në mënyrë lineare nga Y_i . Vlerësuesit e β_0 dhe β_1 gjithashtu mund të zhvillohen duke përdorur metodën maksimale gjasat (nën supozimin se ϵ_i janë shpërndarë normalisht). Këta vlerësues rezultojnë të jenë identikë me vlerësuesit e të katrorëve më të vegjël.



Llogaritja e linjës së regresionit kryhet duke përdorur procedurën në vijim:

- a) Llogarit devijimet e X_i dhe Y_i nga mesataret e tyre përkatëse.
- b) Katrori i shmangieve e X_i dhe i përmbledh ato.
- c) Shumohen devijimet X_i me devijimet përkatëse Y_i dhe shumojini ato.
- d) Njehsohen këto shuma të katrorëve të vegjël dhe produkteve kryq për të marrë b_1 , funksioni i regresionit është:

$$Y = b_0 + b_1 X;$$

I vlerësuar si \hat{Y} është referuar si vlera e parashikuar e Y .

Për të bërë konkluzione (d.m.th., ndërtoni intervale besimi dhe bëni testet statistikore) në analizën e regresionit duhet të vlerësojmë madhësinë e rastit të ndryshimit në Y . Në matim shpërndarjen e vëzhgimeve përreth vijës së regresionit duke krahasuar vlerat e vërejtura Y_i me parashikimet vlerat e shoqëruara me X_i përkatëse. Dallimi midis vlerave të vëzhguara dhe të parashikuara për vëzhgimin e i -te është mbetja për këtë vrojtım.

Për të kryer konkluzione statistikore në lidhje me parametrat e regresionit do t'ju duhet një vlerësim i variancës së termit të gabimit. Një mënyrë e qartë për të vazhduar është të punohet me shumën e devijimeve katrore të vrojtuarve në nivelet e Y nga nivelet e parashikuara - d.m.th,

$$\sum_{i=1}^n (Y_i - \hat{Y})^2 = \sum_{i=1}^n e_i^2$$



Rezulton se mesatarja ose mesatarja e këtyre devijimeve në katror është vlerësues i përshtatshëm të σ^2 , me kusht që të pranojmë se të gjithë n nga këto devijimet nuk janë të pavarura. Meqenëse kemi përdorur të dhënat e mostrës për të vlerësuar dy parametra, b_0 dhe b_1 , kemi përdorur dy nga n pjesët e informacionit të përfshira në kampion. Prandaj, ka vetëm $n - 2$ katror të pavarur devijime d.m.th., $n - 2$ shkallë lirie. Prandaj, në marrjen e mesatares pjesëtojmë me $n - 2$ në vend të n . Një vlerësues i paanshëm i σ^2 është:

$$MSE = \frac{\sum_{i=1}^n e_i^2}{n-2}$$

Ku MSE është termi për gabim mesatar katror. Në përgjithësi, një katror mesatar është një shume e katroreve të ndare me shkallët e lirisë me të cilat është llogaritur. Kjo shumë totale e shesheve mund të ndahet në përbërës duke shtuar dhe zbritja \hat{Y} si më poshtë:

3.4.3 Koeficienti i Korrelacionit midis X dhe Y

Koeficienti i korrelacionit midis ndryshoreve të rastit, X dhe Y ka më parë ishin përcaktuar si

$$\rho = \frac{\text{Cov}\{XY\}}{\sqrt{\text{Var}\{X\}\text{Var}\{Y\}}}$$

Një vlerësues i duhur i ρ është:



$$r = \frac{\sum_{i=1}^n (X_i - \bar{X})(Y_i - \bar{Y})}{\sqrt{\sum_{i=1}^n (X_i - \bar{X})^2 \sum_{i=1}^n (Y_i - \bar{Y})^2}}$$

Ashtu si në rastin e koeficientit të korrelacionit të vërtetë ρ , r mund të ndryshojë midis minus dhe plus. Në situatën aktuale, megjithatë, X_i supozohet fiks — d.m.th., nuk ndryshon nga kampioni në mostër — në mënyrë që X të mos jetë e rastësishme e ndryshueshme.

Sidoqoftë, r është akoma një masë e përshtatshme e shkallës së shoqërimit midis ndryshores Y dhe niveleve fikse të X . Për më tepër, në katror marrim:

$$r^2 = \frac{\left(\sum_{i=1}^n (X_i - \bar{X})(Y_i - \bar{Y}) \right)^2}{\sum_{i=1}^n (X_i - \bar{X})^2 \sum_{i=1}^n (Y_i - \bar{Y})^2}$$

e cila në rezultat mund të tregohet se është e barabartë R^2 siç përcaktohet më lart.



KAPITULLI IV

4. ANALIZA (TRAJTIMI EMPIRIK)

4.1. Hyrje

Referuar nenit 119 të Versionit të konsoliduar të Traktatit²⁴ për Funkcionimin e Bashkimit European / Titulli VIII: Politika Ekonomike dhe Monetare janë përcaktuar shtyllat kryesore me të cilat çdo vend anëtar dhe vend që aderon për t'u anëtarësuar duhet të jetë në përputhshmëri ose pajtueshmëri të plotë. Këto shtylla bazë sipas Traktatit të Mاستrihtit janë: çmime të qëndrueshme, **financa të shëndosha publike** dhe kushte monetare dhe një bilanc të qëndrueshëm të pagesave.

Bazuar në analizën e bërë gjatë rishikimit të literaturës, për plotësimin e treguesve dhe kriterëve për integrimin e Shqipërisë në BE nuk ka më vend për ndërhyrje në drejtim të politikës monetare dhe politikës së kursit të këmbimit. Por, veçse politika fiskale ka mbetë si mjeti i vetëm për të dhënë reagim për disa prej goditjeve makroekonomike të brendshme ose të jashtme si edhe plotësimin e kriterit të kërkuar lidhur me financat e shëndosha publike. Gjithashtu, edhe pas pjesëmarrjes së Shqipërisë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar të BE-së, politika fiskale do të mbetet mjeti i vetëm nën kontrollin e qeverisë së Shqipërisë për të zbatuar dhe ruajtur ekuilibrin makroekonomik të vendit.

Duke pasur parasysh krizën botërore të pas vitit 2008, pasojat e tij dhe rrënimin ekonomik në rastin e Greqisë, evidentojmë edhe njëherë rëndësinë që ka Politika Fiskale, saktësia dhe simetria e të dhënave statistikore dhe transparenca në komunikim me organizmat e BE-së ku aderojmë të integrohemi.

²⁴Source: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2008:115:0001:01:EN:HTML>



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Rasti i Greqisë vërteton me dhimbje ekspozimin e së vërtetës së manipulimit të statistikave zyrtare për paraqitjen e shëndetshme të financave publike por që në fakt rezultuan të kishin pasur një menaxhim të dobët fiskal nga qeverisjet e vendit dhe pasojat i paguan populli.

Treguesit e menaxhimit të shëndetshëm të financave publike janë bërë vendimtare në ditët e sotme dhe si rrjedhim kujdesi në adresimin e duhur të plotësimit të treguesve të politikës fiskale merr prioritet në menaxhimin e sfidave për integrimin e shëndetshëm të Shqipërisë në BE. Si rrjedhim, kujdesi dhe mirë qeverisja e politikave fiskale të qëndrueshme është bërë argumenti i ditës.

Studimet dhe kërkimet rreth mirë qeverisjes së politikave fiskale vijojnë në çdo vend të zhvilluar pavarësisht qëndrueshmërisë dhe stabilitetit ekonomik që ata zotërojnë.


Si rrjedhim, në të tilla situata ekonomike ku rritja ekonomike është anemike dhe stabiliteti financiar mund të vihet në rrezik në çdo moment, del e nevojshme kryerja e studimeve dhe kërkimeve rreth mirëqeverisjes së politikave fiskale sidomos për vendet në zhvillim si Shqipëria, dhe vendet e tjera të Ballkanit Jug-Perëndimor të cilat synojnë integrimin në BE. Kriteret e konvergjencës së BE-së në lidhje me pozicionin buxhetor të qeverisë përcaktohen në pikën e dytë të nenit 140 (1) të Traktatit.

Në pikën e dytë të nenit 140 (1) të Traktatit është e përcaktuar qartë rëndësia që i është dhënë "qëndrueshmërisë së financave publike të qeverisë" dhe monitorimi që i bëhet çdo vendi kandidat duke ju kërkuar plotësim të kriterëve sipas standardeve para se ato të pranohen në BE dhe pasi ato të jenë anëtare të BE-së. Çdo kërkesë sipas neneve të tjera të Traktatit për shtetin anëtar i kalon si kërkesë edhe për çdo shtet kandidat.

4.2. Ecuria e normës së rritjes së PBB-së

Bazuar në të dhënat e marra nga raportet dhe publikimet e gjetura në burimet zyrtare si ato të INSTAT dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për këtë punim ndërtova grafikun si në vijim

Grafiku 5. Ecuria e normës së rritjes së PBB-së



Burimi: Të dhënat marrë nga INSTAT, përpunuar nga autori

Aktiviteti ekonomik në Shqipëri është përsheptuar vitet e fundit. Rritja e PBB-së ishte mesatarisht 4.1% në 2018, nga 3.8% në 2017 dhe 3.4% në 2016. Ekonomia mbështetet nga kushtet e favorshme të financimit, fluksi i IHD-ve, besimi i lartë i biznesit dhe përmirësimi i mjedisit të jashtëm. Rënia e papunësisë dhe rritja e niveleve të përdorimit të kapaciteteve sugjerojnë që ekonomia po i afrohet potencialit të saj.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Shkalla e rritjes ekonomike të Shqipërisë ka vazhduar të përshpejtohet gjatë vitit 2018 dhe kështu pritej të vazhdonte edhe për vijimin e rritjes graduale për 2019 dhe duke arritur në rreth 4.5% në 2021, mbështetur nga bazat e përmirësuara të makroekonomisë. Shpenzimet e konsumatorit gjithashtu pritet të marrin mbështetje të mëtejshme nga rritja e hyrjes së remitancave nga emigrantët e rinj, rritja pagave, etj. Pritet një rritje e eksportit, bazuar në supozimin se çmimi i naftës do të stabilizohet dhe rritja e vitit të kaluar në turizmin e huaj do të vazhdojë. Tërmeti që goditi Shqipërinë dhe rritja më e fortë e importit nga çfarë ishte parashikuar duket të jetë rreziqet kryesore për rritjen reale të PBB-së.

Mbajtja e rimëkëmbjes së vazhdueshme ekonomike kërkon përpjekje të mëtejshme për reforma dhe zgjidhje të tij dobësi makroekonomike në raport me financat publike dhe sektorin financiar. *Dobësitë e qëndrueshme makroekonomike dhe pengesat strukturore për rritjen edhe shëndoshjen e financave publike kërkon përpjekje të vazhdueshme nga qeverisja e vendit për të adresuar sfidat kryesore dhe në veçanti reduktimin e raportit të Borxhit Publik ndaj PBB-së përmes reduktimit të ekonomisë informale dhe evazionit fiskal. Konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit publik është thelbësore për uljen e rreziqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.*


Kornizë fiskale në këto vitet e fundit përfshin politikat buxhetore, të cilat mbështesin rritjen ekonomike dhe kompensojnë efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike të Qeverisë Qëndrore në një afat të shkurtër dhe të mesëm ruhen mesatarisht 5% të PBB-së, e cila është e rëndësishme për të nxitur kërkesën agregate në një afat të shkurtër dhe për të zhvendosur rritjen e mundshme në planin afatmesëm dhe afatgjatë.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Gjithashtu, duke u bazuar në të dhënat e marra nga raportet dhe publikimet e gjetura në burimet zyrtare si ato të INSTAT dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për këtë punim ndërtova parashikimin e ecurisë së normës së rritjes së PBB-së sipas grafikut si në vijim.

Grafiku 6. Parashikimi për ecuria e normës së rritjes së PBB-së



Burimi: Të dhënat marrë nga INSTAT, përpunuar nga autori

Politika fiskale në planin afatmesëm do të mbetet e orientuar qartë drejt konsolidimit fiskal, në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin e Buxhetit Organik, si dhe rekomandimet e dhëna nga KE dhe të përfunduara në Konkluzionet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në maj 2018. Konsolidimi fiskal synon të vazhdojë raportin e borxhit të trajektores rënëse ndaj PBB-së, e cila filloi në vitin 2016, duke synuar një nivel nën 60% në 2021. Ky objektiv afatmesëm për borxhin publik parashikon balanca pozitive vjetore (sufiçiti kryesor) me një mesatare vjetore prej rreth 1% të PBB-së gjatë 2019-2021 dhe një defiçit mesatar të përgjithshëm rreth 1.5% të PBB-së.

Nga qeveria e Shqipërisë është synuar një bilanc parësor pozitiv dhe në rritje në vitet 2019-2021, përkatësisht 0.5% të PBB-së në 2019; 0.9% në vitin 2020; dhe 1.5 % në 2021.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Po ashtu, bilanci aktual, i përcaktuar këtu si diferenca midis investimeve publike dhe defiçitit vjetor, është synuar në nivele të larta dhe gradualisht në rritje për periudhën afatmesme. Bilanci aktual në periudhën afatmesme është synuar në nivelin e 3.3% të PBB-së në vitin 2019, 3.4% në vitin 2020 dhe 3.7% në 2021. Në të njëjtën kohë, ky kornizë fiskale përfshin politikat buxhetore të cilat mbështesin rritjen ekonomike. Investimet publike të qeverisë qendrore në një afat të shkurtër dhe të mesëm ruhen mesatarisht 5% të PBB-së, e cila është e rëndësishme për të nxitur kërkesën agregate në një afat të shkurtër dhe për të zhvendosur rritjen e mundshme në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Vazhdimi i reformave të menaxhimit të financave publike është thelbësore për të rritur efikasitetin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për të krijuar hapësirë për shpenzime më produktive në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Rritja ekonomike parashikohet të mbetet mbi nivelin e 4% gjatë tre viteve të ardhshme 2019-2021, duke vazhduar një përshpejtim, megjithëse marxhinal, gjatë këtyre viteve. Më konkretisht, rritja ekonomike afatmesme e Shqipërisë parashikohet të shënojë nivelet prej 4.3% në vitin 2019; 4.4% në vitin 2020; dhe 4.5% në vitin 2021. Në planin afatmesëm, rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit pritet të transmetohen në një rritje graduale të pagave që pritet të stimulojnë më tej të ardhurat e disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në stimulimin e kërkesës së konsumatorit, si dhe intensifikimin e tendencës së konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nga individët përmes një niveli më të lartë të kredive të marra nga shqiptarët.

Ndërkohë, kreditë për konsumatorët parashikohet të nxiten si nga përmirësimi i kushteve individuale financiare ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ndërsa rritja e investimeve pritet të reflektojë përdorimin tashmë më intensiv të kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe përsheptimin e aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikimit, si dhe përmirësimin e përgjithshëm të perceptimit të investitorëve për stabilitetin makroekonomik të vendit e cila mund të reflektohet dhe në një rrezik më të ulët në periudhat mesatare dhe afatgjatë. Konsumi individëve për periudhën afatmesme (2019-2021) parashikohet të rritet në terma realë me 3% mesatarisht në vit, duke kontribuar me një mesatare prej 2.7 % rritje në normën vjetore.

Ndërsa investimet parashikohet të rriten në terma realë me një mesatare prej 6.2% në vit, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej 1.5 % në vit. Kërkesa e jashtme neto pritet të ketë një efekt pozitiv marxhinal, pothuajse neutral në planin afatmesëm. Eksportet e mallrave pritet të kenë një prirje pozitive, duke supozuar se nuk do të ketë tronditje të konsiderueshme negative ndaj naftës dhe çmimeve të mineraleve në tregjet ndërkombëtare. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimeve për turizmin, pritet të vazhdojnë gjithashtu trendin pozitiv të regjistruar në të kaluarën. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2019-2021 parashikohet të rriten në terma reale me një mesatare prej 7.0% në vit, me një kontribut mesatar pozitiv prej 2.2 pp në vit në rritjen totale. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohet të zgjerohet me 4.7%, me një kontribut mesatar negativ në rritjen totale me rreth -2.1 pp në vit. Si pasojë, kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut shumë pak pozitiv në rritjen totale me një mesatare prej 0,1 % në vit.

Pra, politika fiskale do të vazhdojë të orientohet qartë drejt konsolidimit në afat të mesëm dhe afat të gjatë.

Politika buxhetore e qeverisë do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi për të ruajtur një nivel të investimeve publike në rreth 5% të PBB-së në 2019-2021 me qëllim që të mbajë nivele relativisht të larta të rritjes në planin afatmesëm dhe afatgjatë.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Nga ana tjetër, nivelet relativisht të ulëta të huamarrjes së re të qeverisë të parashikuara për një afat të mesëm do të lënë më shumë hapësirë për sektorin privat dhe do të krijojnë stimuj për grumbullimin e investimeve private. Meqenëse presionet inflacioniste priten të mbesin të ulëta, Shqipëria do të ketë nevojën e aplikimit të qëndrimeve lehtësuese të politikës monetare të parashikuar për një afat të mesëm me qëllim mbështetjen e konsumit privat dhe investimeve.

Për rrjedhojë, konsolidimi fiskal i synuar i qeverisë do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një shtytës i rritjes për periudhën afatmesme. Sidoqoftë, konsolidimi fiskal do të zvogëlojë primin e rrezikut në planin afatmesëm dhe do të rrisë hapësirën për stimulimin e sektorit privat. Në të njëjtën kohë, përbërja e politikave buxhetore të planifikuara është mbështetëse e rritjes dhe prandaj efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal pritet të kompensohen.

Skenari Optimist: Sipas parashikimit në grafikun më sipër në 2024, PBB do të jetë 8.8%. Ndërsa në rastin e skenarit makroekonomik "optimist", raporti i të ardhurave ndaj PBB-së supozohet në të njëjtin nivel si në skenarin fillestar. Politika e përgjithshme fiskale konsoliduese është planifikuar të ruhet në secilin skenar makroekonomik. Sidoqoftë, objektivi sasior i defiçitit fiskal vjetor ndryshon në një farë mase në secilin skenar që reflekton një rregullim kundërciklik drejt dinamikës së supozuar të ciklit ekonomik.

Skenari Pesimist: Sipas parashikimit në grafikun më sipër në 2024, PBB do të jetë 1.4%. Korniza fiskale do të bazohet në një elasticitet më të ulët tatimor sesa baza fillestare në rastin e skenarit makroekonomik "pesimist", i cili supozon një rritje të konsiderueshme më të ulët ekonomike sesa baza fillestare e parashikuar për çdo vit. Ky supozim pasqyron arsyetimin se përgjithësisht një nivel i konsiderueshëm më i ulët i rritjes ekonomike pritet të çojë në efikasitet më të ulët të mbledhjes së taksave për një numër të komponentëve kryesorë të taksave.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Zëri kryesor i shpenzimeve që janë planifikuar të thithin shumicën e efekteve fiskale në rastin e secilit skenar alternative janë "shpenzimet kapitale me financim të brendshëm". Megjithëse ekziston një linjë e qartë e kushteve të paparashikuara për tronditjet e normave të interesit në buxhetet afatmesme, si dhe rreziqe të tjera të nënkuptuara, pavarësisht se nuk llogariten ex-ante për të përmbushur objektivat e defiçitit në skenarin pesimist.

Sidoqoftë, në praktikë (ex post), në rast se të ardhurat rezultojnë të jenë më të ulta se niveli fillestar, por në të njëjtën kohë nuk do të ketë tronditje në normat e interesit dhe për këtë arsye nuk ka shpenzime shtesë të interesit, atëherë shumat fillestare të buxhetuara (që është më së shumti rast i besueshëm), do të kishte nevojë për një shtresë mbrojtëse (buffer) në intervalin prej rreth 0.3 përqind të PBB-së për çdo vit, i cili do të ishte automatikisht në dispozicion për të thithur një pjesë të presioneve fiskale në rast të një skenari pesimist. Gjithashtu, nevojat më të larta për financimin e defiçitit në rastin e skenarit -pesimistll pritet të mbulohen nga huamarrja neto më e lartë. Implikimet fiskale të makro-skenarëve alternative janë paraqitur në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm.

Parashikimi për rritje të PBB-së prej rreth 4% nuk është i kuptueshëm në kontekstin aktual, por trajektorja e parashikuar **për 2019-2020 dukej optimiste**. Përshpejtimi i qëndrueshëm i prodhimit në 2019-2020 ka të ngjarë të parandalohet duke ngadalësuar aktivitetin e investimeve pasi dy projektet e mëdha të energjisë i afrohen përfundimit por edhe demotivimi i investitorëve si pasojë e tërmetit.

Duhet të kemi në konsiderat, rënien e efektit negativ në rritjen e PBB-së që ka ardhur nga zbutja e ritmit të rritjes së importit. Moderime të ngjashme të rritjes mund të gjenden në parashikime nga institucionet ndërkombëtare. Përveç projeksionit bazë, për vitin 2019 paraqiten edhe dy skenarë të rritjes alternative.



Në skenarin pesimist, projeksioni bazë është zhvendosur poshtë me 1.5 pikë përqindje (pps) gjatë periudhës së programit. Në skenarin optimist, projeksioni bazë është zhvendosur lart me 1.0 pikë përqindje. Skenarët thuhet se përfshijnë situata në të cilat, rreziqet materializohen në lidhje me faktorë të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm.

4.3. Treguesit sipas Nenit 126-të (ex-article 104 TEC) të Traktatit të Mاستrihtit

Referuar Nenit 126-të (ex-article 104 TEC) të Traktatit ku në vijim citohet se: Komisioni i BE monitoron zhvillimin e situatës buxhetore dhe të stokut të borxhit qeveritar, në veçanti, ai do të shqyrtojë pajtueshmërinë me disiplinën buxhetore në bazë të dy kritereve:

(a) nëse **raporti i defiçitit qeveritar** të planifikuar ose aktual **ndaj produktit të brendshëm bruto** *tejkalon një vlerë reference, përveç nëse:* - ose raporti ka rënë ndjeshëm dhe vazhdimisht dhe ka arritur një nivel që i afrohet vlerës së references; - ose, përndryshe, teprica mbi vlerën e referencës është vetëm e jashtëzakonshme dhe e përkohshme dhe raporti mbetet afër vlerës së referencës; si edhe

(b) Nëse **raporti i borxhit të qeverisë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto** *tejkalon një vlerë reference, përveç nëse* raporti po zvogëlohet në mënyrë të duhur dhe i afrohet vlerës së referencës me një ritëm të kënaqshëm.

Bazuar po në këtë nen të Traktatit, nëse një shtet anëtar nuk i përmbush kërkesat sipas një ose të dy këtyre kritereve, Komisioni përgatit një raport. Raporti i Komisionit gjithashtu merr parasysh nëse *defiçiti qeveritar i tejkalon shpenzimet e investimeve të qeverisë* dhe merr parasysh të gjithë faktorët e tjerë të rëndësishëm, *përfshirë pozicionin afatmesëm ekonomik dhe buxhetor* të shtetit anëtar.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Gjithashtu, nga komisioni mund të përgatitet një raport nëse, *pavarësisht përmbushjes së kërkesave sipas kritereve, është i mendimit se ekziston rreziku i një defiçiti të tepruar në një shtet anëtar*. Bazuar në propozimin mbi raportin e Komisionit, Këshilli i BE-së, merr parasysh edhe çdo vërejtje që shteti anëtar i interesuar mund të dëshirojë të bëjë, dhe në përfundim vendos nëse ekziston një defiçit i tepërt bazuar dhe në zbatim të pikës 6 të Nenit 126-të Traktatit.

Nëse Këshilli ka vendosur në përputhje me pikën 6 si më sipër duke pozuar se ekziston një defiçit i tepruar, ai do të miratojë, pa vonesë të panevojshme, një rekomandim drejtuar Shtetit Anëtar të interesuar me qëllim që të sjellë treguesin e defiçitit brenda parametrave brenda një periudhe të caktuar. Këshilli mund t'i bëjë rekomandimet e tij publike kur gjykon se shteti anëtar nuk ka pasur ndonjë veprim efektiv në përgjigje të rekomandimeve të tij brenda periudhës së caktuar. Por, nëse shteti anëtar vazhdon të mos zbatojë rekomandimet e Këshillit, atëherë Këshilli mund të vendosë t'i njoftojë shtetit anëtar që të marrë, brenda një afati të caktuar kohor, masa për uljen e defiçitit, i cili gjykohet i nevojshëm nga Këshilli për të korrigjuar situatën dhe mund t'i kërkojë atij shteti të paraqesë raporte në përputhje me një orar specifik, në mënyrë *që të ekzaminojë përpjekjet e rregullimit për financa të shëndosha publike* të këtij shteti.

Çfarë mund të bëjë Këshilli nëse shteti përkatës nuk zbaton një vendim të marrë prej tij lidhur me rregullimin për shëndoshjen e financave publike të këtij shteti?




Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Këshilli mund të vendosë të zbatojë ose, sipas rastit, të intensifikojë *një ose më shumë nga masat në vijim*: - të kërkojë nga ky shtet të botojë informacione shtesë, të specifikuara nga Këshilli, përpara se të lëshojë bono dhe letra me vlerë; - të ftojë Bankën Europiane të Investimeve të rishqyrtojë politikën e saj të huadhënies ndaj këtij shteti; - të kërkojë nga ky shtet të bëjë një depozitë pa interes të një madhësie të përshtatshme në Bashkimin Europian derisa mangësitë e konstatuara të korrigjohen, sipas mendimit të Këshillit; - të vendosë gjoba të një madhësie të përshtatshme.

Gjithashtu, Presidenti i Këshillit duhet të informojë Parlamentin Europian për vendimet e marra.

Referuar Nenit 126-të (ex-article 104 TEC) të Traktatit, gërma a) dhe b) e tij, *bazuar në përpunimin e autorit të të dhënave të marra nga INSTAT për periudhën e marrë në analizë nga viti 2008-2018*²⁵ do të kemi paraqitjen grafike si në vijim.

Grafiku 7. Borxhi publik dhe deficieti buxhetor në raport me PBB (2008 -2018)



Burimi: Të dhëna të marra nga INSTAT. Përpunimi dhe ndërtimi i grafikut: Autori i Punimit

²⁵ Të dhënat për vitin 2018 janë të dhëna paraprake sipas raportimit që gjendet në database të INSTAT, pavarësisht se të dhënat nga autori i punimit janë përpunuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 dhe testuar përfundimisht në fillim të Marsit 2020. Edhe në Mars 2020, statusi i të dhënave për vitin 2018 vijon të figurojë si të dhëna paraprake dhe të dhënat për vitin 2019 ende nuk janë të publikuara në database të INSTAT.



Bazuar në përpunimin e këtyre të dhënave dhe analizën e tyre të trajtuar më gjerësisht në çështjet në vijim do të kuptojmë se vetëm pasi të jenë plotësuar treguesit e kriterit të Politikës Fiskale do të thotë që Shqipëria ka arritur një pozicion buxhetor të qeverisë me **financa të shëndosha publike**.

Pra, sipas nenit 2 të Protokollit për kriteret e konvergencës thuhet se neni 140 (1) i Traktatit përcakton se ky kriter do të thotë që "në kohën e provimit, Shteti Anëtar nuk është subjekt i një vendimi të Këshillit sipas nenit 126 të Traktatit". Pra do të thotë se kriteri është i plotësuar dhe shteti nuk ka një vendim kufizues nga Këshilli i BE-së për të plotësuar lidhur me qënien e tij si anëtar i BE-së.

4.3. Treguesi i Deficitit Buxhetor për Shqipërinë (2008-2018)

Referuar Nenin 126-të (ex-article 104 TEC) të Traktatit, gërma a) e tij, kërkohet që raporti i deficitit qeveritar të planifikuar ose aktual ndaj produktit të brendshëm bruto nuk e tejkalon një vlerë reference, e cila për Shqipërinë është e specifikuar deri në -3%. Ky tregues mund të tejkalohe vetëm në rastet kur: - ose raporti ka rënë ndjeshëm dhe vazhdimisht dhe ka arritur një nivel që i afrohet vlerës së referencës; - ose, përndryshe, teprica mbi vlerën e referencës është vetëm e jashtëzakonshme dhe e përkohshme dhe raporti mbetet afër vlerës së referencës.

Bazuar në përpunimin e autorit të të dhënave të marra nga INSTAT për periudhën e marrë në analizë nga viti 2018-2018²⁶ mund të vijojmë analizën më të detajuar përmes paraqitjes së të dhënave tabelore dhe grafikut në vijim.

²⁶ Të dhënat për vitin 2018 janë të dhëna paraprake sipas raportimit që gjendet në database të INSTAT, pavarësisht se të dhënat nga autori i punimit janë përpunuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 dhe testuar përfundimisht në fillim të Marsit 2020. Edhe në Mars 2020, statusi i të dhënave për vitin 2018 vijon të figurojë si të dhëna paraprake dhe të dhënat për vitin 2019 ende nuk janë të publikuara në database të INSTAT.

Grafiku 8. Defiçiti buxhetor në raport me PBB (2008-2018)



Burimi: Të dhëna të marra nga INSTAT. Përpunimi dhe ndërtimi i grafikut: Autori i Punimit

Sa i përket të dhënave fiskale nga 2001, një rënie e vazhdueshme e defiçitit të buxhetit të qeverisë mund të vërehet deri në vitin 2006. Politika fiskale ekspansioniste gjatë vitit 2008 ishte reflektuar në shpenzime më të larta publike dhe rrjedhimisht një defiçit më të lartë buxhetor, duke arritur në -5.5% të PBB-së. Zgjerimi i defiçitit buxhetor gjatë vitit 2008-2009 ishte kryesisht për shkak të investimeve më të larta publike, veçanërisht atyre që shkojnë drejt autostradës Durrës-Kukës. Kur marrim parasysh vlerën e referencës së BE-së për defiçitin buxhetor prej 3.0%, në pamje të parë mund të konkludohet se Shqipëria nuk e përmbush këtë kriter. Gjatë vitit 2012, të dhënat paraprake tregojnë se defiçiti buxhetor arriti në 3.3% të PBB-së, 0.3% më të lartë se vlera e referencës së BE-së.

Që nga viti 2016, është regjistruar një bilanc parësor pozitiv (sufiçiti primar), krahasuar me një defiçit primar prej 2.3% në vitin 2014.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Të ardhurat nga taksat janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit nga 22.2% e PBB-së në 2013 në rreth 26% të PBB-së në 2018, të nxitur nga masat e politikës tatimore dhe administrimi i përmirësuar i taksave.

Reforma kundër informalitetit gjithashtu ndihmoi në rritjen e mbledhjes së të ardhurave që mbetet një veprim përparësor në vazhdim. Nga ana e shpenzimeve, janë realizuar kursime të konsiderueshme nga reformat në sektorin e pensioneve dhe energjisë, si dhe nga fitimet e efikasitetit në administratën publike.

Nërkohë që qeverisja e Shqipërisë për 2016, 2017, dhe 2018 ka performuar në mënyrë shumë mbresëlënëse lidhur me pothuajse zbritjen në 50% të këtij treguesi. Ky tregues për Shqipërinë qëndron brenda limitit të lejuar prej jo më shumë se 3%. Pra, treguesi i defiçitit buxhetor të Shqipërisë për vitin 2018 vlerësohet se është arritur stabilizimi i tij duke ardhë në ulje dhe duke qëndruar brenda kufirit të kërkuar prej 3%.

Sipas vlerësimit të Bashkimit Europian për Shqipërinë konstatohet se udhëzimi i politikave i miratuar bashkërisht në dialogun ekonomik dhe financiar të vitit 2017 është zbatuar pjesërisht duke vlerësuar se *Konsolidimi fiskal ka përparuar me defiçitin buxhetor ndaj PBB-së duke u ngushtuar pavarësisht se më pak sesa ishte planifikuar për vitin 2018*. Kuadri fiskal është përmirësuar me miratimin e një rregulli fiskal, edhe pse nuk siguron një spirancë të fortë.

Deri në vitin 2015 defiçiti fiskal ishte mbi 4% të PBB-së, megjithëse rritja ekonomike vijonte të ishte në rritje. Ndërsa në vitin 2017, defiçiti fiskal mbeti afër 2% të PBB-së, dhe rritja ekonomike vijonte të forcohej më tej. Të ardhurat totale u rritën me 5.7% nga viti në vit, i nxitur nga të ardhurat më të larta të taksave dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Raporti i të ardhurave ndaj PBB-së u rrit nga 27.6% në 2016 në 27.7% në 2017. Në krahasim me buxhetin e rishikuar në Dhjetor 2017, të ardhurat totale ishin 2.8% nën objektivin.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)


Shpenzimet totale u rritën me 6.4% nga viti në vit, në veçanti, në rritjen e konsumit publik, pagesa të transferimeve sociale dhe shpenzimeve kapitale. Raporti i shpenzimeve ndaj PBB-së u rrit nga 29.4% në 2016 në 29.7% në 2017.

Krahasuar me buxhetin e rishikuar, shpenzimet totale ishin 2.7% nën objektiv. Nënvlërësimi i shpenzimeve ishte pjesërisht rezultat i një nënvlërësimi të shpenzimeve kapitale pas një mbikalimi të konsiderueshëm të një viti më parë.

Investimi publik është thelbësor për adresimin e mangësive të mëdha në infrastrukturë; një dështim i përsëritur për t'iu përmbajtur objektivave të shpenzimeve tregon dobësi të vazhdueshme në menaxhimin e investimeve publike. Në përgjithësi, defiçiti i buxhetit total u rrit nga 1.8% e PBB-së në 2016 në 2.0% në 2017 por zbriti akoma më shumë deri në 1.6 në 2018. Rregulli në Ligjin e Buxhetit Organik që ndalon shpenzimet e parave publike në vitet e zgjedhjeve u respektua nga qeveria duke e ruajtur edhe parashikimin për stabilizimin e buxhetit në afat të shkurtër i cili synonte që defiçiti i përgjithshëm fiskal të mbetej deri në 2.0% të PBB-së në vitin 2018.

Tendenca e ecurisë së defiçiti buxhetor në raport me PBB (2019-2024). Në vijim do të paraqisim edhe tendencat e ecurisë së këtij raporti për 5 vitet e ardhshme nëse të dhënat janë të sakta për të paraqitur një trend ecurie.

Grafiku 9. Tendenca e ecurisë së deficitit buxhetor në raport me PBB (2019-2024)



Burimi: Të dhëna të marra nga INSTAT. Përpunimi dhe ndërtimi i grafikut: Autori i Punimit

Bazuar në planifikimin dhe synimin e qeverisë lidhur me ecurinë e deficitit buxhetor mund të shprehim se konsolidimi fiskal planifikohet të vijojë akoma më shumë uljen e deficitit buxhetor prej 1.5% në 2019 dhe 1.2% në vitin 2020 duke synuar të jetë afërsisht tek skenari normal i mundshëm sipas grafikut të punuar nga unë më sipër. Për vitin 2019 bilanci fiskal i synuar është bërë 0.8 pps më pak ambicioz në lidhje me bilancin e përgjithshëm dhe parësor, megjithë një parashikim pak më pozitiv për rritjen e PBB-së. Ngushtimi i parashikuar i deficitit fiskal pritet të arrihet përmes një kombinimi të të ardhurave në rritje (me 0.4 pps ndërmjet 2019 dhe 2020) dhe një zvogëlim të shpenzimeve (me 0.3 pps për të njëjtën periudhë) në raport me PBB. Rritja e raportit të të ardhurave është rezultat i një rritje graduale të të ardhurave tatimore që kompensohen pjesërisht nga kontributet më të ulëta të sigurimeve shoqërore. Rënia e raportit të shpenzimeve është planifikuar të arrihet kryesisht duke mbajtur normën mesatare të rritjes vjetore të konsumit publik (3.2%) në gjysmën e normës së rritjes së PBB-së nominale (6.4%) në 2018-2020. Kjo do të kërkojë një disiplinë të konsiderueshme të shpenzimeve.



Nisur nga dokumenti i qeverisë për dialogun me BE-në, planifikimi i prezantuar për konsolidimi fiskal synon më shumë uljen e defiçitit buxhetor deri në 1.2% për vitin 2020. Në vlerësimin të këtij synimi nëse të dhënat e raportuara nga INSTAT janë korrekte dhe simetrike, mund ta konsiderojë këtë si një objektiv të pakuptimtë deri diku pasi qeveria e Shqipërisë këtë tregues e ka shumë nën limitin e kërkuar nga BE. Ndërkohë që disa prej vendeve anëtare kanë vështirësi në uljen e këtij treguesi në nivelin e 1.6% që e ka Shqipëria në 2018 dhe synimin për 1.2% për vitin 2020.

Duke parë ecurinë e këtij planifikimi shikohet ecuria pothuajse e njëjtë me skenarin sipas grafikut më sipër. Nëse Shqipëria do të vijojë me këtë tendencë atëherë veçse në 2024 sipas grafikut të mësipërm defiçiti buxhetor i Shqipërisë mund të arrijë standarde të pamenduara më parë të tilla si krijimi i sufiçitit buxhetor në masën e 0.4%.


4.4. Treguesi i Borxhit Publik ndaj PBB për Shqipërinë (2008-2018)

Referuar Nenit 126-të (ex-article 104 TEC) të Traktatit, gërma b) e tij, kërkohet që raporti i borxhit të qeverisë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto të mos tejkalojë një vlerë reference, e cila *për Shqipërinë është e specifikuar deri në 60%*. Ky tregues mund të tejkalohet vetëm në rastet kur: raporti po zvogëlohet në mënyrë të duhur dhe i afrohet vlerës së referencës me një ritëm të kënaqshëm.

Bazuar në përpunimin e autorit të të dhënave të marra nga INSTAT për periudhën e marrë në analizë nga viti 2018-2018²⁷ mund të vijojmë analizën më të detajuar përmes paraqitjes së të dhënave tabelore dhe grafikut në vijim.

²⁷ Të dhënat për vitin 2018 janë të dhëna paraprake sipas raportimit që gjendet në database të INSTAT, pavarësisht se të dhënat nga autori i punimit janë përpunuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 dhe testuar përfundimisht në fillim të Marsit 2020. Edhe në Mars 2020, statusi i të dhënave për vitin 2018 vijon të figurojë si të dhëna paraprake dhe të dhënat për vitin 2019 ende nuk janë të publikuara në database të INSTAT.

Grafiku 10. Borxhi Publik në raport me PBB (2008-2018)



Burimi: Të dhëna të marra nga INSTAT. Përpunimi dhe ndërtimi i grafikut: Autori i Punimit

Për të zvogëluar dobësitë e borxhit publik, ne kemi ndërmarrë një rregullim të konsiderueshëm fiskal gjatë viteve të fundit. Bilanci i përgjithshëm fiskal është përmirësuar me rreth 3.2 p.p. të PBB-së nga viti 2014 deri në 2018, i mbështetur nga mobilizimi i të ardhurave, kufizimi i shpenzimeve dhe zbatimi i disa reformave administrative. Gjithashtu, përsa i përket menaxhimit të borxhit gjatë këtyre viteve rreziqet e ndryshimit të kushteve janë zvogëluar duke diversifikuar dhe zgjeruar ndjeshëm pjekurinë e borxhit publik. Politika fiskale konsoliduese synon të mbajë trajektoren rënëse të borxhit publik, si një raport ndaj PBB-së, që filloi që nga viti 2016.

Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së është zvogëluar, por mbetet një burim kryesor i dobësisë së treguesve makroekonomikë të Shqipërisë. Borxhi publik (përfshirë garancitë) për vitin 2018 është ende afër nivelit relativisht të lartë prej 70% të PBB dhe shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme të kthimit, normës së interesit dhe kursit të këmbimit.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Planet dhe programet e qeverisë për zvogëlim të borxhit publik dhe sjelljen e tij brenda parametrave si edhe rregullimin fiskal janë shtyrë mbrapa në krahasim me programin e vitit të kaluar.

Kjo ecure e dobët do të vonojë arritjen e objektivave afatmesme dhe afatgjatë për borxhin publik. Gjithashtu, parashikimi për rënien e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbështetet kryesisht në rritje të favorshme ekonomike dhe kufizim të shpenzimeve publike. Ndërkohë që ky tregues për vitin 2019 dhe në vijim po shoqërohet me rreziqe domethënëse për rënie të masës së rritjes së PBB-së më shumë sesa ishte parashikuar, ndikuar negativisht edhe nga detyrimet e mundshme për partneritetet e reja publike-private.

Shqipëria ka hapësirë të konsiderueshme për ngritje më të madhe të ardhurave duke përmirësuar përputhjen e taksave dhe zgjeruar bazën e taksave.

Në përgjithësi, korniza makro-fiskale e programit është e pranueshme, ndërsa *angazhimi i rikonfirmuar për uljen e dobësive të lidhura me borxhin publik (i cili qëndron mbi nivelin e lejuar) është në përputhje me prioritetet e identifikuara nga Komisioni i Bashkimit Europian në vitet e kaluara.*

Garancitë publike paraqesin një burim të tillë të rrezikut, edhe nëse ato llogariten plotësisht në **borxhin publik** dhe u raportua të arrinin në 3.2% të PBB-së në fund të vitit 2017, nga 3.6% një vit më parë. Rreth 83% të borxhit të përgjithshëm të garantuar është lëshuar në favor të sektorit të energjisë në pronësi të shtetit ku reformat janë akoma jo të plota. Një qëndrim tjetër i gjatë rreziku për pamjen e buxhetit është detyrimi, i konfirmuar me aktvendime të gjykatës ndërkombëtare, për të siguruar kompensim për ish pronarët e pasurive të shpronësuara në epokën komuniste. Linjat e buxhetit të dedikuara për pagesa të tilla kompensimi mund të jenë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha pretendimet eventuale.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Më e rëndësishmja, planet për të rritur përdorimin e partneriteteve publike-private dhe kontratat e konçesionit sjellin rreziqe të konsiderueshme fiskale në format e detyrimeve të mundshme për buxhetin e shtetit. Më në fund, ekzistojnë rreziqe të vazhdueshme që vijnë nga menaxhimi financiar nga qeveritë lokale; shpenzimet e tyre përfaqësuan 3.0% të PBB-së në vitin 2017.

Raporti i borxhit publik vazhdoi të bjerë, por ai është akoma i lartë dhe sjell rreziqe të konsiderueshme. Në fund të vitit 2017, borxhi publik i Shqipërisë (përfshirë garancitë publike) ishte 69.9% e PBB-së. Kjo ishte 2.5 pps nën raportin e borxhit në fund të vitit 2016 dhe shënoi të dytin vit radhazi me një raport të borxhit në rënie. Sidoqoftë ishte edhe 1 pikë më e lartë se sa ishte parashikuar në ERP të vitit të kaluar. Pothuajse i gjithë borxhi publik i detyrohet nga pushteti qendror. Në një mjedis me norma interesi interesi, borxhi krijoi pagesa interesi me vlerë 2.1% e PBB-së në 2017, nga 2.7% në 2015.

Autoritetet kanë qenë në gjendje të zgjasin mesataren pjekuria e stokut të borxhit publik në mënyrë të konsiderueshme dhe ulja e pjesës së instrumenteve të normës së ndryshueshme. Kjo zhvendosja e përbërjes së borxhit do të thotë që rreziqet e kthimit dhe normës së interesit janë ulur. Pothuajse gjysma e borxhit është në monedhë të huaj, kryesisht euro. Pak më shumë se gjysma e borxhit publik është mbajtur brenda vendit, kryesisht nga sektori bankar, dhe shumë prej tyre janë akoma afatshkurtra dhe duhet të rrefinancohen shpesh.

Shqipëria është e ndjeshme ndaj ndryshimeve në ndjenjën e tregut dhe rregullatorit të vendit pritisë kërkesa që mund të ndikojnë në gatishmërinë e mbajtësve të borxhit për të mbajtur letrat me vlerë shqiptare. Për Shqipërinë, niveli i borxhit publik në vitin 1996 ju afrua normës prej 60 përqind të PBB-së, dhe në vitin 1997 ai ishte mbi 70 përqind të PBB-së.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Ndjekja e një politike fiskale, me rritjen e TVSH nga 12.5 përqind në 20 përqind dhe kontrolli mbi shpenzimet publike bën të mundur që niveli i borxhit publik në fund të vitit 2004 të zbriste në rreth 55 përqind e PBB-së. Me këtë nivel borxhi publik ndaj PBB-së u vazhdua pothuajse deri në vitin 2008.

Vëzhgimi i borxhit publik ndaj pragut të PBB-së (nën 60% të PBB-së) dhe mbajtja e deficiteve të ulëta të buxhetit, ishin dy objektivat më të rëndësishëm të përcaktuara në Kornizën Fiskale dhe Makroekonomike për 2010-2012. Kjo kryesisht për shkak të përkeqësimit të pozicionit fiskal në vitin 2009. Në ndryshim nga dy vitet e mëparshme të stimullit fiskal, politika fiskale gjatë vitit 2010 ishte e orientuar drejt konsolidimit fiskal përmes shpenzimeve më të ulta dhe të ardhurave më të larta, duke çuar në një ulje thuajse 53% të defiçitit të buxhetit të qeverisë për vitin 2010. Me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë së financave publike, edhe gjatë vitit 2011 ishte e nevojshme të ndiqte një politikë të kujdesshme fiskale. Pra, për vitin 2011 politika e përgjithshme fiskale mund të konsiderohet paksa stimuluese.

Nëse marrim parasysh të dhënat për borxhin publik në Shqipëri, një ulje progresive mund të vërehet nga viti 2002. Borxhi i përgjithshëm publik regjistroi nivelin e tij më të ulët në vitin 2007, duke zënë rreth 53.4% për sa i përket PBB-së nominale.

Në vitin 2008, kryesisht për shkak të nevojave për financim të shpenzimeve kapitale, stoku i borxhit publik u rrit, duke arritur në 54.7% të PBB-së në 2008 dhe 59.4% të PBB-së në 2009. Duke pasur parasysh krizat financiare të vitit 2008 dhe krizën e borxhit në Greqi, dhe si pjesë e Kombëtares u miratua Strategjia për Zhvillim dhe Integrim, një administrim më i kujdesshëm dhe më i mirë i strategjisë së borxhit publik.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Kjo strategji përbëhet nga dy elementë kryesorë: shtrirja e maturimit të borxhit të brendshëm dhe, nga pikëpamja teknike, përmirësimi i infrastrukturës së tregut të letrave me vlerë²⁸ (Banka e Shqipërisë, 2008).

Për një krahasueshmëri më të mirë, llogaritet gjithashtu borxhi i qeverisë shqiptare pa lëshime garancie, megjithëse ndryshimet metodologjike vazhdojnë.

Të dhënat tregojnë se për disa vjet, borxhi i qeverisë shqiptare qëndroi nën pragun e UE-së prej 60% të PBB-së, duke përmbushur këtë kriter fiskal edhe pse nga një diferencë e vogël. Larg vlerësimeve të pikës, të cilat aktualisht nuk janë koherente pasi ekzistojnë dallime metodologjike, është e rëndësishme të vihet re që borxhi publik në Shqipëri ka qenë relativisht afër pragut 60%.

Pas vitit 2008 borxhi publik ndaj PBB-së ka njohur vetëm rritje duke arritur në kulmin e tij në vitin 2016 ku ishte në nivelin e 72.7% të PBB-së. Ky nivel përbën pikën më të lartë të borxhit publik ndaj PBB- së të raportuar sipas INSTAT.

Pas vitit 2016 ky raport ka ardhur duke u përmirësuar dhe ashtu siç gjendet i publikuar për vitin 2018 është në nivelin e 67.2%, *që do të thotë se treguesi i borxhit publik ndaj PBB vazhdon të jetë ende mbi kufirin e lejuar prej 60%.*

Për aq sa vet treguesit flasin, Shqipëria ka pasur një kujdes të mirë për ruajtjen e treguesit të borxhit publik ndaj PBB deri në vitin 2010 dhe 2011 por duke e pasur brenda kufirit të lejuar prej 60%. Duke nisur që nga viti 2012 kemi thyerje të treguesit dhe si pasojë Shqipëria është në mos plotësim të treguesit. Lidhur me financimin e borxhit publik të Shqipërisë nga burimet e brendshme të kapitalit, gjatë viteve të fundit dhe tendenca për vitet në vazhdim do të vijë gjithnjë e në ulje.

²⁸ Raporti vjetor, Banka e Shqipërisë, 2008




Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Lidhur me katastrofën natyrore të tërmetit të Nëntor 2019 dhe Pandeminë e Mars 2020, mund të vlerësojmë se borxhi publik ndaj PBB-së parashikohet të vazhdojë të jetë mbi pragun e lejuar nga BE edhe për disa nga vitet e ardhshme.

Në vijim do të paraqisim edhe tendencat e ecurisë së këtij raporti për 5 vitet e ardhshme nëse të dhënat janë të sakta për të paraqitur një trend ecurie.

Grafiku 11. Tendenca e ecurisë së Borxhit Publik në raport me PBB (2019-2024)



Politika fiskale në planin afatmesëm 2019-2021 duhet të orientohet qartë drejt konsolidimit fiskal, në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin e Buxhetit Organik (borxhi publik të jetë më pak se 60% e PBB-së brenda vitit 2021, arrin më vonë se 45 %). Konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit publik janë thelbësore për të ulur dobësitë e lidhura me borxhin që pengojnë rritjen dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Borxhi publik pritet të bjerë në rreth 65.5% të PBB-së në vitin 2019; 63.6% e PBB-së në vitin 2020 dhe 59.9% në 2021, që përfshin një ulje optimale, por ende thelbësore nga kulmi i 72.7% në vitin 2015. Objektiv i tregues afatmesëm për borxhin publik mbetet ulja e tij nën 60% në 2021.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Për sa i përket borxhit publik, ulja do të jetë nga 66.6% e pritshme në fund të 2018 në 59.5% në 2021, e cila përfshin një ulje kumulative prej rreth 7 pp në tre vjet. Për periudhën e programit, ERP projektton konsolidimin fiskal të ngarkuar mbrapa me një raport gradualisht në rënie të borxhit ndaj PBB-së. Shtigjet e parashikuara për defiçitin fiskal dhe për rritjen nominale të PBB-së do të lejonin që raporti i borxhit ndaj PBB-së (përfshirë garancitë shtetërore) të bjerë gradualisht me 6.4 pps në 63.5% gjatë 3 viteve deri në fund të vitit 2020. Në përgjithësi, planifikimi i qeverisë qëndrimi fiskal është mjaft i rreptë për të ulur më tej raportin e borxhit, siç kërkohet nga rregulli fiskal.

Përveç rreziqeve të natyrshme në zbatimin e disiplinës fiskale në kushte të pasigurisë, pozicioni i buxhetit në Shqipëri mund të ndikohet nga detyrimet financiare për të cilat qeveria përfundimisht mund të mbahet përgjegjëse.

Borxhi i mëtejshëm. Prandaj, ulja është thelbësore për të lehtësuar dobësitë e lidhura me borxhin dhe rindërtimin e hapësirës për politika manovrim. Kuadri aktual buxhetor synon të arrijë qëndrueshmërinë e borxhit në planin afatgjatë, por i mungon një spirancë e besueshme dhe operative. **Rregulli aktual fiskal detyron një tavan borxhi prej 45% të PBB-së dhe bilancet vjetore të buxhetit që sigurojnë një raport të borxhit në rënie derisa të arrihet objektivi.** Rregulli është relativisht i butë pasi nuk përcakton një afat kohor për arritjen e objektivit ose kërkon një organ të pavarur për të monitoruar pajtueshmëritë. Në këtë fazë autoritetet nuk planifikojnë të ndryshojnë kornizën buxhetore të miratuar së fundmi. Sidoqoftë, qeveria e tanishme është zotuar të ulë raportin e borxhit në më pak se 60% deri në vitin 2021. Projektioni i ERP-së për rrugën në rënie të borxhit publik është në përputhje me këtë objektiv afatmesëm, por për shkak të rreziqeve anësore të rritjes dhe ekzekutimit të buxhetit mund të kërkohen masa shtesë fiskale.



4.5 Borxhi publik sfidë për Shqipërinë, institucionet përgjegjëse

4.5.1 Konteksti i sfidës

Niveli i borxhit publik ka qenë dhe është një çështje e debatueshme, aq më tepër këtë dekadë me krizën financiare që përjetuan disa vende të Europës. Borxhi publik u bë problematik dhe një barrë jo vetëm për ekonominë e vendeve më pak të zhvilluara por edhe të vendeve në zhvillim. Kjo kërkoi menjëherë marrjen e masave për një menaxhim më të mirë dhe të kujdesshëm për ruajtjen e kufijve të pranueshëm të borxhit kundrejt PBB-së. Për të minimizuar efektet negative të nivelit të lartë të borxhit për më tepër në kushtet e një rritje ekonomike me ritme të ulta, mbajtja nën kontroll e borxhit u cilësua si objektiv i rëndësishëm, edhe nga organizmat ndërkombëtare.

Që prej vitit 2012, u vërejtën tendenca të rritjes së stokut të borxhit kundrejt PBB-së, mbi masën 60% të saj, si një tregues i tij, i vendosur për vendet të cilat aderojnë për t'u bërë pjesë e BE-së. Borxhet publike shfaqen pasi qeveritë kryejnë më shumë shpenzime se niveli i të ardhurave të tyre korrente. Gjatë periudhës që është marrë në shqyrtim është operuar me nivele shpenzimesh më të larta se niveli i të ardhurave, gjë e cila kërkon financimin e këtij defiçiti nëpërmjet huamarrjes së brendshme dhe të huaj.

Në kushtet e një ekonomie me ritme të ulta rritjeje, si dhe nevojës së qeverive për financim të programeve të tyre ekonomike, niveli i borxhit publik u rrit dhe konkretisht për periudhën objekt studimi treguesi i stokut të borxhit arriti në 73.97% për vitin 2016. Një nivel i lartë i borxhit publik, në kushtet e një ekonomie që performon dobët, ka një ndikim të drejtpërdrejtë social, që do të thotë më shumë kosto shërbimi, rritje të peshës specifike kundrejt të ardhurave të cilat në rastin më të mirë do të angazhoheshin për investime publike, shërbime sociale etj.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Politikat makroekonomike, fiskale por edhe ato monetare të ndërmarra nga Banka Qendrore kanë ndikimin tyre në menaxhimin borxhit publik dhe si të tilla janë në qendër të vëmendjes së analizave, prognozave, kritikave dhe komenteve, mbi sfidat që paraqet menaxhimi i borxhit publik. Përfshirja e shumë specialistëve në trajtimin e kësaj tematike, ka të bëjë pikërisht me rëndësinë që ka menaxhimi i borxhit publik, me qëllim minimizimin e efekteve negative sot dhe në të ardhmen.

Në një kontekst më të gjerë makroekonomik, qeveritë synojnë të sigurojnë nivel dhe norma rritjeje të borxhit publik të qëndrueshme duke mbajtur nën kontroll koston e borxhit dhe objektivat e riskut. Rëndësia e studimit të performancës së borxhit publik nisët nga arsyet e mëposhtme :


1. Është objektiv i përgjithshëm i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik, reduktimi i kostove për njësi të shërbimit të borxhit publik duke ruajtur raporte të pranueshme të riskut.
2. Janë vendosur targete të mirëpërcaktuara nga SAMB për reduktimin e instrumenteve afatshkurtër në portofolin e borxhit publik, si dhe për reduktimin e instrumenteve me norma interesi variabël në portofolin e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm.
3. Rëndësia e një keqmanaxhimi të borxhit publik dhe efektet e tij negative në ekonominë e një vendi me ndikim në mirëqenien e individit sot dhe në të ardhmen.

Në këtë studim trajtohet huamarrja, si një nga mënyrat për të plotësuar nevojat e qeverisë në realizimin e programeve ekonomike, shërbimin e borxhit si një instrument për të menaxhuar koston që shoqëron huamarrjen dhe eficiencën e përdorimit të borxhit publik në qëllim të rritjes së performancës ekonomike.

4.5.2. Institucionet përgjegjëse për Menaxhimin e Borxhit Publik

Për të vlerësuar performancën e Menaxhimit të Borxhit Publik (PMBP), janë analizuar disa struktura brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat kanë role të ndryshme dhe janë me ndikim në menaxhimin e borxhit publik, si dhe Banka e Shqipërisë si agjente e qeverisë në realizimin e procedurave të huamarrjes së brendshme dhe si institucioni që merret me politikën monetare, të cilat kanë ndikimin e tyre në borxhin publik.

Figura 3. Skema e institucioneve përgjegjëse për Performancën e Menaxhimit të Borxhit Publik



Më poshtë do të analizojmë misionin dhe objektivat e secilit institucion përgjegjës për PMBP.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Misioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është arritja e stabilitetit ekonomik mëpërmjet drejtimit me efikasitet, efektivitet dhe transparencë të financave publike, si një detyrim Kushtetues.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ushtron veprimtarinë nëpërmjet këtyre fushave të përgjegjësisë shtetërore:



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Politikës makroekonomike dhe fiskale;
- Administrimit të të ardhurave;
- Administrimit të buxhetit të shtetit;
- Menaxhimit të borxhit publik;
- Administrimit financiar;
- Menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Menaxhimit të asistencës financiare të Bashkimit Europian dhe menaxhimit të fondeve të Bashkimit Europian;
- Inspektimit financiar publik;
- Bashkërendimit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm.


Veprimtarinë e saj Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ushtron nëpërmjet drejtorive të mëposhtme të cilat direkt dhe indirekt janë të përfshira në realizimin e një prej përgjegjësive shtetërore të saj, që është –Menaxhimi i Borxhit Publikl.

Më poshtë po paraqesim organigramën, misionin dhe funksionet kryesore të Drejtorive të Përgjithshme të Borxhit, Thesarit, Buxhetit dhe Makroekonomisë dhe Politikave Fiskale.

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit

Misioni i kësaj drejtorie është realizimi i huamarrjes publike në tregun e brendshëm dhe në tregun ndërkombëtar, nëpërmjet instrumenteve financiare dhe marrëveshjeve të huasë, për të financuar defiçitin buxhetor të shtetit, mungesën e përkohshme të likuiditetit, rfinansimin e borxhit shtetëror, për të paguar garancitë shtetërore, koston e emetimit të borxhit shtetëror, etj si dhe menaxhimi i borxhit publik me objektivin e minimizimit të riskut dhe të koston totale efektive të financimit, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të instrumenteve të financimit.

Figura 4. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit



Funksionet kryesore të saj janë:

- Realizimi i huamarrjes në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, nëpërmjet instrumenteve financiarë, në përputhje me buxhetin vjetor;
- Realizimi i huamarrjes nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për financimin e projekteve dhe për nevoja të tjera të buxhetit në përputhje me buxhetin vjetor;
- Sigurimi i financimeve me fonde grant nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse të grantit;
- Ndjekja procedurave ligjore deri në bërjen efektive të marrëveshjeve të huave dhe granteve;
- Bashkëpunimi me kreditorët/donatorët për ndryshimin e marrëveshjeve përkatëse të financimit dhe ndjek procedurat përkatëse ligjore deri në bërjen efektive të tyre;
- Mbështet zhvillimin e tregut të borxhit të brendshëm;
- Monitoron zhvillimet në tregun ndërkombëtar të kapitaleve dhe kujdeset për të realizuar huamarrjen në kohë në këto tregje, në respekt të kufizimeve buxhetore;



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Koordinon aktivitetet e menaxhimit të borxhit me politikat monetare dhe ato fiskale;
- Përgatit strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit, në përputhje me qëllimin për të arritur objektivat e synuara dhe përditëson strategjinë çdo vit;
- Punon për të minimizuar riskun operacional të borxhit;
- Vlerëson riskun e kreditit dhe emetimin e garancive të huasë si dhe menaxhon ato, duke respektuar parametrat e përcaktuara në legjislacionin për huamarrjen vendore
- Miraton dhe monitoron zbatimin e nënshkrimeve;
- Mban database e borxhit publik si dhe mban rekorde të garancive dhe huamarrjes aktive;
- Mban rekorde të kontratave të huave;
- Kryerjen në kohë të shërbimit të borxhit;
- Përgatit dhe siguron publikimin e rregullt të buletineve të statistikave të borxhit;
- I përgjigjet detyrimeve raportuese me natyrë statutores dhe kontraktuale të borxhit të qeverisë ndaj institucioneve të huaja dhe të brendshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Makroekonomisë dhe Politikave Fiskale

Misioni i saj është të paraprijë zhvillimin e ekonomisë nëpërmjet sugjerimit të politikave makroekonomike dhe fiskale dhe testimit të tyre nëpërmjet analizave të thella, të plota dhe me variante.

Figura 5. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Makroekonomisë dhe Politikave Fiskale



Funksionet kryesore të saj janë:

- Zhvillimi dhe zbatimi i një modeli tërësor makroekonomik dhe fiskal, i cili mbështetet në lidhjet që ekzistojnë ndërmjet sektorëve kryesore të ekonomisë (real, fiskal, monetar dhe të jashtëm). Ky model lejon simulimin e situatave të ndryshme praktike duke mbajtur parasysh objektivat për rritjen ekonomike, inflacionin, rezervat valutore dhe mbi këtë bazë, vendosjen e një objektivi për defiçitin buxhetor që është konsistent me këto objektiva;
- Ndjekja e zhvillimit ekonomik të vendit duke parashikuar treguesit agregatë makroekonomikë, të kryejë analiza dhe të japë rekomandime për ruajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë ekonomike;
- Përgatitja e analizave të performancës ekonomike, në veçanti e vlerësimit të PBB-së dhe e performancës sektoriale, duke përfshirë sektorët ku janë identifikuar problemet;
- Ekzaminimi i realizimit të të ardhurave krahasuar me parashikimin dhe ekzaminimi i implikimeve të ndonjë mungese apo teprice;
- Asistencë në analizat e programeve qeveritare, sipas sektorëve;
- Bashkërendimi i punës me Administratën Fiskale, në mbledhjen e të dhënave për treguesit e të ardhurave;




Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Përgatitjen e politikave fiskale dhe ndjekjen e efekteve të tyre në buxhetin e shtetit, nëpërmjet analizave periodike të treguesve fiskalë;
- Hartimin e politikave fiskale duke respektuar marrëveshjen e qeverisë shqiptare me FMN dhe detyrimeve të tjera mbi bazat e programit ekonomik dhe të analizave të thelluara të ekonomisë së vendit dhe të rajonit;
- Në bashkëpunim me drejtori apo sektorë të tjerë të MFE-së dhe të institucioneve në varësi, ndjek ecurinë e zbatimit të legjislacionit fiskal në përgjithësi dhe efektshmërinë e Paketës Fiskale në veçanti;
- Në kuadër të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, ndjek me përparësi ecurinë e negociatave për lidhjen e tyre si dhe i propozon Ministrin të Financave dhe Ekonomisë, në bazë të fluksit të marrëdhënive tregtare, se me cilat vende të lidhen këto marrëveshje;
- Sigurimi i informacionit dhe propozime/rekomandime për Ministrinë në lidhje me problematikat dhe ecurinë e institucioneve në varësi të MFE-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit:

Misioni i kësaj drejtorie është planifikimi dhe menaxhimi me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet i shpenzimeve publike

Figura 6. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit






Funksionet kryesore të saj janë:

- Përgatitja e buxhetit të shtetit;
- Menaxhimi dhe monitorimi i buxhetit;
- Klasifikimi dhe sistemi buxhetor;
- Kryerja e analizave për shpenzimet publike dhe zhvillimi i politikave buxhetore;
- Shlyerja e detyrimeve të prapambetura. Menaxhimi me efektivitet i të dhënave mbi detyrimet e prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

Misioni i kësaj drejtorie është sigurimi dhe realizimi i shërbimeve operacionale për qeverisjen e përgjithshme, që garanton paranë e gatshme për kryerjen e transaksioneve të pagesave.

Figura 7. Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit



Funksionet kryesore të saj janë:

- Menaxhimi i likuiditetit të qeverisjes së përgjithshme.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Bashkëpunimi me drejtoritë e tjera për sigurimin e nevojave të qeverisë për mjete monetare për kryerjen e pagesave brenda kufijve të limitit të cash-it.
- Realizimi i kryerjes së pagesave në mënyrë të centralizuar nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë.
- Regjistrimi, kontrolli, kontabilizimi dhe përpunimi i informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme dhe mbi këtë bazë, gjenerimi i raporteve të ndryshme.
- Përmirësimi i sistemit të shërbimeve financiare në përshtatje me ndryshimet e vazhdueshme.
- Administrimi funksional i Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe raportimit financiar.
- Pagesat e dëmshpërblimeve të ish të përndjekurve politikë.

4.5.3. Përfaqësja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Referuar periudhës që po analizojmë 2010-2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka pasur një objektiv konstant të pasqyruar në të gjitha dokumentet strategjike dhe veçanërisht në Strategjitë Afatmesme mbi menaxhimin e borxhit publik (2011-2013; 2012-2014; 2013-2015; 2014-2016; 2015-2017; 2016-2018) që është:

- Sigurimi i nevojave të qeverisë për financim, shërbimin e borxhit aktual me kosto sa më të ulët kundrejt një shkalle të pranueshme risku, zhvillimin e tregjeve financiare dhe ruajtjen e një niveli të pranueshëm të stokut të borxhit publik;
- Krijimi i një profili të qëndrueshëm të shërbimit të borxhit në përputhje me kapacitetet shlyese të Qeverisë;
- Të promovojë dhe zhvillojë tregun primar dhe sekondar të instrumenteve financiarë shtetërorë;
- Të zgjerojë bazën e investitorëve dhe të diversifikojë burimet e financimit;



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Këto kërkojnë një koordinim me politikat makro-fiskale, politikat monetare dhe dialog ndër institucional me institucionet qeveritare të cilat kanë role mbikëqyrëse.

Gjatë periudhës 2013-2016, si shkak i rritjes në mënyrë të ndjeshme të kufirit të stokut të borxhit publik, politikat institucionale përveç objektivave të përbashkët kanë pasur edhe specifikat e tyre të cilat janë diktuar nga treguesit makroekonomike, nga problematikat e evidentuara në menaxhimin e borxhit publik, nga realizimi i tregueseve buxhetore, treguesit monetarë etj.

Për një menaxhim më të mirë të borxhit publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vendosi disa objektiva si:

- Reduktimi i riskut të rifinancimit, nëpërmjet financimit të defiçitit me instrumente afatgjatë, të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e strukturës së borxhit sipas instrumenteve, si dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së tij;
- Diversifikimi i burimeve të financimit, ku financimi i huamarrjes sipas investitorëve të ndryshojë peshën specifike, me qëllim uljen e riskut të varësisë nga investitorë të veçantë;
- Rënia e normave të interesit për instrumentet afatshkurtër (bono thesari 3-12 mujore) dhe kanalizimin e kërkesës për instrumente afatgjatë (obligacione 3-7 vjeçare);
- Reduktimi i shërbimit të borxhit, ulja e normës së interesit për instrumentet afatshkurtër, ndikon në uljen e kostos së shërbimit të borxhit.

Gjatë vitit 2013 rezultoi si problematikë shlyerja e detyrimeve të prapambetura kontraktuale midis qeverisë dhe biznesit. Këto detyrime të akumuluar nuk ishin evidentuar në regjistrat e borxhit publik, për rrjedhojë qeveria në bashkëpunim me FMN, bëri evidentimin e tyre dhe siguroi mbështetjen buxhetore nga FMN dhe BB, në kuadër të -Marrëveshjes për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambeturall.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Një nga politikat e institucionit në lidhje më detyrimet e prapambetura në kuadër edhe të Strategjisë mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është shlyerja e tyre për një periudhë 3-vjeçare dhe moskrijimi i tyre në të ardhmen.

Politikat e mësipërme institucionale janë projektuar në funksion të objektivit kryesor të qeverisë për borxhin publik që është –reduktimi i nivelit të stokut të borxhit nën 60% në raport me PBB-në deri në fund të vitit 2019.

Borxhi publik është elementi kryesor i financave publike të një vendi, rreth të cilit përqendrohet i gjithë procesi i programimit të buxhetit vjetor dhe atij afatmesem. Njëherësh mbajtja nën kontroll e termave të borxhit publik, është një nga treguesit e rëndësishëm makroekonomik që ndikojnë në konsolidimin e financave publike dhe projeksionet ekonomike për të ardhmen. Për të siguruar nevojat e qeverisë në shërbim të detyrimeve që lindin nga borxhi ekzistues dhe detyrimeve në nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve, MFE në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse ndjenë të nevojës menaxhimin e vazhdueshëm të borxhit në përmbushje të objektivave strategjikë.

Një ndër mjetet e qeverisë për të menaxhuar ecurinë e borxhit janë ligjet e buxhetit, të cilat kornizojnë kufijtë e huamarrjes për periudhat në vazhdimësi. Konkretisht, ligjet e buxhetit për periudhën 2012-2017 dhe aktet normative të secilës prej tyre, parashikojnë në mënyrë eksplicite kufirin për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese shprehur në milionë lekë.

Ligjet e buxhetit për periudhën 2012-2017 si dhe aktet normative të secilës prej tyre, parashikojnë në mënyrë eksplicite kufirin për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese shprehur në milionë lekë. Por rritja e vazhdueshme e stokut të borxhit prej strukturave përgjegjëse të MFE, ka shfaqur tejkalime të ndjeshme të këtij niveli, duke arritur në 73.97% në vitin 2016 dhe duke parashikuar përsëri devijime nga kufijtë ligjorë edhe për vitin 2017.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Mjet i dytë i Qeverisë për të menaxhuar prirjen e borxhit janë Strategjitë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB), të cilat gjenerojnë objektiva të përgjithshëm mbi trendin makroekonomik të vendit dhe objektiva specifike mbi treguesit e borxhit.


SAMB për periudhën 2012-2018 synojnë të japin orientime dhe alternativa në lidhje me politikën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mbajtjen nën kontroll të borxhit publik përgjatë këtij harku kohor, uljen e risqeve që ndikojnë mbi borxh, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të vendit, marrjen e masave për përmirësimin e rritjen e efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike, si dhe forcimin e disiplinës fiskale, etj. Përgjatë analizës së strategjive të borxhit, objektivat e SAMB 2012-2015 mbi mbajtjen në limite të treguesve të borxhit, reflektojnë diferenca të mëdha negative, kjo e ndikuar nga situata e trazuar e Eurozonës si pasojë e krizës së borxheve sovraane. Referuar SAMB mbi portofolin e borxhit, analizohet se përbërja e tij me huamarrje të brendshme afatshkurtër të lartë dhe huamarrje në monedhë të huaj të lartë, reflekton nivele edhe më të larta risku për shkak të rifinancimit në kohë të shkurtër të borxhit të brendshëm dhe riskut të kursit të këmbimit. Objektivi kryesor strategjik mbi përmirësimin e raportit kosto/risk qëndron në reduktimin e borxhit publik, përndryshe efektet financiare do të jenë të mëdha duke shkaktuar rrjedhimisht pagesa të larta të shërbimit të borxhit. Ky nivel borxhi për çdo vit të periudhës objekt studimi, cituar sipas SAMB dhe SKZHI duhet të qëndrojë në raportin poshtë 60% të PBB-së respektive.

Për të bazuar natyrën e gjetjeve dhe konkluzioneve të evidentuara në këtë studim, nisur nga rëndësia dhe ndjeshmëria që ka niveli i borxhit në opinionin publik, auditimet e performancës fokusohen edhe në analiza avangarde ekonomiko-financiare si bazë kriteri krahasueshmërie për projeksione pozitive në afatin e gjatë.

Në këtë qasje, janë analizuar disa tregues të nivelit të borxhit në raport me treguesit makroekonomik, bazuar në praktikën e FMN-ës mbi modernizimin e strukturës për politikën fiskale dhe analizën e qëndrueshmërisë së borxhit publik.

Treguesi i -Nivelet të borxhit sipas DSAI shpjegon trendin e projektuar që ndjek borxhi ndaj PBB-ës. Në këtë kontekst, jo vetëm tendenca, por edhe niveli i raportit të borxhit ndaj PBB-së është një tregues shumë i rëndësishëm në DSA.

Grafik 12. Niveli i borxhit sipas treguesit DSA



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpërndarja grafike pasqyron ndryshimet në përqindje të rritjes së borxhit përgjatë viteve 2012-2018, krahasuar me ndryshimet në përqindje të PBB dhe raportit Borxh/PBB të këtyre viteve. Sipas këtij treguesi, nisur edhe nga objektivat strategjike të një vendi si Shqipëria me kufizim të borxhit publik deri në 60% të PBB-së, shtegu i termave duhet të jetë i qëndrueshëm. Kjo shpjegon se rritjet relativisht -të vogëll të borxhit, sjellin shumë më pak rrezik për ekonominë sesa rritjet relativisht të qëndrueshme të raportit Borxh/PBB por -të lartall të këtij raporti krahasuar me objektivin strategjik. Kjo sepse borxhi shtrihet në periudha të mëvonshme afërsisht drejt intervaleve të qëndrueshme, për të mos krijuar barra pagesash të mëdha ose vështirësi pagese si ajo e ndodhur në vitin 2013.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Për periudhën e analizuar, konstatohet se, MFE në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për menaxhimin e borxhit publik, nuk e ka ruajtur nivelin e borxhit sipas objektivit strategjik të cituar në SAMB-it të viteve 2010-2018, duke raportuar nivel shumë të lartë të borxhit publik përtej parametrave të synuar.

Duke krahasuar nivelin e borxhit publik në secilën nga periudhat me objektivat strategjik të SAMB 2012-2014/2013-2015/2014-2016/2015-2017 dhe 2016-2018, vërehet se niveli i borxhit publik nuk tenton drejt parametrave të synuar. Kjo rritje e raportit të borxhit kundrejt PBB me një trend mesatar rreth 0.47%, është larg vlerave që projektojnë synimet strategjike.

Me rezultatet e gjeneruara nga analiza e qëndrueshmërisë së borxhit publik nëpërmjet treguesit të DSA, vërehet se projeksionet e borxhit nuk janë shtrirë në intervale të qëndrueshme për të mos krijuar barrë pagesash të mëdha si ajo e vitit 2013. Rritja e nivelit të borxhit më shumë sesa rritjet e raportit Borxh/PBB, krijojnë hapësira me rrezik për ekonominë.

Menaxhimi i borxhit publik mund të përkufizohet ndryshe si tërësia e veprimeve të një qeverie për të siguruar burimet financiare në sasinë dhe kohën e duhur për të përmbushur shërbimin e borxhit me koston më të ulët të mundshme. Përgjithësisht objektivat kryesore të menaxhimit të borxhit janë që të sigurojnë një financim të qëndrueshëm për të mbështetur aktivitetet e qeverisë me koston më të ulët të mundshme. Për të menaxhuar borxhin publik duhet të sigurohet se borxhi është i strukturuar në atë formë ku pagesat e shërbimit të tij janë të sigurta dhe të pa probleme përgjatë gjithë kohës.

4.5.4. Risqet e institucioneve përgjegjëse lidhur me borxhin publik

Risqet e aktivitetit të institucioneve të lartpërmendura janë pikërisht ato që përkufizojnë vështirësitë që hasin institucionet në përmbushjen apo mospërmbushjen e përgjegjësisë të tyre.



Ato janë karakterizuar më poshtë sipas analizës SWOT dhe sipas tipologjisë së tyre në risqe me nivel të ulët, të mesëm dhe të lartë. Në formë tabelare janë pasqyruar si më poshtë.

Tabela 3 Analiza SWOT

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
1) Gamë e qëndrueshme e portofolit të borxhit 2) Instrumente borxhi kompleks dhe jo-kompleks 3) Staf i qëndrueshëm 4) Financimi nëpërmjet borxhit të jashtëm me profil amortizimi të shtrirë në kohë dhe afat të gjatë maturimi, minimizon riskun e refinacimit 5) Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e menaxhimit të borxhit publik dhe çdo përgjegjësi të përcaktuar nga qeveria për ata që operojnë në menaxhimin e borxhit publik 6) Ndarje e detyrave dhe përgjegjësi funksionale sipas pozicioneve të punës	1) Mungesë kontrolli periodik për Drejtorinë e Borxhit dhe zbatimit të rekomandimeve 2) Mungesë transaksionesh në tregun financiar sekondar 3) Mungesa e profilit të amortizimit me shpërndarje më të njëtrajtshme të borxhit të brendshëm 4) Pjesa më e madhe e borxhit shtetëror vlerësohet në harkun kohor të një viti, për rrjedhojë borxhi publik është i ekspozuar ndaj lëvizjeve të normave të interesit 5) Luhatjen në normat e interesi në tregun e brendshëm dhe të jashtëm ndikojnë në rritjen e zërit të shpenzimeve në buxhet dhe në rritjen e borxhit publik 6) Komplexiteti i mirëmenaxhimit të portofolit të borxhit publik



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

	<p>7) Pozicione kyçe vakante</p> <p>8) Mungesë e analizave ekonomiko - financiare të treguesve të borxhit</p> <p>9) Të dhëna të ndryshme mbi të njëjtët tregues të borxhit dhe fiskalë</p>
Mundësitë (O)	Kërcënimet (T)
<p>1) Krijimi instrumentit benchmark të borxhit</p> <p>2) Vlerësimi i Republikës së Shqipërisë me B+/B (stable) stabil në emetimin e borxhit në monedhë lokale e të huaj (sipas Standard and Poors) jep mundësi për përparimin e mëtejshëm në këtë vlerësim</p> <p>3) Vlerësimi i transfertave dhe konvertueshmërisë së Republikës së Shqipërisë për borxhin e huaj është BB duke e mbajtur në vlera të përafërta me atë të rajonit.</p> <p>4) Risku që qeveria të mos shlyejë detyrat e veta në kohë (ose fare) mbetet i kontrolluar</p> <p>5) Përpjekje për të rritur jetëgjatësinë e borxhit të brendshëm nëpërmjet procedurave buyback</p> <p>6) Normë e qëndrueshme e inflacionit</p>	<p>1) Ndryshimi Ministrive brenda të njëjtës qeverisje</p> <p>2) Bashkimi strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në një të vetme duke ndikuar në rritjen e risqeve operacionale</p> <p>3) Financimi me borxh të brendshëm me instrumente afatshkurtër ekspozon riskun e rifinancimit.</p> <p>4) Operimi me instrumente borxhi në tregjet e huaja, rrit riskun e luhatjeve së kurseve të këmbimit</p> <p>5) Rritje e vazhdueshme e stokut të borxhit</p> <p>6) Mos realizimi i të ardhurave të buxhetuara</p>

Burimi: Përpunuar nga Autori



4.6. Mbledhja dhe baza e të dhënave për treguesit dhe kriterin e Politikës Fiskale

Ka shumë rëndësi aplikimi i standardeve dhe metodologjive të njëjta të Shqipërisë me vendet e BE-së për të bërë të mundur përlllogaritjen dhe analizën e treguesve dhe plotësimin e kriterëve. Ashtu siç vihet re nga trajtimi i mëposhtëm, Shqipëria e ka plotësuar këtë detyrim duke na mundur ne si studiues por edhe institucionet monitoruese dhe mbikëqyrëse të aplikojnë të njëjtat metodologji në llogaritjen e treguesve të shëndetit financiar publik të Shqipërisë ashtu si edhe në vendet e BE-së, duke bërë të mundur të analizohet *sa, si dhe pse kriteret janë përmbushur apo jo*.

Për defiçitin buxhetor dhe borxhin publik të Shqipërisë, së pari duhet të trajtojmë regjistrimin e të dhënave dhe plotësimin e standardeve metodologjike të çertifikuara nga organizma ndërkombëtarë. Në Shqipëri, metodologjia e përpilimit që mbështet të dhënat për buxhetin e konsoliduar prezantohet se është në përputhje me kornizën analitike të paraqitur sipas FMN-së në "Buletinin e Bordit për Shpërndarjen e Standardeve"²⁹, ku Shqipëria sipas raportit të FMN-së për vitin 2019 rezulton se aplikon E-GDDS dhe NSDP. Konkretisht E-GDDS është krijuar në 2015 për të udhëzuar vendet në shpërndarjen e të dhënave duke mbështetur transparencën, duke inkurajuar zhvillimin statistikor dhe duke ndihmuar krijimin e sinergjive të forta midis shpërndarjes së të dhënave dhe mbikëqyrjes. E-GDDS përmbys GDDS, e cila ishte themeluar në vitin 1997. Ndërsa NDDS do të thotë faqja përmbledhëse e të dhënave (NSDP) dhe është një "portal i të dhënave" për Shqipërinë si një nga vendet që merr pjesë në SDDS Plus, SDDS dhe e-GDDS.

²⁹ <https://dsbb.imf.org/>. Kjo faqe ofron informacione mbi të dhënat e prodhuara dhe shpërndara nga vendet anëtare që marrin pjesë në e-GDDS.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

NSDP lejon përdoruesin të përdori të dhëna, të shikojë me ta data ose të shfletojë linqe në të dhënat online për të gjitha kategoritë në dispozicion për Shqipërinë, edhe nëse këto kategori janë përpiluar nga agjensi të shumta statistikore. Sipas raportit të FMN-së për vitin 2019 ashtu si Shqipëria rezulton se edhe vendet e rajonit si Bosnjë-Herzegovina, Serbia, Mali i Zi, dhe Kosova aplikojnë E-GDDS dhe NSDP. Ndërsa Maqedonia e Veriut ende vijon të aplikojë vetëm SDDS Plus.

Për të monitoruar konvergencën e kritereve fiskale, llogaritjet duhet të bëhen duke përdorur metodologjinë e Eurostat ESA2010. Në ditët e sotme, vendet anëtare të BE-së kanë përfunduar harmonizimin e metodologjive të tyre me ESA2010, dhe të dhënat raportohen sipas ESA2010.

Shqipëria si vend kandidat për pranimin në BE ka filluar zbatimin e ESA 2010³⁰ gjatë vitit 2014. ESA 2010 do të thotë që të dhënat e llogarive kombëtare kanë të bëjnë me të gjitha të dhënat e prodhuara dhe të shpërndara për një ekonomi sipas përkufizimeve dhe udhëzimeve të Sistemit Europian të Llogarive (ESA 2010). Llogaritë kombëtare ofrojnë të dhëna për ekonominë totale, por mund të përfshijnë gjithashtu ndarje të ekonomisë totale (në sektorë, industri, produkte, rajone, etj.). Llogaritë kombëtare ofrojnë të dhëna për disa fusha: llogari kombëtare vjetore dhe tremujore (agregatët kryesorë), llogari sektori, llogari financiare, tabela të furnizimit dhe përdorimit dhe hyrje-daljeve, llogari rajonale dhe statistikat e financave të qeverisë.

Një nga agregatet kryesore të llogarive kombëtare i domosdoshëm për studimin tim është shkalla e ndryshimit të produktit të brendshëm bruto të rregulluar me çmimin (PBB), i cili tregon zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe referohet/quhet gjithashtu edhe si normë e rritjes ekonomike. INSTAT publikon të dhëna në faqen e saj në internet: <http://www.instat.gov.al/al/home.aspx>.

³⁰https://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/EN/na10_esms_al.htm



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Të dhënat e llogarive kombëtare janë paraqitur në seksionin "Ekonomia dhe financat" dhe janë organizuar në koleksionet e mëposhtme: PBB e Llogarive Kombëtare; Tabelat e furnizimit, përdorimit dhe hyrjes-daljes; Llogaritë rajonale në Shqipëri; Statistikat Fiskale; Statistikat bankare; Llogaritë vjetore sipas sektorit institucional.

Të gjitha këto u arritën pasi Shqipëria zbatoi disa nga ndryshimet e reja metodologjike në grumbullimin dhe përpunimin e Llogarive Kombëtare, të cilat janë si në vijim:

- ✓ Zgjerimi i vlerësimeve për sektorin financiar, përfshirë të gjitha institucionet financiare për të cilat janë të disponueshme të dhënat bazuar në klasifikimin e ri të ESA 2010 dhe SNA 2008.
- ✓ Zbatimi i një metode të re për llogaritjen e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matur në mënyrë indirekte (FISIM).
- ✓ Vlerësimi i prodhimit të rezultatit të Bankës së Shqipërisë bazuar në dallimin që do të bëhet midis prodhimit të tregut dhe jo-tregut, sipas SNA 2008 / ESA 2010.
- ✓ Shqyrtimi i përcaktimit për prodhimin e kompanive të sigurimeve që ofrojnë sigurim jo-jetë.
- ✓ Aplikimet metodologjike nën ESA 2010 për vlerësimin e treguesve të shpenzimeve (trajtimi i konsumit përfundimtar të familjeve sipas shifrës 2 COICOP, trajtimi dhe formimi i kapitalit fiks bruto sipas llojit të pasurive, etj.).
- ✓ Përpilimi dhe shpërndarja e Tabelave të Furnizimit dhe Përdorimit (TFP), për vitin referues 2014, në përputhje me programin e transmetimit të kërkesave të të dhënave (ESA 2010), të cilat ofrojnë një portret të detajuar të një ekonomie dhe janë një instrument i rëndësishëm në analizimin dhe krijimin e modeleve statistikore. Këto tabela përshkruajnë burimet dhe përdorimet e produkteve



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

dhe marrëdhëniet ndër-industri në ekonomi. Përpilimi dhe shpërndarja e tabelave bëhet 3 vjet pas viteve të referencës ($t + 3$) në përputhje me kërkesat e programit të transmetimit të të dhënave (ESA 2010).

- ✓ Tabelat e Furnizimit dhe Përdorimit aktualisht publikohen çdo vit, ndërsa TFU-të me çmime konstante (PYP) përpilohen në mënyrë eksperimentale për vitin 2013 -2015. Tabelat hyrëse-dalëse përpilohen në bazë pesë-vjeçare (për vitet e referencës që përfundojnë 0 dhe 5).

Të dhënat e llogarive kombëtare janë të dhëna kyçe të përdorura dhe të publikuara nga shumë organizata ndërkombëtare për të përmirësuar konsistencën e të dhënave dhe për të shfrytëzuar sinergjitë për mbledhjen dhe vërtetimin e të dhënave. Një iniciativë për të përmirësuar ndarjen e të dhënave për Llogaritë Kombëtare u lançua në vitin 2016 nga Grupi i Ndër-Agjencive për Statistikat Ekonomike dhe Financiare (që përfshin përfaqësues të Bankës për Zgjidhjet Ndërkombëtare, Bankën Qendrore Evropiane, Eurostat, FMN, Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik- operacioni dhe zhvillimi, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore) në bazë të Nismës G20 Data Gap. Të dhënat e llogarive kombëtare të Shqipërisë përdoren si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht nga studiues, organizata të ndryshme, politikëbërës dhe analistë. Të dhënat kombëtare (llogaritë nacionale) nga Shqipëria raportohen në drejtim të Eurostat në kuadër të Programit të Transmisionit ESA 2010, tek FMN sipas përshkrimit të mësipërm, si edhe tek OECD, ECB dhe organizata të tjera.

Koherenca e të dhënave. Brenda sistemit të llogarive kombëtare ka konsistencë të plotë midis fushave: llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore, llogaritë qeveritare, llogaritë sektoriale, llogaritë financiare, llogaritë rajonale, tabelat e furnizimit dhe përdorimit. Sidoqoftë, në praktikë konsistenca e plotë mund të mos jetë gjithmonë e mundur dhe mund të shfaqen mospërputhje të përkohshme. Ata zakonisht janë rezultat i diferencave të ardhura nga e shkuara.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Statistikat parësore si statistikat strukturore të biznesit (SSB), statistikat afatshkurtra (SAS) dhe statistikat e forcave të punës (SFP) përdoren gjerësisht si input për llogaritë kombëtare. Sidoqoftë, nuk ka konsistencë të plotë midis këtyre fushave statistikore dhe llogarive kombëtare. Arsyet kryesore janë ndryshimet në koncepte / përkufizime dhe në mbulim. Bilanci i pagesave përdoret gjithashtu si një burim i rëndësishëm për llogaritë kombëtare. Përkufizimet dhe mbulimi i bilancit të pagesave, siç përcaktohet në manualin BPM6, janë plotësisht të harmonizuara me ato të ESA 2010. Prandaj, variablat e bilancit të pagesave janë në parim plotësisht koherent me variablat e llogarive kombëtare përkatëse.

Të dhënat e llogarive kombëtare i nënshtrohen rishikimeve të vazhdueshme pasi të dhënat e reja të hyrjes bëhen të disponueshme. Ato quhen revizione rutinore dhe sjellin rishikime të rregullta të të dhënave të vendit dhe të agregatëve europiane, të cilat rrjedhin nga ato të mëparshme. Më rrallë, rishikimet e jashtëzakonshme (të quajtura rishikime të standardeve) do të vijnë nga ndryshime të mëdha në burimet e të dhënave, klasifikimet ose metodologjia. Për shembull, kur duhej të aplikohen ndryshimi nga ESA95 në ESA 2010, një rishikim i standardit ka ndodhur në nivelin e të dhënave për vendin, Shqipërinë, po ashtu u krye rishikim edhe në nivelin e të dhënave të BE-së.

Grumbullimi i të dhënave për llogaritë kombëtare bazohen në statistika që kryesisht mblidhen për qëllime të tjera (statistikat parësore). Ato mbështeten në një shumëllojshmëri të burimeve të të dhënave, përfshirë të dhënat administrative: regjistrat e makinave dhe biznesit, pasqyrat e kontabilitetit, të dhënat tatimore, raportet buxhetore, regjistrimet e popullsisë, anketimet statistikore të bizneseve dhe familjeve, deklaratat e institucioneve mbikëqyrëse dhe organizatat e degëve, raportet vjetore dhe tremujore, statistikat e tregtisë për mallrat dhe shërbimet, informacioni mbi bilancin e pagesave.



Nuk ka asnjë burim të jetë i dedikuar vetëm për marrjen e të dhënave për llogaritë kombëtare. Burimet ndryshojnë nga një vend në tjetrin dhe ato japin informacione statistikore për një grup të madh fenomenesh ekonomike, sociale, financiare dhe mjedisore, të cilat mund të mos jenë të lidhura rreptësisht me llogaritë kombëtare.

4.7. Analiza bazuar në ANOVA dhe Regresionit të shumfishtë

Për të parë realisht lidhjen midis variablave të pavarur (Borxhit publik, Shpenzimet totale si dhe te ardhurat totale) me PBB i referohemi ndërtimit të ekuacionit të regresionit të shumfishtë linear,

Trajta e përgjithshme e tij është:

$$Y_i = b_0 + b_1X_1 + b_2X_2 + \dots + b_nX_n + \varepsilon_i$$

Sa i takon analizës tonë vërejmë se për $df(3;7)$ dhe $F=17.932$ kemi se vlera e $Sig. = 0.001 < 0.05$, pra kjo na lejon të themi se ka një korrelim midis variablit të varur dhe variablave të pavarur (faktorëve ekonomikë) (Table 1)

Tabela 4. Analiza sipas Teknikës ANOVA

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	236,864,272,022	3	78,954,757,341	17.932	.001 ^b
	Residual	30,821,262,188	7	4,403,037,455		
	Total	267,685,534,211	10			

a. Dependent Variable: PBB

b. Predictors: (Constant), Te ardhurat totale, Borxhi Publik, Shpenzimet totale



Analiza e mëposhtme e këtyre faktorëve tregon se gjithë faktorët (variablat e pavarur) hyjnë në veprim me variablin varur PBB pasi të gjitha vlerat e Sig. të tyre janë më të vogla se 0.05, prandaj ekucioni ynë ka formën si më poshtë:

$$(PBB) = 520,613.9 + 14,137.3 (\text{Borxhi publik}) - 53,277.2 (\text{Shpenzimet totale}) + 57,816.7 (\text{Te ardhurat totale})$$

Tabela 5. Analiza e regresionit të shumëfishtë midis variablave të pavaur dhe variablit të varur PBB

Modeli	R ²	R ² e rregulluar	t	Sig.
<i>Kostantja</i>	0.885	0.836	0.858	0.419
Borxhi Publik			4.218	0.004
Shpenzimet totale			-3.837	0.006
Te ardhurat totale			2.910	0.023

Nga trajta e ekucionit duket se, të ardhurat totale dhe borxhi publik kanë vlera pozitive të koeficientëve β ndërsa variabli shpenzimet totale i cili përfshin shpenzimet korrente, investimet, dhe shpenzimet e tjera, ka vlerë negative që do të thotë se rritja e shpenzimeve ul PBB ndërsa rritja e të ardhurave apo e borxhit publik ndikojnë pozitivisht në rritjen e PBB-së.



Referuar koeficienteve pozitive β të këtyre faktorëve, vlera më e madhe e tij është për faktorin - të ardhurat totale (e cila përfshin të ardhurat nga tatimet dhe doganat, nga pushteti vendor, të ardhurat nga fondet speciale si dhe të ardhurat jo tatimore gjithashtu), e ndjekur nga borxhi publik. Nga ana tjetër të gjithë këta faktorë të pavarur shpjegojnë 83.6% të ndryshimit të vlerave të PBB-së, e konfirmuar kjo nga vlera e R^2 ose ndryshe koeficienti i përcaktueshmërisë së ekuacionit të regresionit të shumëfishtë linear vlerat e të cilit variojnë nga 0% deri në 100%, pra jemi në vlera shumë të mira, ose thënë ndryshe modeli i këtij ekuacioni të shumëfishtë linear shpjegon 83.6% të vlerave të PBB-së.

4.8. Zvogëlimi i ekonomisë informale dhe mjedisi biznesit

Analiza për progresin e bërë gjatë viteve të fundit lidhur me plotësimin e politikave të Miratuar në Dialogun Ekonomik dhe Financiar mes Shqipërisë dhe BE-së paraqitet përmes një tablele ku në një rën anë janë politikat sipas udhëzimeve dhe në anën tjetër jepet në mënyrë të përmbledhur arritja e tyre.

Tabela 6. Zbatimi i Udhëzimit³¹

Udhëzimi	Vlerësimi
PG ³² 1: Shqipëria të vazhdojë të ndjek rregullimet fiskale me qëllim përmbushjen e synimeve afatmesme të dakorduara nga vet qeveria për uljen e borxhit publik ndaj PBB-së. Të paraqiten masat e mëtejshme të konsolidimit fiskal nëse ulja e borxhit është në rrezik të mos bjerë për të arritur objektivin.	Ka pasur zbatim të kufizuar të PG 1. • Deficiti fiskal është stabilizuar në rreth 2% të PBB-së e cila - nën kushtet aktuale ekonomike - është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimin e zvogëlimit të raportit të deficitit buxhetor ndaj PBB-së mbi baza vjetore. Sidoqoftë, nuk ka të ngjarë të jetë e mjaftueshme për të respektuar angazhimin për të ulur raportin e borxhit publik

³¹ 0 = pa zbatim; 1 = po përgatitet implementimi; 2 = janë ndërmarrë hapat fillestarë; 3 = zbatimi në vazhdim me disa rezultate fillestare; 4 = zbatimi është avancuar; 5 = zbatim i plotë

³² Policy Guide



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

	<p>nga aktualisht rreth 70% për nën 60% deri në vitin 2021. Asnjë masë tjetër e konsolidimit fiskal nuk është përfshirë.</p>
<p>PG 2: Shqipëria të vazhdojë përpjekjet për mobilizimin e të ardhurave, veçanërisht nga</p> <p>(i) forcimi i administratës tatimore.</p> <p>ii) zgjerimi i bazës tatimore bazuar në një rishikim të shpenzimeve tatimore.</p> <p>(iii) vendosjen e një tatimi mbi pasurinë bazuar në vlerësimin e tyre.</p>	<p>PG 2 është implementuar pjesërisht.</p> <p>(i) Zbatimi i pjesshëm: Të ardhurat vjetore të taksave u rritën me 7.8% në 2017 dhe kontributet e sigurimeve shoqërore u rritën me 9.7% bazuar në 50 000 kontribues të rinj. Veçanërisht zhvillimi i fundit sugjeron që fushata kundër informalitetit është duke arritur rezultate.</p> <p>(ii) Zbatimi i kufizuar: Ka pasur një shtrirje modeste të bazës, por nuk ka pasur ndonjë rishikim të shpenzimeve tatimore përveçse nga misioni i nenit IV të FMN. Ka pasur disa lëvizje mbrapa në zgjerimin e bazës duke dhënë përjashtime të reja tatimore për sektorët turistikë dhe IT.</p> <p>(iii) Zbatimi i pjesshëm: Ligji i Taksave Lokale u ndryshua në Dhjetor 2017 dhe ka hyrë në fuqi më 1 Prill 2018. Aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e një tatimi mbi pasurinë me bazë vlerësimi u miratuan në Mars 2018. Zbatimi i plotë në mbarë vendin është ende në pritje.</p>



4.9. Sfidat e Politikës fiskale

Përpyekjet për të arritur vizionin e një menaxhimi modern dhe efikas të financave publike të Shqipërisë janë përqëndruar në zbatimin e disa instrumenteve: legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve, ndryshimeve të kulturës, zhvillimit të IT dhe rishikimit të proceseve.

Referuar pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura për këtë punim, konkludoj se Shqipëria vijon të ketë sfida të politikës fiskale për anëtarësimin në BE të tilla si evazioni fiskal, ekonomia informale dhe mos plotësimi i kriterit të borxhit publik ende shumë mbi nivelin e kërkuar dhe të premtuar nga qeverisja e Shqipërisë në përpyekjet e saj drejt integritimit. Pavarësisht se qeverisja e Shqipërisë ka meritë në arritjen e një prej kriterëve, i cili është treguesi i defiçitit buxhetor. Punimi ka trajtuar përmes teknikave statistikore ecurinë dhe prespektivat e PBB-së sipas politikës fiskale të aplikuar nga 2008 në 2018 në Shqipëri dhe evidenton se rritja e shpenzimeve qeveritare ul PBB ndërsa rritja e të ardhurave në buxhetin e shtetit por edhe borxhi publik ndikojnë pozitivisht në rritjen e PBB-së. Përmes këtyre pyetjeve vërtetohet

H1: “Shqipëria ende nuk i ka kapërcyer sfidat për plotësimin e treguesve të kriterit të Politikës Fiskale për anëtarësimin e saj në Bashkimin Europian.”

Gjithashtu, gjatë vitit 2008 –2018, për të arritur objektivat, të përcaktuara në Strategjinë e MFP, MFE ka ndërmarrë disa aktivitete për të përmirësuar këto instrumente. Në fillim të vitit 2018, MFE ka ndërmarrë procesin e Vlerësimit Afatmesëm për Strategjinë PFM për të identifikuar progresin, arritjet, sfidat dhe boshllëqet në mënyrë që të planifikojë axhendën e ardhshme dhe qasjen SMART ndaj reformës së MFP. Janë ndërmarrë dhe përcaktuar programet, aksionet dhe përparësitë kryesore për periudhën 2018-2022.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Strategjia e rishikuar e MFP 2018-2022 dhe Plani i Veprimit 2018-2022 duke marrë parasysh zbatimin dhe përparimin e bërë për secilën shtyllë, është vendosur që të vazhdohet zbatimi për shumicën e aktiviteteve në vazhdim, disa aktivitete janë riformuluar dhe aktivitete të reja janë shtuar, bazuar në gjetjet e raporteve ndërkombëtare. Po ashtu, pas rishikimit të kornizës së MFP dhe fokusit tek parimet kryesore, u propozua që Strategjia e Rishikuar e MFP 2018-2022 të përbëhet nga shtatë shtylla. Në këtë kontekst, duke synuar që të përqendrohemi më shumë në realizimin e planit të veprimit, propozohet që shtylla tre (3) të ndahet në 2 (dy) shtylla: kolona 3- Administrimi i të Ardhurave dhe shtylla 4- Menaxhimi efektiv i Buxhetit të Shtetit.

Shtylla 1: Kuadri fiskal i qëndrueshëm dhe i kujdesshëm: Kjo shtyllë do të përbëhet nga dy komponentë.

Komponenti i parë: -Rregullat fiskale, parashikimi dhe korniza e përgjegjësisë fiskale, pasi të gjitha aktivitetet e planifikuara kanë përfunduar, strategjia e rishikuar do të përmbajë një fokus të ri: Monitorimin dhe raportimin e zbatimit të rregullave fiskale sipas LOB, me objektiv si më parë, për të siguruar një kornizë fiskale të qëndrueshme dhe të kujdesshme, bazuar në objektivat fiskale të përcaktuara qartë.

Komponenti dytë: "Menaxhimi i rrezikut fiskal" do të përqendrohet si më parë duke synuar të sigurojë aftësi të përshtatshme për të zbuluar monitorimin dhe të propozojë masa për të lehtësuar rreziqet fiskale me të cilat përballet qeveria.

Shtylla 2: Planifikimi dhe buxhetimi i integruar dhe efikas i shpenzimeve publike: Kjo shtyllë përbëhet nga pesë përbërës.

Komponenti një: "Menaxhimi i zhvillimit të politikave dhe përmirësimi i qeverisjes strategjike të integruar", do të jetë përqendrimi në përmirësimin e procesit të zhvillimit dhe monitorimit të strategjive sektoriale dhe integritit me PBAM.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Komponenti i dytë: -Do të përqendrohet në përmirësimet metodologjike dhe do të zbatohet plotësisht udhëzimin e ri të PBAM për avancimin e mëtejshëm të Programit dhe Buxhetimin e Performancës.

Komponenti i tretë: "Planifikimi i investimeve kapitale, vlerësimi dhe përfshirja në buxhet", do të përqendrohet në zbatimin e procedurave të reja të MPI-së që synojnë të optimizojnë vlerën për para.

Komponenti i katërt: -Projekti dhe Kontrata e PPP-së dhe Konçesioneve është propozuar të shtohet si një komponent i ri. Ai përfshin një fokus të ri të strategjisë MFP, për të siguruar një kornizë të kujdesshme ligjore dhe të rreptë për një menaxhim më të mirë të PPP-së dhe Konçesioneve në të gjitha fazat, me qëllim zvogëlimin e rrezikut fiskal.

Komponenti i pestë: "MFP në qeverisjen lokale" do të jetë përqëndrimi në menaxhim më të mirë dhe rritje të mbledhjes së të ardhurave lokale; zhdoganimin e borxheve lokale; dhe në përafrimin e PBAM në nivelin lokal me PBAM në nivelin qendror. Objektivi është riformuluar si "Menaxhim i kujdesshëm, efektiv dhe efikas financiar i qeverive lokale dhe një planifikim dhe buxhetim i integruar mirë dhe efikas".

Shtylla 3: Administrata e të Ardhurave: Kjo është një shtyllë e re me dy komponentë ekzistues tatimin dhe administrim me porosi që mbulon vetëm anën e të ardhurave nga ekzekutimi i buxhetit. *Komponenti i parë:* "Administrata tatimore" do të vazhdojë me objektivin për të siguruar një menaxhim efektiv, efikas dhe transparent të të ardhurave tatimore, duke u përqëndruar kryesisht në bazën e taksave të pasurive.

Komponenti i dytë: "Menaxhimi Doganor" do të përqendrohet në objektivin për të mbrojtur interesat financiare dhe ekonomike të Shqipërisë, për të kontribuar në sigurinë e shoqërisë dhe për të lehtësuar tregtinë, të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë palët e interesuara.



Shtylla 4: Realizimi i efektshëm i buxhetit: Kjo është një shtyllë e re me pesë përbërës ekzistues. *Komponenti i parë:* është "Përmirësimi i mbulimit dhe funksionalitetit të SIQMFSH", i cili është i përqëndruar për të vënë në dispozicion SIQMFSH për të gjitha njësitë kryesore të buxhetit dhe për të integruar SIQMFSH dhe sistemet e tjera qeveritare të IT nën SIMFSH. Objektivi është kontrolli i brendshëm financiar plotësisht transparent dhe i unifikuar në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit.

Komponenti i dytë: është "Menaxhimi i fondeve të jashtme". Fokusi do të jetë në vënien në veprim të EAMIS dhe integrimin me SIMSPI dhe SIMFSH. Objektivi do të jetë "Përdorimi efektiv dhe transparent i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të qeverisë për të gjitha fondet e jashtme, përfshirë projektet e financuara nga BE në kuadër të programeve INP në mënyrë të Decentralizuar".

Komponenti i tretë: "Menaxhimi i borxhit" ka si objektiv të sigurojë nevojën e financimit të qeverisë në kohën e duhur, si dhe të minimizojë kostot e huamarrjes që i nënshtrohen mbajtjes së rreziqeve në një nivel të pranueshëm.

Komponenti katër: -Prokurimi Publik do të përqëndrohet në përmirësimin e planifikimit të procedurave të prokurimit publik; rritja e transparencës në prokurimin publik; përmirësimi i efikasitetit në përdorimin e fondeve publike; përmirësimi i kornizës ligjore të ndryshimit të kornizës rregullatore të PPC, në përputhje me Ligjin e ndryshuar të Prokurimit Publik dhe forcimin e pavarësisë së PPC.

Komponenti i pestë: "Menaxhimi i Aseteve" do të përqëndrohet në regjistrimin e plotë të pasurive përfshirë vlerat dhe rregullat e amortizimit sipas standardeve kombëtare.



Shtylla 5: Vlerësimi i transparencës së financave publike: Shtylla ekzistuese katër do të zhvendoset si shtylla e pestë, dhe do të riemërtohet: "Vlerësimi i transparencës së financave publike".

Komponenti parë: "Kontabiliteti" i shtyllës pesë do të përqendrohet si më parë duke synuar të sigurojë zbatimin e plotë të SNKSP në mënyrë që të ketë përmirësim të Standardeve të Raportimit Financiar.

Komponenti i dytë: do të jetë "Llogaritë e Qeverisë Kombëtare", i cili hiqet nga shtylla një deri në shtyllën e pestë, pasi që objektivi për të ndërtuar një sistem të pavarur statistikor për vlerësimin e SFQ duke ndjekur standardet ndërkombëtare, është i lidhur më shumë me raportimin e qeverisë dhe jo me objektivin të kolonës së parë, e cila synon të ruajë një kornizë të qëndrueshme dhe të kujdesshme fiskale. Kjo përfshin procesin e përgatitjes së raporteve pas ESA 2010 TP në SFQ, për të përpiluar dhe dërguar tabela të reja të SFQ në EUROSTAT.

Shtylla 6: Kontrolli i brendshëm efektiv.

Komponenti parë: "Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në Institucionet Publike" do të përqendrohet në ndryshimin e kornizës metodologjike të KMF-së, monitorimin e zbatimit të kornizës ligjore për KMF-në dhe rritjen e ndërgjegjësimit të njësive publike për përfitimet e zbatimit të koncepti i "Përgjegjësisë menaxheriale". Treguesi objektiv dhe rezultati do të mbetet i njëjtë si më parë.

Komponenti dytë: "Auditimi i Brendshëm" do të përbëhet nga katër nën-komponentë që do të përqendrohen në kryerjen e vlerësimeve të jashtme për institucionet publike në lidhje me veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe vlerësimin dhe adresimin e shkaqeve themelore të prapambetjeve në raportet e njësisë së auditimit të brendshëm. Objektivi do të ndryshohet duke u përqëndruar më shumë në forcimin e funksionit të AB në sektorin publik. Treguesit e rezultatit do të mbeten të njëjtë si më parë.



Pjesa e tretë "Inspektimi i Financave Publike" do të përbëhet nga tre nën-komponentë që do të përqendrohen në përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e përgjegjësisë dhe integritetit të inspektorëve të brendshëm financiar publik; për rritjen e fushatës së ndërgjegjësimit për rolin dhe funksionet e Inspektimit Financiar Publik, si dhe në rritjen e cilësisë së ekspertëve të jashtëm të financave publike. Objektivi do të ndryshohet duke u përqëndruar më shumë në përmirësimin e efikasitetit të inspektimit financiar publik.

Shtylla 7: Mbikëqyrja efektive e jashtme e financave publike:

Komponenti parë: "Auditimi i Jashtëm" do të përqendrohet në përmirësimin e kornizës ligjore dhe ndikimin e punës së auditimit, duke prezantuar gjithashtu qasje të reja të auditimit. Propozohet të shtohet

Komponenti dytë: "Forconi mbikëqyrjen parlamentare dhe përgjegjësinë për shpenzimet publike". Ai do të përqendrohet në shqyrtimin e raporteve vjetore të auditorit për financat publike dhe publikimin e raporteve për zbatimin e buxhetit brenda vitit.



KAPITULLI V

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

5.1. Hyrje

Politika makroekonomike është një grup masash politike përmes të cilave politikëbërësit kërkojnë të ndikojnë në gjendjen e ekonomisë dhe në këtë mënyrë të përmbushin objektiva të ndryshëm ekonomike dhe jo-ekonomike.

Në përgjithësi, këto masa politike mund të ndahen në dy instrumente kryesore të politikës makroekonomike: politika fiskale dhe politika monetare. Politika monetare, e cila është në fushën e Bankave Qendrore, paraqet përdorimin e instrumenteve të drejtuara drejt qëllimit kryesor të stabilitetit të çmimeve, të favorshme për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Qeveritë e Shqipërisë për çdo vit ndërtojnë buxhetin sipas zërave përkatës në mënyrë që të ndikojnë në rritjen ekonomike dhe në këtë mënyrë të arrijë objektivat e ndryshme ekonomike, sociale dhe politike. Në njërin anë, buxheti përfshin përbërësit e shpenzimeve qeveritare dhe, nga ana tjetër, përbërësit e të ardhurave të qeverisë. Ekuilibri i përgjithshëm midis këtyre dy përbërësve përcakton bilancin e përgjithshëm të buxhetit të qeverisë ose bilancin strukturor duke eliminuar përbërësin ciklik të ciklit të biznesit.

Në krahasim me politikën monetare, e cila është më e natyrshme teknokratike, duket se politika fiskale mbulon një perspektivë më normative pasi pasqyron vlerat dhe besimet e përfaqësuesve të qeverisë së Shqipërisë në lidhje me atë që do të ishte një sistem ideal ekonomik dhe social për Shqipërinë.

Megjithëse politika fiskale është kryesisht e përcaktuar nga ana politike, historike dhe shoqërore, kjo nuk do të thotë se politika fiskale nuk mund t'i nënshtrohet një analize pozitive ekonomike.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Duke parë politikën fiskale historikisht nga këndvështrimi i teorisë ekonomike, ka pasur disa periudha kur politika fiskale ka qenë jo efiçiente dhe si rrjedhim e parëndësishme dhe nga ana tjetër ka pasur shumë periudha kohe kur në shoqërinë ekonomike ka ekzistuar mendimi se mekanizmi i transmetimit të politikës fiskale përgjithësisht mund të konsiderohet efektiv për rregullimin e mirë dhe stabilizimin e ekonomisë.

Borxhi mesatar publik ndaj PBB-së së vendeve anëtare të BE-së sipas statistikave të periudhës kur u hartuan kriteret e Mastroiit ishte afërsisht 60%. Gjithashtu u vlerësua se shkalla më e mundshme e rritjes së borxhi mesatar publik ndaj PBB-së në vitet që do të vinin do të ishte deri në 5%.

Diskutimi që lidhet me sfidat e politikës fiskale për vendet si Shqipëria që duan t'i bashkohen BE-së dhe ndikimet e politikës fiskale në rritjen ekonomike janë fusha studimi mjaft aktuale pasi zhvillimi i instrumenteve të duhura fiskale mund të na çojë në një rritje ekonomike të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Borxhi Publik dhe potencialet për zvogëlimin e tij janë sfida direkte të qeverisjes, dhe si të tilla duhet pasur parasysh që ndikojnë në mos plotësim të kriterit të Politikës Fiskale. Duke u bazuar në teorinë shkencore ku politika fiskale ekspozohet si ekspansioniste, ajo mund të ndërtohet edhe si politikë fiskale shtrënguese.

Pra, shteti mund të rrisë normën e taksave dhe të reduktojë nivelin e shpenzimeve publike, duke e pasur si orientim zvogëlimin e borxhit. Po ashtu, mund të konkludojmë se qeveria mund të mirë qeverisë evazionin fiskal dhe shpenzimet buxhetore për të qenë me kthim më të lartë në ekonomi dhe në rritjen e kërkesës agregate. Në vijim paraqes konkluzionet kryesore:



5.2. Konkluzione

1. Pavarësisht vështirësive në gjetjen dhe kryerjen e analizës për politikën fiskale dhe sfidat e saj të drejtpërdrejta për një vend kandidat për pranimin në BE, përmes këtij punimi arrij të konkludoj se: perspektiva e anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe kufijtë e ngushtë të manovrimit për marrjen e masave për balancim të treguesve makro ekonomike duket se kanë pasur një rol të fortë nxitës për autoritetet qeverisëse dhe fiskale të Shqipërisë për tu kujdesur për miratimin dhe aplikimin e politikave fiskale deri diku të kujdesshme me qëllim arritjen e objektivave, pavarësisht se ende vijon të mos kenë arrit objektivat e kërkuara.
2. Politika monetare është leva tjetër nga e cila pritej të kishte rregullime për ato hapësira të cilat nuk mund të ndërhyhet me anë të politikës fiskale. Konstatohet se Shqipëria ka mungesë të efektivitetit të politikës monetare dhe mekanizmit të transmetimit të saj përmes uljes apo ngritjes së normës bazë të interest dhe kjo është justifikuar nga Banka e Shqipërisë për shkak të shkallës së lartë të euroizimit të Shqipërisë, pavarësisht masave dhe luftës që i ka shpallur qeveria e Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë prej më shumë se 5 vjetësh. Pra, Shqipëria ndodhet në situatën e një politike monetare anemike pothuajse pa fuqi për të shërbyer ekonomisë së vendit dhe duke e lënë vetëm politikën monetare për të manovruar në rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit dhe në reduktimin e pabarazive që sa vijnë dhe thellohen mes shqiptarëve.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

3. Rritja ekonomike në vitet e pas krizës botërore ka krijuar mundësinë e rritjes së të ardhurave fiskale dhe uljen e defiçitit buxhetor, por nga ana tjetër kanë krijuar edhe mundësinë e rritjes së masës së borxhit publik.
4. Ulja dhe mbajtja e defiçitit buxhetor brenda objektivit nga Shqipëria, në mungesë të vlerësimeve të boshllëqeve të prodhimit dhe ekuilibrave strukturorë mbetet e vështirë të vlerësohet saktë shkalla në të cilën këto përmirësime janë thjesht ciklike apo të një natyre strukturorë.
5. Për periudhën e studiuar në këtë punim evidentohet se niveli i borxhit publik gjatë periudhave afatmesme 2012-2014/2013-2015/2014-2016/2015-2017 dhe 2016-2018 nuk ka qënë në përputhje me objektivat strategjik të SAMB. Kjo rritje e raportit të borxhit kundrejt PBB me një trend mesatar rreth 0.47%, është larg vlerave që projektojnë synimet strategjike.
6. Sektorë me kontributin më të lartë në rritjen reale të PBB-së janë mbështetur shumë pak me disbursime të borxhit të jashtëm me qëllim që ato të vijonin më tej duke kontribuar në rritjen e PBB-së. Si rrjedhim, që prej vitit 2016 vihet re reduktimi i kontributit të tyre në mbështetjen e rritjes së PBB-së.
7. Marrëdhënia mes një defiçiti buxhetor brenda kufirit të 3% të PBB-së dhe borxhit publik deri në 60% të PBB-së nuk duket e qartë për tu arritur në të ardhmen e afërt për Shqipërinë. Ngjarjet dhe efektet që sollën zhvillimet dhe ndryshimet ekonomike, politike, sociale dhe teknologjike kanë mundësuar që vendet anëtare më të vjetra të BE-së të kishin nivele më të ulëta të rritjes ekonomike në krahasim me vendet më të reja anëtare.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Bazuar në këtë ecuri ekziston projeksioni që edhe Shqipëria si vend i ardhshëm anëtar i BE-së do të ketë nivele më të larta të mundëshme për rritjen e saj ekonomike. Përmes kësaj tendence parashikimi duket se Shqipëria në afatgjatë mund ta arrijë plotësimin edhe të treguesit të borxhit publik i cili i rezulton me mangësi, por ajo çfarë kërkohet të mos neglizhohet dhe të ndiqet njëkohësisht është ruajtja e defiçitit buxhetor brenda kufirit prej 3% të PBB-së, duke shkuar kështu drejt qëndrueshmërisë së financave publike afatgjata edhe për uljen dhe pastaj ruajtjen e nivelit të borxhit publik ndaj PBB-së deri në kufirin e 60%.

8. Kërkohet shumë kujdes nga mundësia për hapësirat që duket se ju krijohen vendeve të reja anëtare apo kandidate për anëtare në BE të cilat bazuar në këtë projeksion mund të huazojnë më shumë borxhe, pra të rrisin nivelin e borxhit publik ndaj PBB-së me shpresën se ritmet e larta të rritjes ekonomike do ti favorizojnë ato të qëndrojnë brenda kufirit të 60% të borxhit publik ndaj PBB-së krahasuar me shtetet anëtare më të vjetëra. Ky oreks për rritjen e borxhit nga qeveritë e vendeve si Shqipëria, rrezikon ti çojë në kolaps këto vende të cilat kanë sisteme ekonomike dhe mirë qeverisje të dobëta nisur që nga përqasja e drejtë me *acquis communautaire*, zbatimin e plotë të kuadrit ligjor dhe rregullator, regjistrimin korrekt dhe transparent të statistikave, dhe informimin simetrik të pretendentëve.
9. Pavarsisht se pretendohet që kuadri fiskal është i detajuar dhe i integruar me objektivat e qeverisë dhe në përputhje me kornizën makroekonomike, të dhënat fiskale nuk plotësojnë kërkesat e ESA2010 në lidhje me dallimin midis transaksioneve financiare dhe jofinanciare.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Që nga nëntori i vitit 2014, Shqipëria ka paraqitur raportime të rregullta në Eurostat për raportin e defiçitit të tepërt mbi bazën më të mirë të përpjekjeve dhe pritjet që gradualisht të harmonizojë statistikën e saj fiskale me kërkesat e BE-së.

10. Përgjatë literaturës teorike, veçuar dy grupe kryesore të cilët kanë dhënë kontributet e tyre mbi marrëdhënien e borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Nga njëra anë, qëndronin *Klasikët dhe Neoklasikët* të cilët e konsiderojnë borxhin publik si të dëmshëm për rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, qëndronin *ekonomistët modernë*, të cilët e shikojnë borxhin si një nxitës të rritjes ekonomike, por vetëm nëse fondet përdoren për qëllime produktive. Veçmas këtyre dy grupeve kryesore qëndronte *pikëpamja Konvencionale*, e cila pohon se, në afatin e shkurtër borxhi publik shfaq një efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike, ndërsa në afatin e gjatë ai shfaq një efekt negativ.
11. Qeveria shqiptare ka prezantuar masa të mëtijshme të konsolidimit fiskal me qëllim përmbushjen e synimit afatmesëm për uljen e borxhit publik nën 60% të PBB-së në 2021. Për të arritur objektivin përkatës, Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar të respektojë parimet fiskale sipas rregullit të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB). Sipas nenit nr. 63 të LOB, për herë të parë, aplikimi i kërkesave për parimet fiskale (neni 4.1), dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit në vitet e zgjedhjeve (neni 4.3) janë përfshirë në Raportin Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit, lidhur me gjendjen makroekonomike dhe fiskale 2017. Në lidhje me efektivitetin e rregullit fiskal në LOB në lidhje me uljen e borxhit gjatë vitit 2017 dhe 2018, rezultoi të ishte në përputhje pasi niveli i borxhit aktual ndaj PBB-së për vitin 2017 dhe 2018 rezultoi të jetë në trend rënës dhe respektivisht me 70.1% dhe 67.2%.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Kjo për vitin 2018 konsiston në një ulje prej rreth 5.5 pikë përqindjeje (pp) të totalit të borxhit publik nga niveli prej 72.7% në vitin 2015.

12. Analiza empirike tregoi se ekziston një marrëdhënie mes borxhit publik dhe PBB-së. Studimi empirik zbulon se nivele të larta të borxhit shtetëror kanë një efekt negativ në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Ky është I njëjti përfundim ia rritur edhe për vende të tjera në zhvillim sipas studimeve empirike të Pattillo et al., 2002; Pattillo et. al., 2004; Schclarek, 2004; Kumar dhe Eoo, 2010; Patrizio Lainà, 2011.
13. Borxhi publik në Shqipëri për vitin 2018 karakterizohet kryesisht nga borxh i brendshëm, afatshkurtër, në monedhë vendase, dhe i mbajtur kryesisht nga bankat vendase. Në vitet e fundit është vënë re se norma e rritjes së borxhit të jashtëm ka qenë më e lartë se ajo e borxhit të brendshëm, dhe kjo përbën një rrezik për stabilitetin financiar në vend, sepse mbart një ekspozim më të lartë ndaj ndryshimeve në tregjet botërore financiare dhe kursit të këmbimit. Gjithashtu, rritja e nivelit të borxhit publik mbi nivelin 60 përqind në vitin 2013 dhe vijimi në ngritje deri në vitin 2015 bëri që kreditorët potencialë të ripërceptojnë riskun, që paraqet Shqipëria dhe bonot e tij, në kuadër të huamarrjes.
14. Konsolidimi fiskal synon të ruajë nivelin e borxhit publik, pasi raporti ndaj PBB-së të vazhdojë të ruaj trajektorjen e sigurt për poshtë të nisur që nga viti 2016. Borxhi publik pritej të binte rreth 66.4 përqind të PBB-së në vitin 2019, 63.5 përqind në 2020 dhe më tej në 59.9 përqind në 2021.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

Në të njëjtën kohë, nga qeveria mednohej se kjo kornizë fiskale siguron një politikë që mund të mbështet rritjen ekonomike dhe të kompensojë efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në planin afatshkurtër dhe të mesëm nga qeveria parashikohen të jenë rreth 5 përqind të PBB-së, e cila konsiderohet optimale për të ushqyer kërkesën agregate në një afat të shkurtër dhe për të zhvendosur rritjen e mundshme ekonomike në një nivel më të lartë në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

15. Korniza fiskale synon një defiçit total fiskal prej 1.7 përqind të PBB-së për vitin 2019, nga 2.0 përqind i programuar për 2018; 1.2 përqind e PBB-së në vitin 2020; dhe 0.5 përqind në 2021. Diferenca midis investimit publik dhe defiçitit vjetor (huamarrjes), është synuar në nivele të larta dhe gradualisht në rritje për një periudhë afatmesme. Në të vërtetë, bilanci aktual në vitin 2019 është në shënjestër të 3.3 përqind të PBB-së, po aq sa shënjestrimi i vitit 2018 i synuar më tej në një rritje prej 3.7 përqind në vitin 2020 dhe 4.3 përqind në 2021.

5.3. Rekomandime

Në dritën e këtij punimi, rekomandohet që Shqipëria:

- *Në të ardhmen e afërt* do të jetë rregullimi i modelit të konsolidimit fiskal duke kufizuar madhësinë e borxhit publik, duke zgjeruar bazën e hapësirës fiskale duke mbështetur sektorin privat për një zhvillim më të qëndrueshëm të tij përmes reduktimit të korrupsionit të administrarës shtetërore e cila imponon rritje të evazionit fiskal, uljes së burokracisë, rritjes së profesionalizmit, rritjes së sigurisë dhe stabilitetit politik, si edhe detyrimet për TVSH-në e papaguar, faturat e papaguara për shërbime të ofruara qeverisë, dëmshpërblimet bazuar në vendimet e gjykatës së Hagës, gjykatave administrative, dhe arbitrazhi për gabimet lidhur me largimet nga puna, mbyllja e veprimtarive të bizneseve pa të drejtë, etj.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Në të ardhmen afatmesme, sfidat e mëtejshme do të mbeten në veçanti me focus në shlyerjen e detyrimeve të mëdha të pritura, që rrjedhin pjesërisht nga kthimi dhe kompensimi i pronave, detyrimet e mundshme dhe zhvillimet demografike me një plakje të shpejtë të Shqipërisë për shkak të emigrimit të konsiderueshëm që ka pasë popullsia në moshë të re drejt vendeve si Gjermania, etj. Gjithashtu, rritja e pabarazisë nga njëra anë dhe nga ana tjetër treguesit e dobët makroekonomike dhe financiarë të Shqipërisë do ta pengojnë qeverisjen e vendit të ketë hapësirën dhe mundësinë e reagimit përmes politikave mbështetëse fiskale apo monetare.
- Politikat fiskale për periudhën afatmesme 2019-2021 të orientohet qartë drejt konsolidimit fiskal për uljen e borxhit publik nën 60% të PBB-së, ndërkohë që siguron një nivel optimal të investimeve prej rreth 5 përqind të PBB-së mesatarisht.
- Për një rritje të raportit të borxhit kundrejt PBB me një trend mesatar rreth 0.47%, kërkon që secila strategji afatmesme të sigurohet se do të arrijë qëllimin për të cilin është krijuar. Pa një zbërthim më të detajuar, pa plane veprimi ku të prezantohen qartë hapat, afatet dhe kriteret e vlerësimit të punës së realizuar, nuk mund të ketë implementim efektiv të strategjive të hartuara.
- *Reformat strukturore* ti konsiderojë si shtytësi më i rëndësishëm i konkurrencës për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, përmirësimi i planifikimit të politikave do të kërkojë më shumë vëmendje nga autoritetet qeverisëse të Shqipërisë në rakordimin eficient dhe bashkëveprimin mes politikave fiskale dhe reformave strukturore në Shqipëri.



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Të prezantoj *masa të mëtejshme të konsolidimit fiskal* me qëllim përmbushjen e objektivit afatgjatë të treguar për uljen e borxhit publik nën 45% të PBB-së. Konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit publik janë thelbësore për uljen e rreziqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktajnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale të qeverisë duhet të jenë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të LOB (Ligjit Organik të Buxhetit).
- Të mbështetes konsolidimin fiskal përmes:
 - (a) forcimit të administratës tatimore.
 - (b) zgjerimit të bazës tatimore dhe shmangies së përjashtimeve tatimore.
 - (c) sigurimit që PPP-të të jenë kontraktuar vetëm në bazë të analizave të sakta të kosto-përfitimit dhe vlerësimit të risqeve fiskale.
- Konsolidimi fiskal duhet të ruajë nivelin e borxhit publik, pasi raporti ndaj PBB-së të vazhdojë të ruaj trajektorjen e sigurt për poshtë të nisur që nga viti 2016. Borxhi publik duhet të binte rreth 66.4 përqind të PBB-së në vitin 2019, dhe të vijoj rënien në 63.5 përqind në 2020 dhe më tej në 59.9 përqind në 2021. Përmirësimi i klimës së të bërit biznes dhe një kornizë e tillë fiskale sigurojnë një politikë që mund të mbështet rritjen ekonomike dhe të kompensojë efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në planin afatshkurtër dhe afat



Sfidat e politikës fiskale për vendet që i bashkohen BE-së (Rasti i Shqipërisë)

- Korniza fiskale duhet të synojë një defičit total fiskal prej 1.7 përqind të PBB-së për vitin 2019, nga 2.0 përqind i programuar për 2018; të vijoj rënien në 1.2 përqind të PBB-së në vitin 2020; dhe 0.5 përqind në 2021.
- Qeveria nuk duhet të zgjedhin që të reduktojnë shpenzimet për investime të saj si alternativën e saj më të mirë, për të reduktuar defičitin buxhetor sepse i rritet edhe borxhi public. Qeveria duhet të zgjedhë dhe të siguroj rritjen e të ardhurave nga taksat. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë gjë është reformimi cilësor dhe profesional i organeve tatimore dhe forcimi i rekrutimit dhe ndëshkimit të tyre në rastet e abuzimit me detyrën.
- Qeveria duhet të bëjë transparencë për publikun e gjerë se ku i përdor paratë që vijnë nga taksat. Transparenca rrit besimin, dhe ky i fundit do të rriste ndërgjegjësimin e qytetarëve taksapagues se paratë e tyre po përdoren në të mirë të tyre dhe do të shmangen evazionit fiskal dhe do të denoncojnë tatimorët abuziv.
- Kanalizimi i duhur i fondeve që siguron qeveria nga huamarrja, në edukim, shëndetësi, bujqësi, dhe në infrastrukturë, është një rekomandim tjetër i cili do të ndihmonte në uljen e efektit negativ të borxhit publik mbi rritjen ekonomike. Rritja e këtyre do të rrisite konsumin, dhe kjo do të sillte një PBB më të lartë. Kanalizim i duhur i fondeve, do të sjellë një efekt të konsiderueshëm në ekonominë e Shqipërisë dhe në mirëqenien e qytetarëve shqiptarë. Të gjitha këto rekomandime duhet t'i vijnë në ndihmë qeveritarëve shqiptarë, të cilët duhet të synojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe një mirëqenie më të lartë për qytetarët e tyre.



5.4. Studime të mëtejshme

- Mjaft interesante do të ishte të vazhdohej më tej analiza e punimit tim, duke studiuar rolin e borxhit publik të brendshëm dhe të jashtëm në rritjen ekonomike. Kjo duke iu referuar faktit që në Shqipëri vitet e fundit është vëne re një përshpejtim i ritmeve të rritjes së borxhit të jashtëm kundrejt atij të brendshëm, edhe pse ky i fundit vazhdon të këtë peshën kryesore në borxhin total.
- Nga ana tjetër, shumë studiues mund të jenë të interesuar të vazhdojnë analizën e mësipërme, duke përdorur modele të ndryshme empirike, të vlerësojnë marrëdhënien e borxhit publik dhe rritjes ekonomike në një panel që përfshin të dhëna për vendet në zhvillim, duke bërë një analizë krahasimore të Shqipërisë dhe këtyre vendeve. Pra, vazhdimi i analizës teorike dhe empirike mbi këtë marrëdhënie do të ishte shumë e vlefshme për të mësuar akoma më shumë mbi rolin e borxhit publik dhe rritjes ekonomike, në një kohë që kriza e borxheve është një fenomen që ka prekur shumë vende të zhvilluara apo në zhvillim.



LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

1. Abbas, S and Christensen, E (2007): The Role of Domestic Debt Markets in Economic Growth: An Empirical Investigation for Low-income Countries and Emerging Markets, IMF Working Paper, ff 20-23.
2. Agarkova Yuliya, -Public debt analysis in selected countries: Greece, Spain and Portugal, (2011).
3. Akerlof, G. A., Dickens, W. T., & Perry, G. L. (1996). The macroeconomics of low inflation. *Brooking Papers on Economic Activity*, p. 1-76.
4. Albania and indicators <http://www.imf.org/economic/indicators/Albania.com>.
5. Alfredo Schclarek (2004): —Debt and Economic Growth in Developing and Industrial Countries, f 15.
6. Alesina, Alberto and Roberto Perotti: The Political Economy of Budget Deficits, IMF Working Paper 94/85, Washington, DC 1995.
7. Amerini, G. (2004). Long - term interest rates for acceding countries. *Eurostat Statistics in Focus*, Theme 2-21.
8. Anand, Ritu, and Sweder Van Wijnbergen: Inflation and the Financing of Government Expenditures: An Introductory Analysis with an Application to Turkey, *World Bank Economic Review* 3, Washington, DC 1989.
9. Agénor, Pierre-Richard: *The Economics of Adjustment and Growth*, Academic Press, San Diego 2000.
10. Barth, Richard, and William Hemphill: *Financial Programming and Policy: The Case of Turkey*, IMF Institute, Washington, DC 2000.
11. Blanchard, Olivier J.: *Debt Deficits and Finite Horizons*, *Journal of Political Economy*, 1985.
